# Plani Zhvillimor i Komunës së Mamushës
# 2013-2023

DRAFT



Ky dokument është i përgatitur nga Komuna e Mamushës (Drejtoria e Zhvillimit, Planifikimit, Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrit), e mbështetur nga Programi për Mbështetje e Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP) i financuar nga Sida dhe i zbatuar nga UN-Habitat-i, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor .

Mamushë, ….2013

**Përgaditur nga:**

Komuna
Mamusha/Mamuşa

**Përkrahur nga:**

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Programi i Mbështetjes së Planifikimit
Hapësinor Komunal

Implementuar nga:

UN-HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

Financuar nga:

SWEDEN

<u>**GRUPI PUNUES**</u>

**Cavit Mazrek –** Drejtor i drejtorisë për zhvillim, planifikim, urbanizëm, gjeodezi dhe kadastër, Mamushë
**Esra Osi –** palnere urbane dhe regjionale **/** shefe e drejtorise për zhvillim, planifikim, urbanizëm, gjeodezi dhe kadastër, Mamushë
**Ishaku Maitumbi –** koordinator i njësisë për planifikim, MuSPP / UN-Habitat
**Jillian Bywater** – dizajnere urbane dhe planere / deri më 2011 udhëheqëse e projektit MuSPP / UN-Habitat
**Artnet Haskuka** – arkitekt / zyrtare për planifikim hapësinor dhe urban, MuSPP / UN-Habitat
**Dafina Karahoda** – arkitekt / deri 2011 zyrtare për planifikim dhe prej 2011 udhëheqëse e projektit, MuSPP / UN -Habitat
**Caroline Johansson** – arkitekte peisazhi / zyrtare për planifikim, MuSPP / UN-Habitat
**Yuksen Topoyan** - Shef i drejtorisë për shërbime publike, Mamushë
**Nusret Morina** – zyrtare në kadastër, Mamushë
**Hashim Morina** – zyrtar mjedisor, Mamushë
**Ylber Kastrati** – administratë, Mamushë
**Xhevahire Gashi** – zyrtare e lartë për financa, Mamushë
**Agim Morina** – Drejtor i drejtorisë për shërbime publike
**Cafer Morina –** Drejtor i drejtorisë për arsim, Mamushë
**Yahya Mazrek –** Drejtor i drejtorisë për bugjet dhe financa Mamushë/Mamuša
**Esat Morina -** Koordinator për cështje sociale, Mamushë
**Hayrullah Mazrek –** zyrtar i laretë për financa, Mamushë
**Necat Morina** – Udhëheqës i shoqatës së farmerëve, Mamushë

<u>**KESHILLTARË**</u>

**Hasse Ericsson** – MuSPP / UN-Habitat
**Peter Engstrom** – MuSPP / UN-Habitat

<u>**EKIPI MBESHTETES**</u>

**Catarina Camarinhas** – koordinatore e njësisë së planifikimit, MuSPP / UN-Habitat
**Lumnije Gashi** – zyrtare për planifikim hapësinor dhe urban, MuSPP / UN-Habitat
**Rudina Qerimi** – zyrtare për informim / zyrtare për planifikim hapësinor dhe urban, MuSPP / UN-Habitat
**Arijeta Himaduna** – zyrtare për cështje gjinore / shoqëri civile, MuSPP / UN-Habitat
**Gloriosa Hisari** – zyrtare ligjore, MuSPP / UN-Habitat
**Drita Nushi** – zyrtare për planifikim hapësinor dhe urban, MuSPP / UN-Habitat
**Vjollca Puka** – departamenti planifikimit hapësinor, MMPH
**Festa Nixha**, instituti i planifikimit hapësinor, MMPH
**Gëzime Ibrahime**, instituti i planifikimit hapësinor, MMPH
**Merita Morina**,departamenti i banimit, MESP
**Drita Shabani**, departamenti i banimit, MESP

**EKSPERTET E JASHTEM**

**Michal Drozdz**, Ekspert i GIS-it

**Kadri Tilleman**, ekspert i VSM-së

**Lista e akronimeve**

| | |
|---|---|
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| EULUP | Mbështetja e Mëtejshme e Projektit të Përdorimit të Tokës – Bashkësia Evropiane |
| IOM | Zyra Ndërkombëtare për Migrim |
| KEK | Korporata Energjetike e Kosovës |
| MAPL | Ministria  Administratës dhe Pushtetit Lokal |
| MBPZHR | Ministria e  Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Forestry |
| MEF | Ministria e Ekonomisë dhe Financave |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| MTI | Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë |
| PRrU | Plani Rregullativ Urban |
| PTK | Posta dhe Telekommunikacioni i Kosovës |
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal |
| PZHU | Plani Zhvillimor Urban |

# Përmbajtja

HYRJE ... 10
RËNDËSIA E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR ... 10
QËLLIMI I PZHK-së SË MAMUSHËS ... 11
PROCESI I PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA ... 12
RAPORTI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR ... 13
SI TI PËRDORIM PLANET ... 13
QEVERISJA LOKALE DHE ADMINISTRATA KOMUNALE ... 14
KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PZHK-së ... 15
DOKUMENTETE REFERUESE PËR PZHK-NË E MAMUSHËS ... 16
1. PROFILI ... 18
1.1 KUSHTET FIZIKE DHE GJEOGRAFIKE ... 18
1.1.1 Pozita gjeografike ... 18
1.1.2 Karakteristikat gjeografike ... 19
1.2 DEMOGRAFIA DHE SITUATA SOCIO-EKONOMIKE ... 20
1.2.1 Popullsia ... 20
1.2.2 Situata Sociale ... 22
1.2.3 Infrastruktura dhe shërbimet sociale ... 24
1.2.4 Vlerësimi i Situatës Aktuale ... 30
1.2.5 Sfida ... 31
1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK ... 34
1.3.1 Situata ekonomike ... 34
1.3.2 Vlerësimi i situatës aktuale ... 40
1.3.3 Sfidat ... 41
1.4 INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHERBIMET PUBLIKE ... 43
1.4.1 Infrastruktura Rrugore ... 43
1.4.2 Shërbimet publike ... 44
1.4.3 Infrastruktura teknike ... 47
1.4.4 Vlerësimi i situatës aktuale ... 50

1.5 PËRDORIMI I TOKËS , VENDBANIMI DHE BANIMI ........ 52
1.5.1 Përdorimi i tokës ........ 52
1.5.2 Vendbanimi ........ 58
1.5.3 Banimi ........ 58
1.5.4 Vlerësimi i Situatës Aktuale ........ 60
1.5.5 Sfidat ........ 60
1.6 MJEDISI, ZONAT E RREZIKUARA NGA RREZIQET DHE DEGRADIMI DHE TRASHEGIMIA KULTURORE ........ 61
1.6.1 Peisazhi dhe Resurset Natyrore ........ 61
1.6.2 Trashëgimia kulturore ........ 62
1.6.3 Situata e mjedisit ........ 63
1.6.4 Fatkeqësitë natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu ........ 65
1.6.5 Vlerësimi i situatës aktuale ........ 67
1.6.6 Sfidat ........ 68
1.7 KAPACITETET NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPESINORË ........ 71
1.7.1 Sfidat ........ 72
1.8 VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË INVESTIMEVE ........ 73
2. VIZIONI, PARIMET DHE QËLLIMET ........ 75
2.1 VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS ........ 75
2.2 PARIMET PËR ZHVILLIM ........ 77
1.2 SYNIMET AFATGJATA ZHVILLIMORE ........ 78
1.3 PRIORITETET STRATEGJIKE ........ 81
3. KORNIZA KOMUNALE E ZHVILLIMIT HAPËSINOR ........ 82
3.1 KONCEPTET KRYESORE TË ZHVILLIMIT HAPËSINOR ........ 82
3.1.1 Skenari i preferuar ........ 82
3.2 STRUKTURAT HAPËSINORE DHE LOKACIONET PËR ZHVILLIMET DHE ORGANIZIMET E ARDHSHME ........ 87
3.2.1 Popullsia, strehimi dhe vendbanimi ........ 87
3.2.2 Infrastruktura Sociale ........ 88
3.2.3 Zhvillimi ekonomik, duke përfshirë turizmin, rekreacionin dhe tregtinë ........ 90
3.2.4 Infrastruktura, transporti, komunikacioni dhe shërbimet publike ........ 94

3.2.5 Trashëgimia mjedisore, natyrore dhe resurset, pamja e vendit dhe trashëgimia kulturore 98

3.3 SHËNJIMI I ZONËS SË VENDBANIMIT EKZISTUES DHE ZONAT E PROPOZUARA SI DHE KUSHTET RREGULLUESE PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM ... 105

4. STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANI I VEPRIMIT ... 106

4.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANI I VEPRIMIT ... 107

4.2 VLERËSIMI I STRATEGJIVE BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA NË BAZË TË PARIMEVE, POLITIKAVE DHE LIGJIT ... 119

5. DISPOZITAT PËR ZBATIM ... 121

5.1 UDHËZUES MBI PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL ÇËSHTJET E ZBATIMIT GJATË HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES DHE PLANEVE TJERA; ... 121

5.2 KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE PËR ÇËSHTJET RELEVANTE PER ZHVILLIM DHE PËRDORIM TË TOKËS NË KOMUNË ... 121

5.2.1 Kushtet për përcaktimin e destinacionit për përdorimin e tokës brenda territorit të komunës 121

5.2.2 Kushtet për rregulloren e hapësirës ... 121

5.2.3 Kushtet për rregullimin e zonave të ndërtimit në vendbanime ... 122

5.2.4 Kushtet për rregulloren e veprimtarive ekonomike ... 124

5.2.5 Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike ... 126

5.2.6 Kushtet për vendosjen e korridoreve apo shtigjeve, sipërfaqet lidhëse dhe sistemet tjera të infrastrukturës; ... 127

5.2.7 Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore, kulturore dhe pasurive historike; ... 129

5.2.8 Mënyrat e trajtimit të mbeturinave të ngurta dhe të ujerave të zeza; ... 130

5.2.9 Masat për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis ... 131

5.2.10 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social; ... 132

5.2.11 Masat për zbatimin e planit ... 132

5.3 DISPOZITAT QË LIDHE ME BASHKËPUNIMIN ... 133

5.4 DSPOZITAT QË MBI FAZAT E IMPLEMENTIMIT ... 134

5.5 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM ... 134

5.6 DISPOZITAT PERFUNDIMTARE ... 135

6. ELEMENTET E RREGULLIMIT TË HAPËSIRËS ... 136

6.1 HYRJE ... 136

6.2 HARTA E ZONIMIT ..... 137
6.3 KUSHTET E NDËRTIMIT ..... 144
6.3.1 Banimi ..... 144
6.3.2 Përdorimi i përzier : Banim + ..... 147
6.3.3 Ndërtesat industriale, tregtare dhe administrative ..... 147
6.4 INFRASTRUKTURA– RRJETI RRUGOR ..... 149

# HYRJE

## RËNDËSIA E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Planifikimi hapësinor është një aktivitet që ka për qëllim koordinimin e planifikimit hapësinor të të gjitha aktiviteteve dhe proceseve në mënyrë që të vendosë një qëndrueshmëri afat-gjate, korniza të qëndrueshme për zhvillim social, ekonomik dhe kulturor duke marrë parasysh konsideratat mjedisore. Me qasjen e vet multidisiplinare, roli kyç i planifikimit hapësinor është për të rritur integrimin ndërmjet politikave sektoriale dhe planeve duke siguruar përdorimin racional të tokës dhe ruajtjen e vlerave kulturore dhe natyrore të hapësirës.

Korniza e Planifikimit Hapësinor në Kosovë është e përcaktuar me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor dhe Ligjin Nr. 2003/14 Nr. 2003/L-106 mbi Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr .2003/14. Adaptimi për t'iu përshtatur standardeve ndërkombëtare, një planifikim i ri përfshirës dhe një qasje multi-displinare është prezantuar duke u bazuar në konceptin e planifikimit pjesëmarrës strategjik. Legjislacioni përcakton rolet dhe përgjegjësitë e nivelit lokal dhe qendror në hiererakinë e planeve strategjike mjedisore të bazuara në principet e një zhvillimi të qëndrueshëm, procedurat për shqyrtim publik dhe participim si dhe pjesëmarrje të palëve të ndryshme të interesuara në procesin e planifikimit.

Plani Hapësinor i Kosovës përshkruan vizionin strategjik dhe zhvillimet e ardhshme hapësinore për Kosovën si dhe udhërrëfyesin për hartimin e planeve hapësinore komunale dhe urbane.

Një Plan Zhvillimor Komunal (PZHK) është një plan multi-sektorial që i përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, mjedisor, social dhe hapësinor në të gjithë territorin e komunës, duke përfshirë zonat urbane dhe fshatrat.

Plani Zhvillimor Urban (PZHU) është një dokument që do të promovojë zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm hapësinor të një zone urbane, në interes të përbashkët të të gjithë banorëve me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetesës. Ai shërben gjithashtu edhe si një bazë dhe udhëzues për hartimin Planeve Rregulluese Urbane (PRrU), që i përcakton kushtet për rregullimin e hapësirës, zonave të ndërtimit, kushtet për pozicionimin e ndërtesave në parcelat tokësore, vijat rregullative, Vijat e Ndërtesave, Normat Teknike Urbane dhe kërkesat e tjera sa i përket vendeve të lejuara për ndërtesa dhe ndërtimet tjera në parcelat urbane.

Është e rëndësishme të theksohet se qasjet e reja në planifikimin strategjik hapësinor përfshijnë më tepër se vetëm rregulloret e përdorimit të tokës. Kjo kërkon një qasje të integruar për rregullimin e tokës, duke ndjekur një vizion të qartë në përputhje me të gjitha grupet e interesit dhe një angazhim për të punuar drejt arritjes së qëllimeve të vendosura nga procesi i vizionimit. Kjo i lejon planifikuesit dhe palët e interesuara të përcaktojnë së bashku një perspektivë të zhvillimit të përgjithshëm, të identifikojnë fushat prioritare për veprim, dhe të përqendrohen në zbatimin e tyre. PZHK-ja e Mamushës është një plan strategjik multi-sektorial që përkufizon qëllimet e shkurtra dhe afatgjata ekonomike dhe sociale për komunën për periudhën e ardhshme 10 vjeçare. Në mënyrë që të sigurojë përputhshmërinë e politikave lokale dhe vendimeve me strategjitë kombëtare ky plan duhet të jetë në përputhje me

Planin Hapësinor të Kosovës. Nëpërmjet procesit të planifikimit strategjik, plani mund të identifikojë çështjet afatgjata, si dhe integrimin e prioriteteve afat-shkurtra në planet e veprimit. Në këtë mënyre ai shërben si një mjet për krijuesit dhe menaxherët e politikave lokale për të ndihmuar ata që të ndajnë burimet e tyre në mënyrë më efikase dhe të ofrojnë cilësi më të lartë të shërbimit për qytetarët.

## *QËLLIMI I PZHK-së SË MAMUSHËS*

Mamusha ishte një fshat që i përkiste Komunës së Prizrenit deri në vitin 2005 kur ajo u krijua si një pilot komunë. Para vitit 2003 administrata nuk kishte një PZHK / PZHU që përmban tema që janë të përcaktuara dhe të detyrueshme nga ligjet e tanishme. Dokumentet e mëparshme të planifikimit janë zhvilluar nga Komuna e Prizrenit, kur Mamusha ishte përfshirë ende si një fshat brenda territorit të komunës së Prizrenit. Dokumenti i vetëm i hartuar për Komunën e Mamushës është Strategjia Zhvillimore Lokale në vitin 2009, e cila nuk përfshin ndonjë komponent hapësinor.

Orientimi i kësaj komune të vogël drejt zhvillimit të qëndrueshëm mund të arrihet vetëm me anë të hartimit të planeve hapësinore.

Qëllimi i Planit Zhvillimor Komunal të Mamushës është që të ofrojë një vizion për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës dhe drejtimin e përbashkët për politikat dhe programet për të arritur qëllimet e përcaktuara si dhe prioritetet e identifikuara strategjike. Është një dokument që duhet të përgjigjet për çështjet kryesore lidhur me zhvillimin e ardhshëm të komunës: si p.sh. për të përmirësuar bujqësinë si sektor kryesor për zhvillimin e komunës, cilat janë potencialet e tjera për zhvillim, ashtu edhe për të zgjidhur nevojat e banimit dhe të ruajtjes së tokës bujqësore , dhe për të adresuar sfidat e arsimit dhe për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet publike, etj, Përveç që përshkruan udhëzimet që lidhen me drejtimin e parapëlqyer dhe natyrën e zhvillimit të ardhshëm, PZHK-ja gjithashtu adreson çështje të tilla si mbrojtja e mjedisit, trashëgimia kulturore zhvillimi i komunitetit, rekreacionit dhe promovimi i produkteve bujqësore.

Me hartimin e PZHK-së, Mamusha si një komunë e re është duke iniciuar një proces të rëndësishëm që ka potencial për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mundësit ekonomike për banorët e saj.

PZHK-ja përfshin shumë aspirata dhe dimensione, por qëllimi i saj kryesor është për të hartuar një kornizë për veprim që do të shërbejë si një plan dinamik dhe i gjallë për komunën. Procesi dhe elementet e planit përfundimtar pritet që të sigurojnë një bazë për vendim-marrje dhe të shërbejnë si një udhëzues i shkruar për të menaxhuar politikat publike, planet, programet, veprimet, investimet dhe për lëshimin e lejeve të ndërtimit për të ardhmen.

Plani përfshin pajisjet me anën e të cilit objektivat afatgjata mund të rregullohen në bazë të veprimeve dhe të zhvillimeve të shkurtra, të mesme dhe afat-gjate .

Përveç rolit të saj primar si një dokument strategjik, PZHK-ja ka gjithashtu një rol pjesërisht rregullues. Duke pasur parasysh zonën e e vogël të komunës me vetëm një vendbanim PZHK-ja e Mamushës si një dokument kornizë mund të luajë gjithashtu një rol parësor në ofrimin e elementeve të rregullimit derisa mos të përgaditen plane më të detajuara të rregullimit. Elementet e rregullimit të cilat janë të

parashikuara në dokumentin e PZHK-së do të drejtojnë komunën në lëshimin e lejeve të ndërtimit për ndërtimet në zonën e vendbanimit.

Suksesi i këtij plani varet mbi zbatimin e saj, mbështetjen institucionale, angazhimin qytetar dhe qëndrueshmërinë e udheheqjes së procesit.

PZHK është një udhëzues që jep udhëzime për liderët lokalë, komunitetin e biznesit dhe qytetarëve privat me qëllimet e mëposhtme:

Për të kontrolluar zhvillimin në mënyrë të qëndrueshme, duke promovuar interesat e përbashkëta të banorëve në fushat e zhvillimit social, mjedisit, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës brenda Mamushës .

- Për të identifikuar një strategji për të shfrytëzuar në mënyrë sa më efektive dhe efikase burimet potenciale natyrore dhe shoqërore.
- Të identifikojë lokacionet potenciale dhe burimet për zhvillimin komunal.
- Të mbështesë zhvillimin e ekuilibruar të zonave urbane dhe rurale.
- Të identifikojë rolin e zonave kryesore për zhvillimin social dhe ekonomik.
- Të identifikojë prioritetet për zbatimin e projektit.
- Për të mbrojtur dhe shfrytëzuar gjëra të trashëgimisë natyrore dhe kulturore për turizmin dhe zhvillimin ekonomik.
- Të udhëheqë ndërtimin, rindërtimin, ruajtjen dhe konsolidimin në 4 zonat e vendbanimit.
- Të drejtojë hartimin e një Plani Rregullues Urban për Zonën A.
- Për të lehtësuar përdorimin dhe mbrojtjen e biznesit, përdorimit të banimit dhe të shërbimeve, dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

## *PROCESI I PLANIFIKIMIT DHE METODOLOGJIA*

Pas kërkesave ligjore të parashikuara në LPH No.2003/14 dhe Ligji No.2003/L-106 për ndryshimin e LPH-së, komuna e Mamushës ka nisur përgatitjen e PZHK-së më 31.03.2010 (Vendimi nr. 13-09).Procesi i planifikimit dhe hartimi i dokumentit u ndërmor nga autoriteti i planifikimit komunal-Departamenti i Planifikimit Zhvillimor, Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrit) i mbështetur nga UN-Habitati –Programi Komunal i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor financuar nga Sida.

PZHK-ja është përgatitur nëpërmjet një procesi me pjesëmarrje dhe duke respektuar parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor dhe qeverisjes së mirë si : transparencën, zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e publikut, etj, dhe në përputhje me politikat kombëtare dhe PHK-së.Procesi ka tentuar të përfshijë pjesëmarrës të ndryshëm në të gjitha fazat e procesit: nga faza përgatitore dhe analizimi i situatës nëpërmjet definimit të vizionit dhe konceptit për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës si dhe hartimin e Strategjive të zbatimit dhe të Planit të Veprimit.

Përfshirja e të gjitha palëve të interesuara si : institucionet e nivelit qendror, shoqërisë civile dhe sektorit privat është bërë përmes takimeve konsultative, seminare tematike dhe prezantimeve publike.

Struktura e dokumentit është në përputhje me Udhëzimin Administrativ-Nr.33 mbi elementet themelore të PZHK-së dhe përmban përbërësit tekstuale dhe grafik duke pasqyruar procesin dhe fazat kryesore të procesit të planifikimit

## *RAPORTI I VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR*

Siç kërkohet me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimeve Administrative të ndërlidhura, PZHK-ja do të ketë një vlerësim të ndikimit social, ekonomik dhe mjedisor në kuadër të zhvillimit të propozuar. Raporti për VSM-në është që të kryhet në përputhje me Direktivën 2001/42/KE të BE-së në vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve në mjedis dhe me Ligjin e Kosovës Nr 03 / L - 230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Në bazë të Vendimit për hartimin e PZHK-së, Komuna e Mamushës ka kryer raportin mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor të PZHK-së.

Qëllimi i këtij raporti është që të nxjerrë në pah segmentet kyçe të mjedisit që mund të jenë

prekur nga zbatimi i strategjive dhe veprimeve të propozuara në PZHK, të identifikojë ndikimet më të rëndësishme pozitive dhe negative mbi mjedisin, të propozojë masa për të zvogëluar ndikimet negative të identifikuara dhe të e përcakton programin e monitorimit mjedisor gjatë zbatimit të Planit. Konkluzioni i përgjithshëm i VSM-së është se PZHK-ja është e drejtuar në përmirësimin e gjendjes aktuale, ekonomike si edhe të mjedisit dhe aktivitetet e saj dhe komponentët nuk përfshijnë ndonjë ndikim të madh negativ mjedisor, siç është theksuar në Raportin për VSM-në

## *SI TI PËRDORIM PLANET*

Plani Zhvillimor Komunal i Mamushës është një dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të saj për një zhvillim dinamik ekonomik në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e jetës.

Objektivi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) është të identifikojë qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe hapësinor për tërë territorin e komunës. PZHK mbulon fusha të shumta të politikës siç janë banimi, rrugët dhe transporti, infrastruktura, hapësirat publike dhe objektet, trashëgiminë kulturore, vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve nga fatkeqësitë (VMRRF), bujqësinë dhe pylltarinë, zhvillimin rural dhe bashkëpunimin ndër-komunal.

PZHK-ja përmban vizionin për zhvillimin e ardhshëm që prioritizon projektet për qëllime publike. Komuna do të përdorë PZHK-në për të negociuar me palët e ndryshme të tilla si ministritë dhe investitorët privatë për zbatimin strategjik të projekteve komunale.

PZHK-ja e thekson zonimin e përdorimit të ardhshëm të tokës zonimi brenda territorit të komunës për zhvillimin e tokës, ruajtjen e saj apo kufizimin me theks të veçantë në zonat rurale. PZHK-ja gjithashtu ofron udhëzime për infrastrukturë, pjesës kryesore. lartësisë dhe paraqitjen për një zhvillim të ri. Të gjitha aplikacionet që kërkojnë pëlqimin(aplikimin e planifikimit) do t'u referohen politikave të PZHK-së dhe do të jenë në përputhje me natyrën e planit.

Në praktikë, ka burime të çmuara natyrore të tilla si lumenj, pyje, terrene me kodra dhe malet që do të ruhen në mënyrë adekuate përmes kufizimeve të zonave të ndërtimit. Sa i përket strategjisë VMRRF, zhvillimi duhet të jetë i përmbajtur brenda zonës së prirur ndaj katastrofave për të minimizuar rrezikun e rrëshqitjes së dheut, përmbytjet dhe erozionin. Toka pjellore bujqësore dhe pyjet janë gjithashtu burimet kyçe për komunën, që të ruhen për të mirën e ekonomisë lokale rurale, si dhe vlerën e peizazhit.

PZHK-ja mund të përdoret si:

- Si një kornizë që mundëson zhvillimin e ardhshëm në Mamushë që duhet të ndërmerren në mënyrë të qëndrueshme duke ruajtur burimet natyrore dhe biodiversitetin si dhe duke promovuar një zhvillim kompakt me përdorim të përzier
- Për të rritur mundësitë e punësimit dhe të sigurojë një cilësi të mirë të jetës për qytetarët e Mamushës
- Të drejtojë investimet e ardhshme në një mënyrë të koordinuar, me prioritete
- Të identifikojë fushat e mundshme të fatkeqësive dhe të propozojë masa të kontrolluara

## *QEVERISJA LOKALE DHE ADMINISTRATA KOMUNALE*

Komuna e Mamushës është një komunë e vogël rurale në jug të Kosovës. Ajo kohët e fundit fitoi statusin si një qendër administrative dhe komunë, por ka funksionuar si një komunitet rural lokal që nga viti 1985.

Mamusha ka filluar të funksionojë si një pilot komunë në vitin 2005, pas nxjerrjes së një akti administrativ nga përfaqësuesi special i sekretarit të përgjithshëm të OKB-së.

Pilot Komunës i ishte dhënë statusi i plotë në vitin 2008 pas miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe kufijtë administrative të Komunës.

Administrimi aktual i komunës përbëhet nga zyra e kryetarit dhe gjashtë drejtorive komunale dhe sektorët e tyre të ndërlidhura.




***Figura 1 . Administrata Komunale (2013***

## *KORNIZA LIGJORE PËR HARTIMIN E PZHK-së*

Gjatë hartimit të PZHK-së janë hartuar ligjet në vijim :

• Ligji mbi Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14 dhe Ligji mbi amendamentimin e Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor Nr.03/L-106

• Ligji mbi Trashëgiminë Kulturore Nr.02/L-88

• Ligji mbi Ndërtimin Nr.04-L-110

• Ligji mbi rrugët Nr.2003/11

• Ligji mbi Transportin rrugor Nr.2004/11

• Ligji mbi tokën bujqësore Nr.02/L-26

•Ligji mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr.03/L-230

• Ligji mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Nr.04/L-027

• Ligji mbi Kadastrin Nr.04-L-013.

• Ligji mbi mbrojtjen e mjedisit Nr.03-L-025

• Ligji mbi mbrojtjen e natyrës Nr.03-L-233

• Ligji mbi zonat ekonomike Nr. 04-L-159

• Ligji mbi mbeturinat Nr.04-L-060

• Ligji mbi ujin Nr.2004/24

• Ligji mbi zhvillimet bujqësore dhe rurale Nr.03-L-98

• Ligji mbi sigurinë në trafik Nr.02-L-70

• Ligji mbi pyjet Nr.2004/29 etj.

## *DOKUMENTETE REFERUESE PËR PZHK-NË E MAMUSHËS*

Dokumentet përkatëse që janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të PZHK-së së Mamushës janë:

• Plani Hapësinor i Kosovës (2010-2020)

• Strategjia e Zhvillimit Lokal-2009

• Raportet dhe politikat e sektorit të nivelit komunal dhe kombëtar

  - Raportet komunale të sektorëve
  - MMPH (2007), Raport mbi gjendjen e natyrës
  - MMPH (2011), Raporti mbi Mjedisin në Kosovë 2008-2010
  - MIA (2007), Vlerësimi i rreziqeve
  - ASK (2013), Vlerësimi i popullsisë së Kosovës; 2011 Regjistrimi i popullsisë
  - ASK (2009), Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimit dhe organizimit territorial në Kosovë deri në vitin 2008

Dokumentet e tjera në dispozicion:

- Dokumenti i Integruar i Vizionimit për Mamushën 2011
- Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë (2009) Studimi i Fizibilitetit për Qendrën e Grumbullimit në Mamushë




*Figura* **2.** *Strategjia e Zhvillimit hapësinor – Zona e Portokalltë (Kopshtet e Kosovës)*

*Burimi : PHK 2010-2020*

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK-së) 2010-2020 përkufizon qëllimet dhe objektivat e zhvillimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës dhe shërben si udhëzues për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale. Struktura hapësinore e territorit të Kosovës është e ndarë në fushat e mëposhtme bazuar në karakteristikat e tyre të përbashkëta të gjeografike, ekonomike dhe sociale:

- "Thesari i Kosovës" - zonë e gjelbër, e karakterizuar nga industria, shërbimi dhe tregtia me Mitrovicën si qendër kryesore.
- "Porti i Kosovës "-zona e kaltër me Prishtinën si kryeqendë , qendër administrative, arsimore, agro-industriale, të tregtisë dhe shërbimit .
- “"Kopshtet e Kosovës "- me ngjyrë portokalli dhe e karakterizuar si zonë kulturoro-turistike, shërbime të agro-industrisë dhe të tregtisë. Qendrat kryesore në Prizren dhe Pejë.
- “Urat e Kosovës”-zona e verdhë është e identifikuar si vend me potencial turistik, tregtar, shërbyes dhe agro-industrial. Ferizaj, Gjilani dhe Gjakova janë nyje tregtare me shtetet fqinje.

Mamusha është pjesë e Pjesës jugore të Kosovës ,zonës së portokalltë , që përfshinë Suhareken, Dragashin dhe Prizrenin si qendra komunale. .

Vizioni i zonës së portokalltë në PHK është: :

- Kopshti i Kosovës, me Prizrenin si qendër të saj do të ndërtohet në rrënjët dhe traditat e kësaj zone të lashtë, për t'u bërë një qendër moderne ekonomike dhe kulturore-turistike, e zhvilluar, me shërbim të industrisë bujqësore dhe tregtisë, dhe rrjetit funksional që krijon lidhje të forta me fshatrat e largëta për të inkurajuar aktivitetet e bazuara në burimet natyrore, krijimin e një mjedisi tërheqës punues për zhvillimin e aktiviteteve afariste private, veçanërisht në turizëm dhe bujqësi.
- Synimet kryesore për rajonin jugor –Kopshtet e Kosovës janë :
- Administrimi efikas që promovon programet për zhvillimin ekonomik lokal
- Zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike
- Zhvillimi i bujqësisë
- Programi i ZHEL-it ( zhvillimi ekonomik lokal) përmes promovimit të NVM-ve ( ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme )
- Zhvillimi i turizmit kulturor dhe malor , mbrojtja e trashëgimisë natyrore kulturore dhe historike

Këto caqe afatgjata të zhvillimit ishin bazë për vendosjen e qëllimeve specifike të zhvillimit për Mamushën, duke marrë parasysh kontekstin e saj lokal: Karakteristikat gjeografike, burimet natyrore dhe zhvillimin aktual ekonomik dhe burimet njerëzore.

Kutia 1. Plani Hapësinor i Kosovës

# 1. PROFILI

## 1.1 KUSHTET FIZIKE DHE GJEOGRAFIKE

### 1.1.1 Pozita gjeografike

**Lokacioni:** Komuna e Mamushës shtrihet në regjionin jugor të Kosovës. Sipërfaqja e saj është 10.94 km² dhe është njëra nga njësitë komunale më të vogla në Kosovë. Koordinatat e komunës janë gjerësia 42° 20’40”dhe gjatësi 20° 43’47”. Komuna në juglindje kufizohet me Komunën e Prizrenit, në verilindje me Komunën e Suharekës dhe në veriperëndim me Komunën e Rahovecit. Vendbanimi i vetëm në komunë është e komuna e Mamushës që gjendet në të dy anët e rrugës që lidh rrugën Piranë – Suharekë me rrugët regjionale Prizren-Prishtinë dhe Prizren – Shkup, ndërsa në jug lidh me Gjakovën dhe Pejën. Distanca nga qendrat e komunave fqinje është: nga Prizreni është 20 km, nga Suhareka është 10 km dhe nga Rahoveci 15 km.




*Figura 3. Geographical Position of Mamusha/Mamuşa Municipality*

### *1.1.2 Karakteristikat gjeografike*

**Topografia:** Komuna e Mamushës shtrihet në rrafshin e Dukagjinit, pellgut të madh që mbulon pjesën jug-lindore të Kosovës. Ky rajon ka tokë të punueshme pjellore, e cila në kombinim me klimën e bën të përshtatshëm kultivimin bujqësor. Territori i komunës është i përbërë kryesisht prej terrenit të sheshtë në zonën qendrore, ndërsa në veriperëndim ka dy kodra Maçovina dhe Tiçanlik, ku janë të mbjella vreshta dhe një në Juglindje ku rriten shkurre / pyje. Komuna e Mamushës ka një lartësi prej 320-360 m mbi nivelin e detit me pikën më të lartë në kodrën Golubrade me 460 m. Dy lumenj rrjedhin përmes komunës, duke kaluar nëpër tokë të punueshme: më i madhi Toplluha e cila është degë e lumit Drini i Bardhë dhe një më i vogël me emrin Tërrn. Vendbanimi linear është i vendosur në një pjerrtësi në qendër të komunës, përgjatë një rrugë të ngushtë dhe gjarpëruese.

**Kushtet klimatike:** Në komunën e Mamushës mbizotëron një klimë kontinentale, por ajo gjithashtu përjeton edhe një klimë mesdhetare për shkak të rrymës të ngrohtë të Adriatikut që vjen përmes kanjonit të lumit Drini i Bardhë. Kjo klimë është e përshtatshme për kultivimin e një sërë të prodhimeve bujqësore. Temperatura mesatare vjetore në komunë është 11.5 ° C. Temperatura më e lartë mesatare është 22,2 ° C në korrik-gusht, ndërsa më e ulët është 0 ° C në janar. Reshjet mesatare janë diku rreth 686 mm / vit.

**Kushtet hidrologjike:** Dy lumenj kalojnë përmes komunës së Mamushës, lumi Toplluhë dhe lumi Tërrn. Lumi Toplluhë me një gjatësi prej 4 km fillon në Shkozë të Malishevës, ndërsa lumi Tërrn me një gjatësi prej 2.5 km fillon në Sallagrazhdë-Suharekë. Cilësia e ujit të dy lumenjve është e ulët dhe për këtë arsye nuk përdoret për të pirë apo për ujitje brenda komunës së Mamushës. Megjithatë ka burime të pasura ujore nëntokësore të cilat përdoren për këtë qëllim.

**Përbërja e tokës:** Një pjesë e madhe e tokës në komunën e Mamushës me rreth 85% është tokë bujqësore. Nga kjo, 65% është tokë e punueshme e kualitetit të mirë e cila përdoret për të prodhuar perime; 11% janë livadhe dhe kullota dhe rreth 9% janë vreshta; pyjet dhe shkurret përbëjnë 9% të territorit të komunës. Vendbanimi në vetvete shtrihet në tokë bujqësore të kualitetit të mirë të zonës qendrore, ndërsa vetëm 2% e tokës komunale është kategorizuar si një tokë joproduktive.

**Flora dhe fauna**: Mjedisi natyror në Mamushë është i pasur dhe i larmishëm si në habitate ashtu edhe me kafshë të egra. Pylli është i mbjellur me drunj të ndryshëm dhe shkurre që janë vendbanim për një numër të madh të kafshëve të egra. Ekziston edhe një biodiversitet i pasur në zonën përgjatë lumenjve dhe rrugëve në fushat bujqësore.

***Konkluzion :***

*Përkundër faktit që është komuna më e vogël në Kosovë, Mamusha me pozitën e saj gjeografike , burimet natyrore dhe klimë të këndshme ka kushte të favorshme për zhvillimin ekonomik. Ajo mund të përfitojë nga distanca e shkurtër me qendrat komunale fqinje që mundëson një bazë të mirë zhvillim dhe bashkëpunim të ardhshëm. Afërsia me autostradën siguron një qasje të lehtë në tregjet ndërkombëtare dhe mundësi për të zhvilluar një bashkëpunim të mirëfilltë ndërkufitar.*

## 1.2 DEMOGRAFIA DHE SITUATA SOCIO-EKONOMIKE

Të dhënat e paraqitura më poshtë i referohen të dhënave zyrtare te Entit të statistikave të Kosovës, *"Popullsia, ekonomitë familjare sipas vendbanimeve dhe organizimit territorial të Kosovës deri në vitin 2008". Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë nga viti 2011 dhe anketa e ekonomive familjare (2010).*

### 1.2.1 Popullsia

Regjistrimi i fundit i popullatës ishte bërë më 2011, për herë të parë për Mamushën si një komunë në vete. Në mënyrë që të krijohet një ide e evoluimit të vendbanimeve në kuptimin e rritjes së popullatës ndër vite, në tabelën e mëposhtme janë prezantuar të dhëna nga viti 1945 deri më 2011.

Gjatë diskutimit të të dhënave ne duhet të kujtojmë se këto të dhëna janë marrë nga burime të ndryshme dhe kriteret bazë nuk janë të ditura. Prandaj është e vështirë ti referohemi evolucionit si një trend i zhvillimit.

Megjithatë, siç tregon tabela ka një rritje konstante të popullsisë. Nga të dhënat në tabelën 1. Popullata prej vitit 1948-1953 është rritur për 11% (përafërsisht 2.2 % në vit), nga vitet 1953-1961 është rritur 6% (ose përafërsisht 0.75% në vit), nga 1961-1971 është rritur për 28 % (pse përafërsisht 2.8% në vit), nga viti 1971-1981 është rritur 35% (përafërsisht 3.5% në vit ) dhe prej vitit 1981-1991 popullata është rritur për 20% (përafërsisht 2% në vit). Megjithatë, nga viti 1991 deri në vitin 2011 numri i popullatës është shtuar për 67 % (ose 3.35% në vit ). Nga të dhënat e mësipërme mund të shihet se rritja më e madhe e popullsisë ishte në periudhën mes viteve 1991-2011.

| **Nr** | **Vendbanimi** | **Popullsia** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991[1] | 2010[2] | **2011[3]** |
| **1** | **Mamushë** | **1,352** | **1,500** | **1,590** | **2,038** | **2,752** | **3,297** | **4234** | **5,507** |

***Figura 4.Popullsia nga 1948 deri 2011***

Sa i përket Shërbimeve Administrative Komunale, Një zyre e regjistrimit civil është hapur në ndërtesën komunale më 22 Maj 2009. Së bashku me certifikatat e lindjes , banorët tashmë mund të marrin edhe dokumente tjera personale siç janë letërnjoftimet dhe pasaportat. Ofrimi i shërbimeve si regjistrimi i automjeteve dhe dhënia e patentë shoferëve nuk ka filluar ende [4].

**Dendësia e popullatës:** sipërfaqja e përgjithshme e territorit të komunës së Mamushës është 10.94 km² me dendësi të popullatës prej 503.4 banorë në /km² (e llogaritur për numrin e popullatës të nxjerrë nga

[1] *Source: Statistical office of Kosovo - Evaluation of the Federal Statistical Office of Yugoslavia*
[2] *Source: Field survey – Un-Habitat and Municipality, July 2010*
[3] *Source: Statistical Agency of Kosovo – Kosovo Census 2011*
[4] *Source: Profile of Mamusha/Mamuša municipality – OSCE – 2009*

Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë më 2011). Kjo shifër tregon se dendësia e popullatës në Mamushë është më i lartë se dendësia mesatare në Kosovë, që është (177.4 banorë /km²)[5].

*Popullsia në bazë të përkatësisë etnike:* ***Komuna e Mamushës është e banuar kryesisht nga tri përkatësi etnike , prej të cilëve 93% janë Turq , 6% Shqiptarë dhe 1% Romë, Ashkali apo Egjiptas (RAE[6]).***




***Figura 5Përbërja etnike e Komunës***




***Figura 6. Struktura e moshës në komunë***

Gjendja e ekonomive familjare:Sipas tabelës së prezantuar më poshtë Mamusha ka 566 ekonomi familjare me ç'rast më tepër se 40% e ekonomive familjare kanë më shumë se 10 + anëtarë. Një fakt që duhet theksuar është se rreth 21% të ekonomive familjare në Mamushë bien nën shifrat e mesatares se MEFK (mesatarja e ekonomive familjare te Kosoves (MEFK) që është 5.85 anëtarë) dhe ky është një trend në (shih figurën 8 ).

| Vendbanimi | Ekonomite familjare | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 1948 | 1953 | 1961 | 1971 | 1981 | 1991[7] | 2008 | 2010[8] | **2011[9]** |
| **Mamushe** | **183** | **198** | **209** | **220** | **263** | **334** | **403** | **453** | **566** |

***Figura 7. Ekonomite familjare nga 1981 deri 2011***

| Ekonomite familjare sipas numrit te antareve | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. I antareve | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 + | Total |
| Nr. I ekonomive familjare % | 0.2 | 1 | 2.8 | 6.5 | 11 | 12 | 11 | 6.9 | 6.2 | 42.4 | 100 |

***Figura 8. Household structure[10]***

| Settlement | Households per Housing Unit | | |
|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | **3+** |
| *Mamusha* | *461* | *43* | *6* |

***Figura 9. No of household per housing unit[11]***

5 *Source : Spatial Plan of Kosovo 2010-2020*
6 Burimi *: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, Prill*
7 Burimi: *Agjencia e Statistikave të Kosovës - Vleresimi i Entit Statistikor Federal i Jugosllavise*
8 *Burimi: Hulumtimi ne teren – UN-Habitat-i dhe Komuna e Mamushës, Korrik 2010*
9 Burimi *: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, Prill 2011*
10 *Source: Kosovo Statistical Agency – Kosovo Census, April 2011*

### *1.2.2 Situata Sociale*

**Punësimi dhe papunësia**: në komunën e Mamushës numri i përgjithshëm i popullsisë në moshë pune (15 deri 64 vjet ) është rreth **3440**, numri i popullatës ekonomikisht aktive është [12] rreth **1216**, prej të cilëve 97% janë të punësuar, 1.1% ka punuar por tash është e papunë , 0.7% e papunë dhe nuk ka punuar kurrë , 0.9% e papunë duke pritur që të filloj punën, përderisa numri i popullatës ekonomikisht jo aktive është rreth [13] **2224** 65% e numrit të përgjithshëm të moshës së punës.

Popullata ekonomikisht joaktive përfshin gratë e te gjitha moshave të cilat kujdesen për shtëpinë apo familjen. Kjo është si rezultat i të qenurit një komunë rurale, ku mundësitë e punësimit kanë bazë kryesisht familjare (në bujqësi dhe bizneset e ndërlidhura me bujqësi) pothuajse të gjitha femrat anëtarë të moshës së punës nuk janë zyrtarisht të punësuara , dhe në vend të kësaj marrin detyra në kuadër të ekonomisë familjare dhe aktiviteteve shtesë në ferma. Kjo qon në një pabarazi të gjerë ndërmjet gjinive në lidhje me fuqinë punuese se sa që perceptohet në nivelin e Kosovës.

Sa i përket popullatës ekonomikisht jo aktive, 18% e vijojnë shkollën dhe pjesa tjetër është e pensionuar ose nuk punon për arsye tjera. *(shih figurën 10)*

**Popullsia ekonomikisht jo aktive sipas arsyes qe nuk punon ne javen para rregjistrmit**

| GRUPMOSHAT 5 VJECARE (15-19; …; 64) | Arsyeja prse nuk punon | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shkollohen (%) | | Kujdesen per familjen (%) | | Te pensionuar (%) | | Marrin pension apo te hyra kapitale (%) | | Arsye tjera (%) | | Total |
| Gjinai | Mash | Fem | Mash | Fem | Mash | Fem | Mash | Fem | Mash | Fem | |
| 15 – 19 | *37.4* | 29 | 2 | 22.4 | 0 | 0 | 0 | 0.2 | 6.7 | 2.3 | 483 |
| 20 – 24 | 14 | 7.4 | 4 | 58.7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 12.9 | 3.0 | 353 |
| 25 – 29 | 1.5 | 0.7 | 2.2 | 79.7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13.4 | 2.5 | 275 |
| 30 – 34 | 0 | 0 | 1.6 | 84.8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 12 | 1.6 | 251 |
| 35 – 39 | 0 | 0 | 2.2 | 87.0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 9.4 | 1.4 | 226 |
| 40 – 44 | 0 | 0 | 2.4 | 80.0 | 0.6 | 0 | 0 | 0.6 | 14.6 | 1.8 | 164 |
| 45 – 49 | 0 | 0 | 1.4 | 82.8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 13.6 | 2.2 | 140 |
| 50 – 54 | 0 | 0 | 2.2 | 76.3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 20.5 | 1.0 | 93 |

[11] *Source: Kosovo Statistical Agency – Kosovo Census, April 2011*
[12] Burimi *: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, Prill 2011*
*Ekonomikisht aktive: Personat e të dyja gjinive të një moshe të caktuar, që ofrojnë fuqinë punëtore në tregun e punës për aktivitetet prodhuese (të cilët e kanë kaluar kufirin prodhues të sistemit), gjatë një periudhe specifike të referencës. Kjo përfshin të gjithë personat që I plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e të punësuarve( të punësuar apo vetëpunësuar) ose të papunësuar.*
[13] Burimi *: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, Prill 2011*
*Ekonomikisht jo aktiv: Personat që nuk konsiderohen të punësuar apo të papunësuar gjatë periudhës së observimit siç janë : nxënësit, studentët, shtëpiaket, pensionistët, personat në shërbimet e detyrueshme ushtarake etj.*

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 55 – 59 | 0 | 0 | 3.5 | 73.0 | 1.0 | 0 | 1.0 | 1.0 | 18.0 | 2.5 | 123 |
| 60 – 64 | 0 | 0 | 7.0 | 60.0 | 3.5 | 0 | 5.0 | 1.6 | 22.0 | 0.9 | 116 |
| **TOTAL** | | | | | | | | | | | **2224** |

***Figura 10.Popullata ekonomikisht jo aktive sipas arsyes së papunësisë* [14]**

**Te hyrat:** Sa i përket gjendjes ekonomike të banorëve të Komunës, për shkak të luhatjeve të fitimeve të bujqve të vetëpunësuar është vështirë që të llogariten të ardhurat e tyre mesatare. Sipas anketës në terren të 2010, prej atyre që ju përgjigjen kësaj pyetjeje, shumica e ekonomive familjare deklaruan të ardhura mesatare prej 200 eurosh në muaj, megjithatë 32% e ekonomive familjare deklaruan të ardhura më të ulëta se kjo. Të ardhurat e ekonomive familjare po ashtu plotësohen edhe nga mbështetja financiare nga diaspora.

| FITIMET MUJORE TË EKONOMIVE FAMILJARE | PËRQINDJA |
|---|---|
| Nën 200 euro në muaj | 32% |
| 200 euro në muaj | 55% |
| *Mbi 200 euro në muaj* | *13%* |

***Figura 11. Të ardhurat mujore të ekonomive familjare*[15]**

**Shkalla e varfërisë dhe asistencës sociale**: * Në komunën e Mamushës është themeluar kohëve të fundit Zyra për mirëqenie sociale nën Departamentin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Njësia përbëhet nga një koordinator dhe një zyrtar. Niveli i varfërisë, është përcaktuar në bazë të numrit të familjeve që marrin asistencë sociale, e cila ende jepet nga komuna e Prizrenit. Të dhënat e marra nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale tregojnë se në vitin 2011 rreth 22 familje kanë marrë ndihmë sociale. Bazuar në numrin e familjeve që marrin asistencë sociale është vlerësuar se norma mesatare e varfërisë në komunë është 4.0%.

**Migrimi :** Për shkak të faktit se Mamusha është një komunë e sapo themeluar, nuk ka të dhëna të mjaftueshme zyrtare lidhur me migrimin brenda dhe jashtë komunës. Pasi që komuna është e përberë nga një vendbanim për këtë arsye ajo nuk është përballur me migrimin nga zonat rurale në ato urbane. Përveç kësaj, shumë njerëz nga komuna e Prizrenit janë të punësuar në Mamushë dhe udhëtojnë çdo ditë nga Prizreni në Mamushë dhe anasjelltas.

Sipas të dhënave të marra nga Regjistrimit i popullsisë në Kosovë të vitit 2011[16] Mamusha është brenda atyre komunave që kanë normë të ulët të imigracionit (<5%), ndërsa shkalla e migrimit të jashtëm është më e ulët se <10%.

Popullsia e Mamushës imigron kryesisht në Turqi, për arsim, punë dhe për t`i siguruar familjeve kushte më të mira të jetesës dhe mjedisit.

[14] Burimi *: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë, Prill 2011*
[15] *Burimi*: *Hulumtimi ne teren – UN-Habitat-i dhe Komuna e Mamushës, Korrik 2010*

Organizimi i shoqërisë civile: Komuna e Mamushës ka disa Organizata Joqeveritare (OJQ) apo shoqatat që kryesisht merren me aktivitete politike, kulturore, arsimore, bujqesore dhe te zhvillimit ekonomik. Partite politike qe ishin prezente ne vitin 2011 jane: PDK, KDTP dhe KTB. Disa nga Organizatat e Mamushës janë " Shoqata Kulturore Artistike "Asik Ferki" , Shoqata Rinore " Alperenler", Shoqata per arsim dhe kultur " Shoqata e Fermerëve", Shoqata e afaristëve" dhe Shoqata Kulturore Artistike " Asik Ferki".

The following associations are operating in Mamuşa/Mamushë/Mamuša: youth association "Alperenler", cultural and artistic association "Asik Ferki", association for education and culture "Mabed", aid association " Gönüleli", two farmers associations, business associations, and beekeepers association[16].

### *1.2.3 Infrastruktura dhe shërbimet sociale*

Shërbimet e shëndetësisë primare janë të menaxhuara nga Drejtoria Komunale e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa shërbimet e arsimit menaxhohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit.

**Shërbimet shëndetësore:** Që nga Janari i vitit 2007 kujdesi shëndetësor parësor i Mamushës është ndarë nga kujdesi shëndetësor parësor i Prizrenit. Tani, kujdesi shëndetësor parësor në Mamushë menaxhohet nga Departamenti Komunal i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet në Qendrën kryesore të Mjekësisë Familjare, e cila ndodhet në qytetin e Mamushës. Ndërtesa e Qendrës së parë të Mjekësisë Familjare u ndërtua në vitin 2002 nga KFOR-i Turk[17]. Në fund të vitit 2008 Qendra e re e Mjekësisë Familjare u bë funksionale, ndërtimi i së cilës u financua nga Ministria e Shëndetësisë.

Qendra ka të punësuar gjithsej 17 punonjës[18], duke përfshirë një mjek specialist, dy mjekë të përgjithshëm, një dentist, një teknik i lartë, një teknik i farmacisë, dy teknik laboratori, 6 infermiere/ teknikë medicinal dhe dy punonjës administrativë.

Qendra është e hapur nga ora 7 e mëngjesit deri në orën 9 të mbrëmjes dhe ofron shërbime të kujdesit shëndetësor parësor të përgjithshëm, shërbime laboratorike, dentare dhe vaksinim ndërsa për shërbimet e kujdesit shëndetësor dytësor, banorët i drejtohen Spitalit Rajonal të Prizrenit.

Qendra ekzistuese e përmbush kriterin e Draft Planit Hapësinor të Kosovës, 1 mjek dhe 2 motra medicinale për 2000 banorë[19].

**Shërbimet Arsimore:**Sistemi arsimor në komunën e Mamushës është i organizuar në tre

nivele: parashkollor, fillor, mesëm i ulët dhe mesëm i lartë, të cilat nivele zhvillohen në dy objekte shkollore. Sistemi i arsimit menaxhohet nga Departamenti Komunal i Arsimit.

---

[16] *Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës - Regjistrimi i Kosovës, Prill 2011, "Një analizë e lëvizjeve ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale të popullit të Kosovës - botuar më 2012" faqe. 8 dhe faqe. 14*

[16] *Burimi:KK Mamushë, 2012*

[17] *Burimi: Profili i Zhvillimit Hapësinor dhe Analiza e Situatës së komunës së Prizrenit, 2007, fq. 33*

[18]*Burimi:KK Mamushe, 2010*

[19] *Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+*

*Niveli i parashkollor (çerdhe*), në komunë e Mamushës nuk ka çerdhe për fëmijët deri në 4 vjeç, Komuna duhet të merr në konsiderim sigurimin e objektit apo hapësirës për kopsht. *Niveli parashkollor* që nga Shtatori i vitit 2010 këto klasë janë vendosur në objektin e shkollës së re "Hacı Ömer Lütfü''. Mësimi zhvillohet në gjuhën turke dhe gjuhën shqipe, ku rreth 15% i femijeve mesojne ne gjuhen Shqipe dhe te tjeret ne gjuhen Turke, mesimi mbahet nga tre edukatorë.

*Niveli fillor dhe mesëm i ulët,* deri ne vitin akademik 2009/2010 si shkollë fillore ka qenë shkolla "Haci Omer Lutfu", por që nga Shtatori i vitit 2010 mësimi mbahet në objektin e ri të shkollës fillore "Hacı Ömer Lütfü". Në këtë shkollë zhvillohet arsimi fillor dhe i mesëm i ulët, ku rreth 92% mesojne në gjuhën Turke kurse te tjeret në gjuhën Shqipe. Shkolla frekuentohet nga fëmijët me përkatësi etnike turke, shqiptare dhe rome. Në këtë shkollë gjithashtu janë akomoduar edhe 5 fëmijë me nevoja të veçanta. Shkolla ka 29 mësimdhënës për lëndët në gjuhën turke (si komunitet shumicë në komunë), gjë që nuk plotëson kriteret për raportin nxënës/mësimdhënës[20] të marrë nga Udhëzimi Administrativ 18/2009, që është 21.3 nxënës/1 mësimdhënës, ndërsa për mësimin në gjuhën shqipe (si komunitet pakicë në komunë) janë 14 arsimtarë, që plotëson kriterin 14.2 nxënës/1 mësimdhënës.

*Niveli i mesëm i lartë*, shkolla e nivelit të mesëm në Mamushë "Ataturk" filloi të funksionojë në vitin 2002 dhe ka 2 degë, në degën e shkencave natyrore dhe atë të shkencave shoqërore.

Kjo shkollë u ndërtua nga KFOR-i Turk në vitin 2003 dhe ka 5 klasa ku mësimi mbahet në gjuhën turke. Në këtë shkollë zhvillohet mësimi i arsimit të mesëm të përgjithshëm (gjimnazi) dhe mjekësor si pjesë e shkollës së mesme të mjekësisë të Prizrenit[21]. Shkolla ka 7 mësimdhënës, që plotëson kriterin për raportin nxënës/ mësimdhënës[22].

Personeli i shkollës është i përbërë nga punonjës nga Mamusha dhe atyre që vijnë nga komuna fqinje e Prizrenit. Duke pasur parasysh kualifikimin rreth 46% (shumica) janë me diplomë të shkollës së mesme, 36% janë me shkallën e 4 vjet universitet, rreth 4% janë me diplomë Bachelor. (*Shih figurën 14*)

| Nr | Niveli | Nr. i nxenesve | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Femra | Meshkuj | Total |
| 1 | Parashkollor | 24 | 36 | 60 |
| 2 | Fillor | 442 | 454 | 896 |
| 3 | I mesem | 66 | 97 | 163 |
| 4 | Femijet me nevoja te vecanta | 3 | 2 | 5 |
| | **Total** | **1124** | | |

| Niveli | | Gjuha | |
|---|---|---|---|
| | | Turke | Shqip |
| Parashkollor | | 52 | 8 |
| Fillor dhe i mesem i ulet | I-V | 472 | 48 |
| | VI-IX | 349 | 75 |
| | Femijet me nevoja te vecanta | 5 | |
| Mesem | X-XII | 163 | |

***Figura 12. Nxënësit në të gjitha nivelet e arsimit*[23]**
***Figura 13. Struktura e nxënësve në bazë të etnisë***

[20] *Burimi: Udhëzimi Administrativ 18/2009*
[21] *Burimi: Profili i Komunës së Mamushës – OSBE – 2009*
[22] *Burimi: Udhezimi Administrativ 18/2009*
[23] *Source: Mamuşa/ Mamusha/Mamuša Municipality, 2010*

| | **Univerzitet 4 vjecar** | | **Univerzitet Bachelor** | | **Shkolle e larte** | | **Shkolle e mesme** | | **Shkolle fillore** | | **Total** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Femra | Tot. | Femra | Tot. | Femra | Tot. | Femra | Tot. | Femra | Tot. | Femra | Tot. |
| **Fillor** | 10 | 14 | 1 | 2 | 16 | 26 | 1 | 1 | 0 | 3 | 28 | 46 |
| **Mesem** | 3 | 5 | 0 | 0 | 1 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 7 |
| **Drejtor** | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| **Sekretar** | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 |
| **Stafi mbeshtetes** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 5 |

***Figura 14. Kualifikimet e stafit të shkollave***[24]



***Figura 15. Shkolla Haci Lutfi Pacarizi***

Sa i përket analfabetizmit të dhënat e marra nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2011[25] tregon se rreth 1.3% e popullsisë së moshës 10 vjeçar dhe më të mëdhenj nuk dinë shkrim dhe lexim e cila është më e ulët sesa përqindja e Kosovës e cila është 3.8%.Përqindja më e lartë e analfabetizmit është e pranishme tek popullsia në mes të moshave 60 deri në 79 vjeç.

Të dy shkollat nuk kanë salla të sportit brenda tyre, por kanë fusha sporti në oborret e tyre. Kohëve të fundit është ndërtuar një fuhsë e futbollit afër shkollës së re fillore, e financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

**Ndërtesat fetare:** Në Mamushë ekzistojnë dy xhami, ku njëra është e vendosur në qendër të vendbanimit dhe një që është përfunduar në vitin 2012 e cila gjendet në pjesën jugore të komunës. Këto dy xhami përmbushin nevojat për banorët.

[24] *Source: Mamuşa/ Mamusha/Mamuša Municipality, 2010*
[25] *Source: Statistical agency of Kosovo – Kosovo Census, April 2011*

**Hapësirat publike, Kultura, Sporti dhe Varrezat:** Institucioni i vetëm kulturor në Mamushë është shtëpia e kulturës e cila është përdorur për shumë qëllime multi për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe si një librari.

Për më tepër, si ngjarje me rëndësi kulturore është “ Festivali i Domates” që festohet që nga viti Korriku i vitit 2009. Qëllimi i festivalit është mbledhja e prodhuesëve dhe tregëtarëve nga Kosova dhe shtetet e regjionit si dhe promovimi i industrisë së domates në Mamushë. Festivali është mjaft popullor ku zhvillohen vallëzimet tradicionale.

Komuna ka 3 parqe, dy hapësira gjelbëruese të shfrytëzuara nga qytetarët për piknik, dhe një numër të fushave te sportit. Këto hapësira mbulojnë vetëm 4.1[26]% të territorit të komunës të gjithë sipërfaqes së komunës, nga e cila vetëm 0.1% mirëmbahet.

Parqet gjenden në qendër të qytetit të Mamushës, përgjatë lumit afër Ndërtesës së Kuvendit Komunal. Parqet janë ndërtuar pas vitit 2000, ku Parku Ankara dhe ai Fëmijëve është financuar nga komuna e Ankarës dhe Parku Bregdetar u financua nga Ministria e Qeverisjes Lokale. Parku i Fëmijëve ka lojërat për fëmijë që përdoret nga fëmijët e vegjël. Përveç fëmijëve të vegjël ky park nuk përdoret nga moshat tjera. Ndërtimi i parkut të ri është financuar nga Komuna dhe fondet e BE-së dhe ka një lokal për qaj po që nuk është duke operuar ende. Parqet janë pasuri e madhe e Komunës, E vetmja brengë është se parqet janë shumë të vogla dhe u mungojnë drunjët e mëdhenj, të cilët do të kishin krijuar hije gjatë ditëve të verës.

Sipërfaqet e gjelbra që përdoren për piknik janë prone private, dhe ndonjëherë përdoren nga banorët për rekreim, posaqërisht nga nxënësit dhe mësimdhënësit. Megjithatë, këto sipërfqaqe të hapura nuk plotësojnë nevojat e qytetarëve, pa përfshirjen e ndonjë objekti public, apo pa aktivitetet e planifikuara për mirëmbajtje.

Në Mamushë sporti më i popullarizuar është futbolli. Komuna ka tre terene të hapura të sportit, dy janë terene të futbollit dhe një I basketbollit. Njëri nga terenet e futbollit që ndodhet ndërmjet Shtëpisë së Kulturës dhe Shkollës së re fillore, është ndërtuar menjëherë pas luftës. Kurse dy tjerat janë ndërtuar në të një njëjtën kohë me objektin e shkollës së mesme të lartë në vitin 2002 nga KFOR-i Turk. Aktualisht nuk ka terene të mbyllura të sportit.

Tereni i futbollit dhe i basketbollit brenda oborrit të shkollës përdoret nga nxënësit e shkollës dhe gjatë pushimeve përdoret nga rinia. Megjithatë, këto terrene janë të kualitetit të ulët dhe kërkojnë përmirësime.

Për më tepër, për shkak të përdorimit të shpeshtë nga ana e qytetarëve tereni i futbollit afër shtëpisë së kulturës dhe shkollës është në gjendje të keqe. Për të përmirësuar gjendjen e tereneve dhe për të plotësuar nevojat e qytetarëve, Kuvendi Komunal ka filluar me punët regjeneruese.

Në kuadër të punëve regjeneruese komuna e Mamushës ka filluar të hartoj projektin për terenet e hapura dhe të mbyllura të standardit Europian. Tereni i futbollit në të hapur ndodhet afër Shtëpisë së

[26] *Burimi: KK Mamushë, 2010*

Kulturës. Realizimi I këtij tereni është financuar nga Ministria e Komuniteteve dhe për Kthim. Aktualisht vetëm ky teren është përfunduar. Kurse tereni i mbyllur i sportit do të financohet nga Komuna Turke Büyükçekmece. Realizimi i këtyre dy projekteve do të rris kualitetin e jetës së qytetarëve, pasi që në Mamushë nuk ka salla të gjimnastikës nëpër shkolla dhe në përgjithësi ka mungesa hapësirave publike.

**Varrezat:** Në Mamushë aktualisht ka katër varreza, duke përfshirë edhe varrezat e vjetëra

që ndodhen në juglindje (Shih pjesën e Trashëgimisë Kulturore)

Tre varrezat tjera u themeluan pas zgjerimit të Mamushës në veri dhe ende përdoren. Kur janë themeluar ndodheshin në dalje të Mamushës pro për shkak të zgjerimit të vazhdueshëm, varrezat janë në qendër të komunës. Varrezat janë rreth 150 vjeçare me disa gur varri të vjetër dhe ndodhen në të dyja anët e rrugës (kryesore) lokale.Njëra varrezë i përket vetëm banorëve romë, ndërsa dy të tjerat i përkasin banorëve turq dhe shqiptarë.

Në varreza gjenden gurë varri shumë të vjetër. Deri në vitin 2005 varrezat nuk mirëmbaheshin dhe gjatë vitit 2005 persona privatë i rrethuan ato me shufra hekuri. Në vitin 2009 Komuna e Mamushës i përfundoi muret e gardhit. Në të njëjtin vit, Komuna e Mamushës ndërtoi shtigje mes varrezave për të pasur qasje më të lehtë.

Të rinjtë e Mamushës të cilët janë në moshë për punë, çdo ditë e më tepër janë të interesuar që të braktisin komunën për arsye të arsimit më të lartë dhe pas përfundimit të studimeve ata qëndrojnë nëse vendi i studimeve i ofron më tepër mundësi, ndërsa disa të tjerë shkojnë në komuna të tjera të Kosovës ose jashtë vendit për mundësi më të mira punësimi.

Duke marrë parasysh se Mamusha është një komunë e re, shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë të kënaqshme, por ende është e nevojshme që të pun. ohet për avancimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit.

Në aspektin e arsimit në komunë ka një përqindje më të ulet të vajzave që frekuentojnë shkollën në krahasim me djemtë

Kështu që avansimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore si dhe inkurajimi i vajzave të vijojnë shkollimin do të jetë njëra nga sfidat e Mamushës.

**Mediat lokale:** nuk ka radio apo TV kanale lokale në komunën e Mamushës apo ndonjë gazetar që i shërben medies lokale. Prandaj, popullata kryesisht informohet nëpërmjet medieve publike dhe private të Kosovës.



*Figura 16.Parku Ankara*



*Figura 17. Varrezat*

***Përmbledhje***

*Si rezultat i situatës të theksuar më lart, situata e punësimit në Mamushë është e kënaqshme pasi që shumica e familjeve janë 'të vetëpunësuar' në sektorin e bujqësisë. Megjithatë, komuna po përballet me kërkesa për mundësitë e punësimit alternativ për të akomoduar ambiciet e të rinjve që kanë studiuar apo studiojnë jashtë vendit (kryesisht Turqi) dhe nuk janë të interesuar për t'u angazhuar në aktivitete bujqësore.*

*Për sa i përket infrastrukturës së shërbimeve shëndetësore dhe arsimore ekziston nevoja për avancimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të stafit, pajisjeve dhe objekteve. Për më tepër, ekziston nevoja për një hapësirë për një kopsht të fëmijëve dhe të objekteve për të moshuarit.*

*Edhe pse ka përmirësime në lidhje me braktisjen e shkollës nga vajzat kjo çështje është ende evidente, prandaj ekziston nevoja për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në shkollë dhe për të lehtësuar mundësitë e tyre për punësim në të ardhmen.*

*Në mënyrë që të sigurojë kushte cilësore të jetesës për banorët, Komuna ka krijuar hapësira për sport, rekreacion, kulturë me ndërtimi i hapësirave sportive, parqeve si dhe shtëpisë së kulturës, mirëpo mungon një objekt për argëtimin e të rinjve.*

### *1.2.4 Vlerësimi i Situatës Aktuale*

**Përparësitë**

- Popullsia e re shumë-etnike
- objektit adekuat shëndetësor
- Objektet adekuate shkollore
- Zhvillimi i shërbimeve të arsimit
- Mbështetja nga komunat simotra turke dhe bashkëpunimi me ato.
- Qytetarët që jetojnë në shtëpitë në pronësi private
- Disa aktivitete kulturore në dispozicion
- Mundësi për arsim (duke e përjashtuar universitetin)
- Norma e rritur e vajzave që ndjekin shkollat

**Mundësitë**

- Politikat e planifikimit social
- Pjesëmarrja e stafit mjekësor dhe mësimdhënësve të shkollave në trajnime të ndryshme për ngritje profesionale
- Ndihma financiare nga donatorët
- Ndihma teknike nga komunat simotra turke për ekipin komunal te planifikimit
- Numri i ngritur i profesionistëve komunal
- Ndërtimi i qendrës sportive
- Hapja dhe riaktivizimi i fabrikave
- Eksporti i produkteve në tregjet e huaja
- Kufizimi i migrimit
- Mundësi për të studiuar në universitetet e Turqisë

**Dobësitë**

- Normat e ulëta e të ardhurave
- Shkalla e lartë e papunësisë në mesin e popullsisë në moshë pune dhe të grave
- Migrimi i popullsisë në moshë të re në qytetet e tjera të Kosovës dhe jashtë Kosovës
- Mungesa e profesionalistëve në të gjitha fushat
- Përfshirja e pamjaftueshme e femrave në jetën publike
- Mungesa e zhvillimit /kontrollit të ndërtimeve
- Shërbimet shëndetësore të pamjaftueshme (mungesa e mjekëve, mungesa e gjinekologu)
- Shkalla e të kufizuara përfundimit të arsimit

**Rreziqet**

- Mungesë/ reduktim e përkrahjes financiare nacionale dhe ndërkombëtare për zhvillimin e ekonomisë do të kufizoj zbutjen e papunësisë dhe çështjeve të varfërisë
- Rënie e cilësisë së jetesës

### *1.2.5 Sfida*

Të rinjtë e Mamushës të cilët janë në moshë për punë, çdo ditë e më tepër janë të interesuar që të braktisin komunën për arsye të arsimit më të lartë dhe pas përfundimit të studimeve ata qëndrojnë nëse vendi i studimeve i ofron më tepër mundësi, ndërsa disa të tjerë shkojnë në komuna të tjera të Kosovës ose jashtë vendit për mundësi më të mira punësimi.

Si në mbarë Kosovën shërbimet shëndetësore dhe arsimore kanë nevojë që të përmirësohen. Duke marrë parasysh se Mamusha është një komunë e re, shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë të kënaqshme, por ende është e nevojshme që të punohet për avancimin e vazhdueshëm të këtyre shërbimeve dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit.

Në aspektin e arsimit në komunë ka një përqindje më të ulet të vajzave që frekuentojnë shkollën në krahasim me djemtë

Kështu që avansimi i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore si dhe inkurajimi i vajzave të vijojnë shkollimin do të jetë një nga sfidat e Mamushës.




*Harta 1. Dendesia e popullsise*




*Harta 2.Infrastruktura sociale dhe zonat e hapura*

## *1.3 ZHVILLIMI EKONOMIK*

### *1.3.1 Situata ekonomike*

Në komunën Mamushës niveli i papunësisë në kuadër të ekonomisë aktive të popullsisë është më e ulët se sa në nivel kombëtar e cila është rreth 45%[27] .

Kjo i atribuohet nivelit të lartë të 'vetëpunësimit' të banorëve në sektorin e bujqësisë. Shumica e aktivitetit ekonomik të Komunës zhvillohet nga prodhimtaria bujqësore dhe nga industria që ka të bëj me bujqësinë. Megjithatë për momentin ka pak investime në këta sektorë të rëndësishëm për të nxitur zhvillimin.

Mamusha ka lidhje me komunat simotra në Turqi dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (TIKA) gjithashtu ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për zhvillimin e ekonomik duke bërë përmirësime të infrastrukturës në Komunë siç janë rregullimi i rrugëve dhe trotuareve dhe kompletimi i shkollës së re fillore. Edhe Ministria e Shëndetësisë e ka mbështetur përmirësimin e situatës ekonomike në Komunë duke ndërtuar një qendër të re mjekësore, e cila tani punëson 17 persona.

Sektorët e punësimit: Si një komunë rurale, industria bujqësore dhe nga industria që ka të bëj me bujqësinë, janë kryesisht sektorët e vetë-punësimit. Megjithatë ka edhe sektorë të punësimit në Mamushë të përbërë nga sektori publik dhe bizneset e vogla.

| **INDUSTRIA KRYESORE** | **Totali** *(%)* |
|---|---|
| Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria | 55.0 |
| Industria përpunuese | 3.5 |
| Ndërtimi | 13.4 |
| Tregtia me shumicë dhe me pakicë, riparimi i motorëve të automjeteve, motoçikletave dhe mallrat personale dhe shtëpiake | 15.8 |
| Hotelet dhe restoranet | 1.0 |
| Transporti, magazinimi dhe komunikacioni | 1.5 |
| Ndërmjetësimi financiar | 0.3 |
| Pasuritë e patundshme, dhënia me qira dhe aktivitet biznesore | 0.5 |
| Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi i detyrueshëm social | 3.9 |
| Arsimi | 2.5 |
| Shëndetësia dhe puna sociale | 1.0 |
| Komunitetit tjetër, social dhe aktivitetet personale të shërbimit | 1.6 |

***Figura 18. Punësimi në bazë të industrisë*** [28]

[27] *Source: Statistical agency of Kosovo – Kosovo Census, April 2011*

Sipas *figurës 18* në komunën e Mamushës sektori më i madh i punësimit është bujqësia dhe industria që ka të bëj me bujqësinë ku rreth 55.0% e pozitave të punësimit janë të ofruara nga ky sektor.

Ekziston edhe një sektor aktual (kryesisht komercial) privat i punësimit i cili mbulon rreth 29%. Kjo është e orientuar drejt biznesit të vogël, me anketimin e bizneseve komercial në përgjithësi punësojnë më pak se 10 të punësuar. Primare për sektorin e biznesit të vogël është në tregtinë dhe shitjen e vajrave motorike dhe pjesët e automjeteve, të cilat janë të importuara kryesisht nga Turqia.

Sektori publik punëson rreth 10% duke përfshirë edhe vetë komunën, qendrën e shëndetit publik, postë, shkolla, stacionin e policisë dhe në shërbimin e zjarrfikësve. Megjithatë, sipas të dhënave komunale, disa pozicione të sektorit publik janë të mbushur nga të punësuarit që jetojnë jashtë Komunës, kryesisht nga Prizreni. Në *figurën 19* janë paraqitur llojet e veprimtarive ekonomike të zhvilluara në komunë.

| | | | ***Numri i objekteve*** | ***Kapaciteti*** | ***Viti i ndërtimit*** |
|---|---|---|---|---|---|
| ***INDUSTRI-PRODHIM*** | | | | | |
| **INDUSTRIA QË KA TË BEJE ME BUJQËSINË** | MULLI | Birlik | 1 | 850 ton | 1985 |
| | | Rizam | 1 | 850 ton | 1990 |
| | | jo operativ | 1 | | |
| | THASË | | 1 | 6 milion thasë | Ri- operativ 2012 |
| | FERMA | Bagëti | 3 | 148 kafshë | 2012 |
| | Ferma të pulave | | 1 | 50-60 Pula | 2010 |
| | Bletari | | 1 | | 2012 |
| **MATERIAL NDËRTIMOR** | Prodhimi i gypave të betonit | | 1 | | 1995 |
| | Xhama për vetura | | 1 | | 2007 |
| | **TOTALI** | | **11** | | |
| | | | | | |
| **PUNËTORI** | Zdrukthëtare | | 1 | | 1983 |
| | Raste të prodhimit të drurit | | 4 | 3 milion raste | 2007-2008 |

[28] *Source: Statistical agency of Kosovo – Kosovo Census, April 2011*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Prodhimi i dritare dhe dyerve nga Alumini dhe PVC- ja | 3 | | 2002-2010 |
| | Prodhimi i makinës për fabrika (objektet ndarëse) | 1 | | 1980 |
| | **TOTALI** | **9** | | |
| ***TREGETI*** | | | | |
| **AUTOMJETET** | Pjeset per automjete | 20 | | 1995-2011 |
| | Vajrat per automjete | 7 | | 1995-2010 |
| | Elektricist per automjete | 2 | | 2003-2012 |
| **USHQIMORE** | Market | 11 | | 1990-2012 |
| | Bukepjekes | 2 | | 1990-2012 |
| | BMishtore | 3 | | 1995-2009 |
| **TE TJERA** | Barnatore | 1 | | 2008 |
| | Barnatore bujqesore | 4 | | 1995-2011 |
| | Tekstili | 2 | | 2002-2010 |
| | Materialet ndertimore | 1 | | 2008 |
| | **TOTAL** | **53** | | |
| ***SHERBIMET*** | | | | |
| | | | | |
| **PUBLIKE** | Shkolla fillore | 1 | | |
| | Shkolla e mesme | 1 | | |
| | QKMF | 1 | | |
| | Posta | 1 | | |
| | Stacioni i policise | 1 | | |
| | Stacioni i zjarrfikesve | 1 | | |
| | Komuna | 1 | | |
| | Shtepia e kultures | 1 | | |
| **PRIVATE** | Kafe dhe cajtore | 6 | | 2002-2012 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Qebaptore | 4 | | 2001-2012 |
| | Internet kafe | 3 | | 2003-2010 |
| | Frizere | 5 | | 2002-2012 |
| | Servis automjetesh | 6 | | 1995-2011 |
| | Servis elektricisti | 2 | | 1995-2003 |
| | Shitore e vidhave | 1 | | 1993 |
| | Servisi per goma | 2 | | 2005-2009 |
| | Pompa te benzines | 5 | | 1993-2008 |
| | Shitore per xhama te automjeteve | 1 | | 2006 |
| | Shitoret instalime te ujit | 3 | | 1994-2002 |
| | Sherbimet e autobuseve | 2 | | 1993-2001 |
| | **TOTAL** | **48** | | |

***Figura 19. Aktivitetet ekonomike të zhvilluara në komunën e Mamushës***[29]

**Industritë bujqësore dhe ato që kanë të bëjnë me bujqësinë**: Shumica e fermave merren me kultivimin e kulturave bujqësore, dhe prodhimi kryesor është domatja.

Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë në Kosovë të vitit 2011[30] tregon se 441 e familjeve (që përfaqësojnë 78% të familjeve) kanë tokë, shumica e tyre i posedojnë ato.

Mamusha është e përbërë nga toka bujqësore me cilësi të mirë që është shumë e përshtatshëm për prodhimin e perimeve dhe prodhimit bimor.

Mamusha është prodhuesi dhe furnizuesi kryesor i domateve për tërë Kosovën. Të gjithë bujqit e komunës së bashku importojnë 8-10 kg të farës çdo vit nga Holanda, pasi që këto farëra janë më të përshtatshmet për klimën lokale dhe për kushtet e dheut. Cilësia dhe sasia e domates së prodhuar në Mamushë është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit,në vitin 2012 janë prodhuar 20250 ton domate. Kjo është arritur si rezultat i investimeve të bujqve në ngritjen e serrave, aktualisht në Mamushë rreth 170 ha tokë janë të mbuluara me serra. Serrat ofrojnë një ambient të brendshëm për të mbjellat, i cili u reziston të gjitha kushteve atmosferike. MBPZHR e inkurajon ketë dhe synon të bashkë-financojë investimet me 50% grante për blerjen e materialeve/ pajisjeve për serra. Megjithatë, për shkak të shpenzimeve të investimit në serra, për momentin shumica e bujqve po përdorin materiale plastike të cilat duhet të hiqen gjatë muajve të dimrit. Për ketë arsye koha e stinës së prodhimit nuk është zgjatur aq shumë deri më tani.

[29] *Burim: Komuna e Mamushës, 2013*
[30] *Burimi: Agjencioni Kosovar i Statistikave– Regjistrimi i popullsisë së Kosovës Prill 2011*

Kulturat e tjera bujqësore që rriten gjatë stinës në komunë janë trangulli, lakra, pjepri, shalqiri, specat (në pranverë) dhe spinaqi, qepët dhe marulet (në dimër). Bujqit janë duke menduar që të rrisin përdorimin e serrave, veçanërisht ato të llojit me xhama ose Perspex, që këto të mbjella në të ardhmen të japin rendimente edhe më të mëdha. Kultivohet edhe gruri dhe bimët foragjere, ndonëse ato janë kryesisht për nevoja personale ose si ushqim për bagëtinë.

Edhe hardhitë kultivohen përgjatë kreshtës më të lartë perëndimore të Komunës.

Në Mamushë vetëm 203 amvisëri mbajnë bagëti të cilat ruhen vetëm për nevoja familjare. Rreth 92% e familjeve posedojnë bagëti dhe lopë, 26% posedojnë shpend, 6% posedojnë hoje bletësh, dhe 3.4 % dele dhe dhi[31].

Lopët kryesisht mbahen për qumësht. Ky qumësht i mbulon nevojat e familjeve. Teprica e qumështit shitet në dyqanin e kooperativës lokale "Serdar" e cila e grumbullon të gjithë qumështin në Komunë dhe ua shet blerësve në supermarketet lokale në Prizren. Kjo sasi është rreth 4-5 tonë çdo ditë. Bujqit paguhen sipas kontributit të tyre me litra të qumështit. Megjithatë, me çmimet e tanishme të tregut, dhe me importimin në rajon të qumështit të përpunuar me afat të gjatë përdorimi, kjo nuk është gjithaq fitimprurëse.

Delet kryesisht shiten për mishin e tyre në tregjet lokale të rajonit. Para vitit 1999 numri i deleve ka qenë i lartë, megjithatë, pas luftës konkurrenca e mishit të importuar, mundësia e kufizuar për eksport, bashkë me mungesën madhe të transportit më automjete, të gjitha qojnë në një bllokim faktik të kësaj industrie në Mamushë.

Edhe industria që ka të bëj me bujqësinë ekziston në Mamushë. Ky sektor është i angazhuar në furnizimin me plehra, pesticide, makineri dhe pjesë për automjete.

Sipas Strategjisë për Zhvillim Rajonal, si një nga 6 komunat në rajonin e jugut, Mamusha do të ndikohet pozitivisht në të ardhmen për shkak të pozicionit të mirë gjeo-strategjikë të rajonit në Kosovë e cila është një perspektivë e mirë për zhvillimin strategjik dhe është një avantazh në kontekstin e integrimit evropian. Lidhje me autostradën dhe nëpërmjet saj me një port detar në njërën anë dhe me Serbinë në anën tjetër, e kombinuar me lokacionit gjeografike e cila kufizohet me Shqipërinë dhe IRJ të Maqedonisë do të sigurojë një qasje të lehtë në tregjet ndërkombëtare dhe për të zhvilluar bashkëpunimi ndërkufitar kuptimplotë.

[31] *Burimi: Agjencioni Kosovar i Statistikave– Regjistrimi i popullsisë së Kosovës Prill 2011*

***Përmbledhje***

*Sipas analizës, shtyllë kryesore për zhvillimin ekonomik të komunës është bujqësia, për shkak të faktit se pjesa më e madhe e komunës së Mamushës është e mbuluar nga toka e punueshme e kualitetit të lartë dhe angazhimit tradicionale të banorëve në aktivitetet bujqësore. Megjithatë, fermerët po përballen me probleme që lidhen me mungesën e sistemit të ujitjes dhe promovimin e produkteve vendore në tregun rajonal. Një problem tjetër është edhe mungesa e menaxhimit të ujërave të zeza dhe ndotja e lumit Toplluha që prek tokën e punueshme.*

*Ekziston një nevojë për aktivitete të tjera punësimi, në veçanti ato që synon të rinjtë që kërkojnë mundësi të tjera përveç prodhimit bujqësor.*

*Prandaj, ekziston një nevojë për trajnim të vazhdueshme, seminare, në fushën e biznesit dhe sigurimin e kredive dhe granteve në zhvillimin e këtyre aktiviteteve në të ardhmen.*

### *1.3.2 Vlerësimi i situatës aktuale*

**Përparësitë**

- Toka pjellore mjaft e përshtatshme për bujqësi
- Prodhimi i perimeve dhe prodhimi bujqësor (domate, lakër, shalqi, etj.) është përmirësuar me prezantimin e ujitjes dhe serrave
- Lidhje t forta me Turqinë
- Popullata e re e angazhuar dhe e aftësuar në aktivitetet bujqësore.
- Festivali i Domates është një stimulues i mirë ekonomik
- Tre mullinj gruri
- Industri e fortë që ndërlidhet me bujqësinë (gypa, blloqe çimentoje) si dhe tregtia me Turqinë për pjesë këmbimi për makina.
- Rruga për në Piranë dhe Suharekë

**Mundësitë**

- Zhvillimi i sektorit bujqësor nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të serave dhe e ujitjes dhe mbështetjes financiare
- Objektet për ruajtjen (frigorifer) e produkteve
- Zhvillimi i industrisë organike
- Zhvillimi i industrisë së ndërlidhur me bujqësinë
- Fuqizimi i marrëdhënieve tregtare me nivelin qendror
- Rikrijimi i tregjeve të mëhershme në rajonin e Ballkanit

**Dobësitë**

- Eksport i ulët i produkteve
- Mungesa e kooperativave të organizuara
- Mungesa e sistemit të ujitjes
- Papunësia e madhe
- Mungesa e ekspertëve bujqësor
- Tregu i bagëtisë  është i pa përkrahur
- Paraqitja e ndërtimeve në toka bujqësore
- Burimet ekzistuese të ujit dhe deponit joformale janë të pa menaxhuara dhe të ndotura
- Transporti për në tregjet e Prishtinës, si dhe eksporti dhe ruajtja e produkteve është e pamjaftueshme
- Mungesë e përkrahjes financiare për bujqit

**Rreziqet**

- Rritja e mëtejme e importeve në tregun Kosovar
- Mungesa e arritjeve të marrëveshjeve tregtare do të e vështirësoj shoqërimin në të ardhme
- Ndotja e tokës përmes burimeve të pa-menaxhuara do të reduktoj kualitetin e dheut.
- Reduktimi i tokës së punueshme nëpërmjet ndërtimit të shtëpive
- Të rinjtë do të shikojmë për punësim diku tjetër (në Kosovë apo Turqi)

### *1.3.3 Sfidat*

Në mbarë Kosovën ka shumë sfida për zhvillimin ekonomik dhe rural, të cilat në mënyrë të ngjashme e prekin edhe Mamushën. Duke qenë se ajo është një komunë rurale sfidat e ekonomike shtohen. Është e vështirë që të tërhiqet investimi i biznesit të jashtëm në zonë. Ka më pak mundësi për gratë dhe të rinjtë; veçanërisht në Mamushë ka mungesë të madhe të mundësive të punësimit për gratë. Kjo shkaktohet kryesisht nga mungesa e mundësive për arsimimin e femrave, ku 90% e femrave të papuna e kanë kryer vetëm shkollimin fillor. Sfidat kanë të bëjnë me edukimin e ekonomive familjare për përparësitë që ofron shkollimi i plotë i femrave në përmirësimin e cilësisë së jetës së familjes.Rritja e pragjeve në industrinë bujqësore drejt standardeve evropiane do të jetë sfida kryesore për bujqit e Mamushës nëse tregu i eksportit do të zgjerohet. Megjithatë kjo kërkon asistencë të ndjeshme me investime për fermerët sepse ata nuk mund t'i përballojnë të vetëm kostot e rritjes së prodhimit duke pasur parasysh kushtet aktuale të tregut. Kjo gjithashtu do të kërkojë negocimin me nivelin qendror për mungesën aktuale të marrëveshjeve tregtare dhe mundësive të eksportit për Mamushën. Edhe pse ka prodhim të mjaftueshëm për t'i eksportuar produktet në rajonin fqinj të Ballkanit, ka shumë pak përkrahje nga niveli qendror. Kjo përforcohet edhe nga nivelet ekzistuese të larta të importeve nga Shqipëria dhe vendet e tjera fqinje.

Efikasiteti i prodhimit bujqësor, magazinimit, përpunimit dhe transportit është i nevojshëm. Kjo do të zbutet në një farë mase nga depoja frigoriferike e propozuar, por ende kërkohen masa dhe investime të tjera për të rritur kompetencën e Komunës.

Ndërtimet e pakontrolluara të objekteve në tokë të kategorisë së parë dhe të dytë po ashtu përbëjnë një sfidë për Mamushën dhe kjo duhet të adresohet në afat të shkurtër, së bashku me degradimin e tokës bujqësore nga erozioni, shpyllëzimin dhe mbi-shfrytëzimin bujqësor.




***Harta 3. Aktivitetet ekonomike***

## 1.4 INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHERBIMET PUBLIKE

### 1.4.1 Infrastruktura Rrugore

Transporti paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm të njeriut që është pjesë jetike e ekonomisë dhe luan një rol të rëndësishëm në lidhjet e hapësirave. Transporti krijon lidhje të çmueshme ndërmjet vendeve, aktiviteteve ekonomike dhe njerëzve.

Në Komunën e Mamushës janë tri lloje rrugësh: kryesore/regjionale, lokale, dhe rrugë fushore.

Rruga kryesore/regjionale e ashtuquajtur rruga kryesore e Mamushës e cila e ndan Mamushën në dy pjesë, si një vendbanim linear. Ajo është e gjatë 3.42 km, dhe ofron qasje në dhe nga rrugët e parapara me kapacitet më të madh dhe shpejtësi më të madhe. Kjo rrugë është asfaltuar dhe shtruar gjatë vitit 2008 nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit. Meqë ajo e lidh Piranën me Suharekën shpesh është shumë e ngarkuar me trafik.

Rrugët lokale janë rrugë që lidhin lagjet dhe shtëpitë brenda vendbanimit të Mamushës. Gjatësia e rrugëve periferike është 11.63 km. Shtrimi i këtyre rrugëve është mbështetur nga IOM-i gjatë vitit 2007 dhe pjesa tjeter nga vet bugjeti komunal, të cilat kryesisht janë shtruar me kubëza të betonit.

Rrugët fushore sigurojnë qasje në ara dhe zonën rurale të komunës dhe gjatësia e tyre është rreth 39.71 km. Këto rrugë nuk janë të asfaltuara apo të rehabilituara sepse ekziston problem i pronësisë që duhet zgjedhet nga Komuna.

| **Rrugët e Mamushës** | | | |
|---|---|---|---|
| **Klasifikimi i rrugëve** | **Lloji i hapësirës së qarkullimit** | | |
| | Rrugë të asfaltuara | Rrugë të paasfaltuara | Gjithsej |
| | km | km | km |
| **Kryesore/regjion.** | 3.42 | 0 | 3.42 |
| **Lokale** | 5.67 | 5.96 | 11.63 |
| **Fushore** | 0 | 39.71 | 39.71 |

***Figura 20.. Rrugët e Mamushës***[32]

Analizat e rrjetit të transportit kanë treguar se rrugët e Mamushës janë projektuar për zhvillim me densitet të ulët. Megjithatë, pozita e saj ndërmjet tri komunave: Prizrenit, Suharekës dhe Rahovecit tregon se duhet të bëhen zgjerime dhe përmirësime të tjera. Megjithëse rruga kryesore ka ndriçim, rrugët periferike nuk kanë, gjë që kërkon adresimin e tyre në përmirësimet e ardhshme të infrastrukturës.

[32] *Burimi: KK Mamushë, 2010*

**Trotuaret:** Rruga kryesore ka trotuare të shtruara, që tregon që ka siguri për këmbësorë. Disa rrugë periferike kanë gjithashtu trotuare, por në shumë rrugë kjo çështje nuk është adresuar dhe duhet mirret në konsiderim gjatë fazave të ardhshme.

**Vend parkingjet:** Në Mamushë janë vend parkingjet e kufizuara para objekteve publike, dhe për këtë paraqitet kërkesa për vend parkingje më të organizuara. Shumë nga automjetet parkohen në trotuare, që shkakton rrezik për lëvizjen e këmbësorëve. Prioritet për vendosjen e vend parkingjeve duhet të jetë përgjatë rrugës kryesore dhe para objekteve publike.

### *1.4.2 Shërbimet publike*

**Transporti public:** Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, 98 % udhëtojnë brenda Mamushës, ndërsa 2 % jashtë Mamushës. Për transport kryesisht përdoren autobusët nga Mamusha për në Prizren vetëm nga e hëna deri të premten me 3 ndalesa/1 km. Janë dy kompani private që veprojnë në Mamushë. Gjatë ditëve të fundjavës nuk qarkullon asnjë autobus. Në Mamushë ka dy vend ndalesa kryesore të autobusëve përgjatë rrugës kryesore por nuk ka stacion të autobusëve.

Tabela më poshtë tregon se sa shpesh qarkullojnë autobusët në Mamushë gjatë javës:

| Linja | Nr. në ditë | Çmimi | Kohëzgjatja |
|---|---|---|---|
| **Mamushë - Prizren** | 6 | 1.5 euro | 45 min |
| **Prizren – Mamushë** | 6 | 1.5 euro | 45 min |

***Figura 21. frekuentimi i autobusëve***[33]

Nuk ka linjë autobusi nga Mamusha për në Suharekë dhe Rahovec, çështje e cila do të adresohet në të ardhmen.

Tabela më poshtë paraqet mobilitetin në Mamushë sipas anketës në teren[34].

| Lloji i transportit | Ekonomitë familjare ( %) |
|---|---|
| **Ecje** | 86 |
| **Automjet privat** | 11.60 |
| **Bicikletë** | 0.2 |
| **Motocikletë** | 0.2 |
| **Autobus** | 1.0 |
| **Tjetër** | 1.0 |

***Figura 22. Mobiliteti në Mamushë***

[33] *Burimi: KK Mamushë, 2010*
[34] *Burimi: Anketa në teren - UN-HABITAT dhe KK Mamushë, Korrik 2010*

Nga figura mund të konkludohet që njerëzit shpesh ecin në këmbë për shkak të distancave të shkurtëra brenda Mamushës. Një numër i vogël i njerëzve përdorin autobusin që tregon që njerëzit nuk udhëtojnë shumë dhe punojnë kryesisht në Mamushë. Biçikleta dhe motoçikleta përdoren nga një numër i vogël i njerëzve që tregon se ka mungesë të shtigjeve dhe materialeve kualitative për shtrim të rrugës dhe kjo çështje duhet adresuar në fazat e ardhshme.

Përfundimisht, transporti hekurudhor nuk përdoret për shkak të pozitës së Mamushës që nuk ka qasje të drejtëpërdrejtë dhe se aktualisht hekurudha nuk funksionon në këtë regjion.

Distanca nga Komuna e Prizrenit është 20 km; nga Suhareka 10 km, ndërsa nga Rahoveci 15 km. Mamusha lidh Suharekën me Piranën në drejtimin Prizren, Gjakovë dhe Pejë dhe anasjelltas në drejtimin Prizren – Prishtinë dhe Shkup.

**Transporti hekurudhor:** Transporti hekurudhor në Kosovë është në nivel shumë të ulët si rezultat i

zhvillimit të dobët të infrastrukturës hekurudhore. Komuna e Mamushës nuk ka qasje të drejtpërdrejtë në stacionin hekurudhor; qasja më e afërt është në Krushë të Vogël e cila është 12 km nga Mamusha.

Qasja në aeroport:Qasja nga Mamusha për në aeroportin e Prishtinës mund të realizohet në dy mënyra, por shumë nga qytetarët e Mamushës përdorin mënyrën e dytë:

Përmes Lipjanit – 91 km

Përmes Komaranit – 75 km

Si alternativë përdoret edhe aeroporti i Shkupit në Maqedoni, por jo edhe aq shpesh për shkak të distancës së gjatë prej 135 km.

**<u>Taksitë</u>:** Në Mamushë nuk ka shërbime taksie.




*Harta 4.Infrastruktura rrugore*

### *1.4.3 Infrastruktura teknike*

**Furnizimi me ujë:** Burimet ujore në Komunën e Mamushës janë të shumta. Mamusha furnizohet me ujë të pijshëm nga dy rezervuare, të cilat ndodhen në pjesën veri-perëndimore të Mamushës. Ndërkohë rezervuarët furnizohen me ujë nga dy burime të cilat ndodhen në pjesën perëndimore-lindore të Mamushës (shih figurën 3). Kapacitetet e rezervuarëve janë 300,000 litra dhe 150,000 litra. Rrjeti i furnizimit me ujë u financua nga TIKA[35] në vitin 2005 dhe furnizon të gjitha objektet e Mamushës me ujë të pijshëm. Sipas zyrtarëve të komunës së Mamushës, sasia e ujit i përgjigjet nevojave të popullatës së Mamushës. Rezervoaret furnizohen me ujë nga dy pompa të cilat punojnë me rrymë. Sipas testeve kimike të kryera më 17.03.2010 kualiteti i ujit në rezervoare përmbush standardet.

Pasi që Mamusha ka problem me furnizim të rregullt me rrymë elektrike, ndërprerjet e rrymës ndikojnë në furnizimin me ujë.

Një tjetër burim i ujit janë puset në çdo shtëpi, por këto nuk janë në ndonjë rrjet apo të lidhur me njëri-tjetrin. Konsumi nga puset nuk është i kontrolluar nga asnjë autoritet.

Për më tepër, në pjesën lindore të komunës janë katër fontana (burime) tradicionale. Këto fontana publike përdoren nga bujqit në zonën përreth.

Sipas Regjistrimit të Kosovës[36] nga numri i përgjithshëm i njësive të banimit, 99.0% kanë furnizim me ujë të pijes brenda në shtëpi dhe pjesa tjetër jashtë shtëpisë. Fatkeqësisht uji nuk paguhet. Megjithatë Komuna e Mamushës ka shprehur shqetësimin për këtë çështje dhe po punon në këtë drejtim në mënyrë që të organizojë pagesën për konsum.

Komuna nuk ka sistem të ujitjes, qytetarët janë duke përdorur ujin nga puset, që është shumë shqetësuese sepse ky ujë nuk është testuar fare dhe si pasojë mund të ndikojë në kultura bujqësore.

**Sistemi i Kanalizimit:** Në Mamushë ka një sistem kolektiv i kanalizimit dhe sipas anketë në terren[37], 60% e objekteve kanë qasje në sistem ndërsa 4.0% nuk kanë përderisa për 36.0% nuk ka të dhëna.

Në Mamushë ka rreth 1500 m rrjet të kanalizimit, i përbërë nga dy segmente. Nuk ka ndonjë impiant për trajtimin e ujërave të zeza dhe një segment i rrjetit derdhet në ujëra sipërfaqësore – në vend bashkimin e lumenjve Toplluhë dhe Trrnjë, që ndot të dyja burimet ujore. Kjo është një problem serioz. Segmenti tjetër është i lidhur me rrjetin e kanalizimit të fshatit Medvec (fshat në Komunën e Prizrenit). Për shkak të dimensioneve joadekuate të gypave të kanalizimit, është e nevojshme të bëhet rehabilitimi i rrjetit.

Që nga viti 2012 rrjeti i ujit dhe ujërave të zeza ishin nën mbikëqyrjen dhe menaxhimin e Kompanisë Rajonale të Ujit "Hidroregjioni Jugor" me seli në Prizren, megjithatë ende ka një problem me pagesën e taksës për shkak të kostove të larta.

[35] - Agjencia Ndërkombëtare Turke për Bashkëpunim dhe Zhvillim
[36] *Burimi: Agjencioni Kosovar i Statistikave– Regjistrimi i popullsisë së Kosovës Prill 2011*
[37] *Burimi : Anketa në teren - UN-HABITAT dhe KK Mamushë, Korrik 2010*

Si rezultat i kualitetit të dobët të rrugëve, nuk ka sistem të duhur për drenazhimin e ujërave atmosferik, përveç rrugëve periferike të shtruara kohëve të fundit të cilat janë financuar nga Bashkimi Europian[38] (rreth 2.5 km). Ujërat atmosferik derdhen në lumin Toplluha. Gjithashtu edhe rruga (kryesore) lokale nuk ka sistem të drenazhimit, dhe kjo duhet të adresohet në fazat e ardhshme.

**Furnizimi me energji elektrike:** Mamusha furnizohet me energji elektrike nga Suhareka me një kapacitet prej 10KV. Ka tre transmetues të energjisë elektrike me kapacitet 200KW të cilët nuk i përmbushin nevojat e Mamushës. Sipas anketës në teren 60.0% të objekteve janë të kyçura në sistemin e energjisë elektrike ndërsa 4.0% nuk janë të kyçura dhe për 36.0 % nuk ka informata.

Rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike është relativisht i vjetruar dhe përbën një problem të madh gjatë sezonit të dimrit. Në përgjithësi konsumimi i energjisë elektrike nuk paguhet në komunë, gjë që gjithashtu rrit ndërprerjet e energjisë elektrike.

Aktualisht transmetuesit elektrikë janë të vendosura në qendër të vendbanimit që paraqet rrezik për qytetarët, prandaj kjo çështje do të trajtohet në fazat e mëtejshme.

**Sistemi i ngrohjes:** Në Mamushë nuk ka sistem qendror ngrohje, por ajo është e rregulluar në një bazë individuale kryesisht me dru dhe disa raste me energji elektrike. Përdorimi i drurit për ngrohje nga shumica e popullsisë ndikon tek humbjet e drurit të pyllit. Ka edhe disa familje që kanë filluar përdorimin e paneleve diellore, të cilat janë shembuj të mirë për të inkurajuar familjet e tjerë të përdorin atë në të ardhmen.

**Komunikimi (Telekomunikimi dhe Interneti):** Në Komunën e Mamushës rrjetet e telefonit dhe internetit operohen kryesisht nga PTK-ja. Sipas PTK-së ka 638 lidhje të telefonisë fikse dhe 168 lidhje të internetit.

Kapaciteti i rrjetit kabllor është 300 çifte që përfundojnë në distributorin e objektit të PTK-së në

Mamushë.

Gjithashtu ekziston edhe shërbimi i IPKO-s i cili përdoret më tepër për internetin. Komuna është e mbuluar me rrjetin e telefonisë mobile.

**Menaxhimi i Mbeturinave:** Grumbullimi i mbetjeve të ngurta është njëri nga problemet më të mëdha në Mamushë. Ekzistojnë dy deponi joformale në qytet që nuk menaxhohen, por në vitin 2012 me ndërtimin e tregut një deponi ilegale është larguar. Hedhja jo e duhur e mbeturinave në këtë zonë ndot ujërat tokësore dhe djegia e tyre mund të shkaktojë lirimin e gazrave toksike në atmosferë. Ndodhja e deponisë në terrenin e ulët të rrjedhës së lumit, paraqet mundësinë për rritjen e përhapjes së ndotjes dhe mbeturinave gjatë rasteve të përmbytjeve në drejtim të vendbanimit, që paraqet rrezik për shëndet.

Grumbullimi i mbeturinave në Mamushë menaxhohet nga kompania private I&S. Sipas kompanisë, 150 ekonomi familjare paguajnë taksa për shërbimet, ndërsa të tjerat vendosin t'i hedhin mbeturinat në mënyrë të jashtëligjshme ose të mos paguajnë për këtë shërbim. Performanca e tyre varet nga shkalla e

[38] *Burimi: KK Mamushë, 2010*

pagesave të qytetarëve për këtë shërbim. Sipas raporteve të kompanisë, niveli i tarifave të mbledhura është 23%.

Sasia e mbeturinave të prodhuara për kokë banori është 300 kg në vit. Në Mamushë nuk bëhet klasifikimi dhe riciklimi i mbeturinave. Pika e grumbullimit për Komunën e Mamushës është në Landovicë me një sasi prej rreth 15 tonë në muaj.

***Përmbledhje***

*Sipas analizës, rruga kryesore / rajonale është në gjendje relativisht të mirë. Megjithatë, ajo nuk ka vende parkimi dhe ka një rrjetë pjesërisht të ngadaltë të lëvizshmërisë, dhe frekuentohet shumë.*

*Duke pasur parasysh se ky segment është edhe zona kryesor tregtare dhe komerciale, ekziston nevoja për sigurimin e lëvizjes së trafikut të sigurt, në veçanti për këmbësorët.*

*Pothuajse të gjitha rrugët lokale janë të shtruara, por mungon rrjeti i ngadalshëm i lëvizshmërisë, parkingjet, kullimi i ujit të shiut si dhe ndriçimi publik.*

*Rrugët për qasje në fushat bujqësore janë në kushte mjaft të dobëta. Vetëm pak prej tyre janë të shtruara me zhavorr*

*Një çështje tjetër me të cilën qytetarët po përballen është mungesa e bashkëpunimit ndër-komunal të shërbimeve të transportit publik. Mungon linja e transportit (autobus) me qytetet fqinje me Suharekën dhe Rahovecin.*

*Edhe pse ka një mbulim të mjaftueshëm me ujë dhe sistemit të ujërave të zeza, ka një problem me pagesën e taksës për konsumin e ujit kundrejt kompanisë përkatëse. Një çështje tjetër është mungesa e pagesës për grumbullimin e mbeturinave të ngurta kundrejt kompanisë përkatëse. Këto janë probleme që duhet të adresohen në të ardhmen.*

*Mungesa e sistemit të ujitjes, impianteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe problemi i shtrirjes së rrjetit elektrik krahas vendbanimit janë çështje që duhet të adresohen në të ardhmen.*

### 1.4.4 Vlerësimi i situatës aktuale

**Përparësitë**

- Lokacioni i Mamushës dhe rruga lokale që përshkon nëpër qytet ofron një lidhje të fortë mes Suharekës, Prizrenit dhe Rahovecit
- Burime të mjaftueshme të ujit dhe furnizimit
- Ekziston lidhja telefonike, rrjeti mobil, interneti.

**Mundësitë**

- Krijimi i transportit ndër-komunal dhe lëvizje efikase për të forcuar lidhjet me Suharekën Prizrenin dhe Rahovecin
- Themelimi i kompanisë publike për menaxhimin e ujit dhe mbeturinave
- Përmirësimi i të gjitha tipave të rrugëve
- Rritja e të hyrave komunale duke rregulluar konsumin e ujit të pijes nga qytetarët, si dhe shërbimet për menaxhimin e mbeturinave
- Prezantimi i objekteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe kanalizimit

**Dobësitë**

- Periferia e pa asfaltuar dhe rrugët fushore
- Mungesa e shtigjeve të biçikletave
- Mungesë e shtigjeve për këmbësor
- Mungesë e parkingjeve publike
- Mungesa e sistemit të ujitjes për tokat bujqësore
- Ekziston lidhja telefonike, rrjeti mobil, interneti

**Rreziqet**

- Ndotja e ujit të pijes dhe lumit Toplluha nga mbeturinat
- Deponit joformale të mbeturinave do të rrisin degradimin mjedisor
- Keqpërdorimi i burimeve të ujit

***Sfidat***

*Meqë bujqësia është katalizatori kryesori për zhvillimin e Komunës së Mamushës, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet infrastrukturës, e cila do ta ndihmojë në mënyrë të tërthortë (ose të drejtpërdrejtë) zhvillimin e këtij sektori. Megjithëkëtë, ka shumë sfida me të cilat Komuna duhet të përballet.*

*Organizimi i pagesave për konsumimin e ujit, përdorimi racional të ujit, trajtimi i ujërave të zeza, mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja si rezultat i hedhjeve të jashtëligjshme të mbeturinave, zëvendësimi i rrjetit të energjisë elektrike me rrjet nëntokësor, sigurimi i linjave telefonike dhe të internetit janë sfida me të cilat Komuna duhet të përballet në vitet e ardhshme.*

*Ofrimi i transporti publik efikas (identifikimi i vendit dhe ndërtimi i stacionit të autobusëve) që ofron kushte më të mira për lëvizje (trotuare, sinjalistikë, shtigjet etj.) është një sfidë tjetër për komunën.*




***Harta 5. Sherbimet publike***

## *1.5 PËRDORIMI I TOKËS , VENDBANIMI DHE BANIMI*

### *1.5.1 Përdorimi i tokës*

Nga i gjithë territori i komunës së Mamushës i cili është rreth 1,094 ha, dhe pjesës më të madhe të territorit që është rreth 65.0 % (712.0 ha) është e mbuluar me tokë pjellore, rreth 19.5% (212.5 ha) është e mbuluar me pemishte, vreshta, lëndina, me pyje është e mbuluar rreth 8.50 % (93.0 ha), dhe në zonat e rregulluara, përfshirë lumenjtë, rrugët dhe përdorimet e tjera mbulojnë vetëm 7.0% (76.6 ha) të territorit të komunës *(shih figurën 23)*.

Zona pjellore për kokë banori në komunën e Mamushës është rreth 0.13 ha shifër e cila është nën limitin kritik të 0.17 ha që i nevojitet një shteti për prodhim të mjaftueshëm të ushqimit dhe repro-materialit për popullatën e vet.

Toka pjellore përdoret për kultivimin e kulturave të ndryshme të tilla si: domateve, trangujve, lakrave, spinaqit, pjeprit, shalqirit dhe kulturave të tjera në një sasi më të vogël.

Në fakt vreshtat nuk janë prioritet i banorëve të kësaj komune dhe si rezultat është ato janë tharë, kultivohet vetëm një sipërfaqe e vogël për nevoja familjare. Ndërsa lëndinat dhe kullota përdoren për piknik dhe kullosje të bagëtisë.

**Për shkak të interesit të banorëve për të mbrojtur tokën në pjesën lindore të komunës, disa familje që posedojnë tokë në veriperëndim të komunës kanë filluar ndërtimet për qëllime banimi dhe nën-ndarje të tokës gjë që shkakton humbjen e tokës së mirë. Përveç kësaj, gërmimet për qëllim të ndërtimit janë duke shkaktuar një efekte vizual negativ në peizazhin e përgjithshëm të komunës.**

| PERDORIMI I TOKES | % |
|---|---|
| ***Vendbanimi*** | 7.0 |
| ***Toka e punueshme*** | 65.0 |
| ***Pemetari, vreshtari, livadhe dhe kullosa*** | 19.5 |
| ***Pyll*** | 8.5 |

***Figura 23.Përdorimi i tokës***

Toka e territorit të komunës përdoret për qëllime të ndryshme të cilat kanë karakteristika të ndryshme *(shih figurën 23):*

- Banim, Administratë, Sociale, Shërbime Dhe Ekonomi
- Tokë bujqësore
- Pyje, kullota dhe livadhe

**Banim, Administratë, Sociale, shërbime dhe ekonomike:** kjo zonë është një vendbanim dhe ajo është e vendosur në një lartësi prej 320-340 m, e cila është rreth 117 m² e madhe. Kjo zonë është e përbërë nga përdorimet e mëposhtme; banimi, institucionale, administrative, sociale, kulturore dhe ekonomike.

Përdorim për banim është i përbërë kryesisht nga shtëpitë individuale të tipit të shkëputura të rrethuara nga hapësira oborri që përdoren me qëllime të tjera, të tilla si, bujqësi, bagëti dhe deponim.

Përdorimet e tjera të tokës së pranishme në këtë zonë janë; përdorimet institucionale, administrative dhe kulturore që janë të përqendruara kryesisht në pjesën qendrore të vendbanimit. Përdorimi ekonomik përfshin dyqane të shitjes me pakicë, shërbime, të cilat janë të vendosura kryesisht përgjatë anës së rrugës kryesore/rajonale si një përdorim i vetëm ose i kombinuar me përdorim të banimit, dhe përdorimi industrial që përfshinë aktivitete të rënda dhe të lehta prodhuese.

Një tjetër përdorim janë infrastruktura rrugore , infrastruktura e komunikimit dhe shërbimet publike, si dhe parqet, zonat e gjelbra dhe rekreative.

Për shkak të karakterit rural të vendbanimit në këtë zonë brenda parcelave janë të pranishme gjithashtu dhe pjesë të tokës për kultivimin e perimeve dhe frutave për qëllime familjare dhe të biznesit.

Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë nga toka në pronësi të individëve privatë që mbulon përqindjen më të lartë të zonës dhe komunës.

Toka në pronësi private në këtë zonë është e madhësive të ndryshme ku madhësia minimale e parcelës është rreth 40.0 m² dhe maksimale është 20.000 m².

Toka që është në pronësi komunale është në përqindje më të vogël dhe gjendet në një vend potencial për zhvillimet e ardhshme për përdorim të komunitetit.

**Toka bujqësore:** kjo zonë është e përbërë nga tokat e përdorura kryesisht për aktivitete bujqësore / blegtorale e cila mbulon pjesën lindore dhe perëndimore të territorit të komunës; ajo është e vendosur në një lartësi prej 320 – 460m. Zona është me potencial për zhvillimin e aktiviteteve të tjera të tilla si rekreacioni, turizmi bujqësor, hapësira publike si dhe kultivimin e pemishteve dhe bimëve herbale.

Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor territori i Komunës është i përbërë nga pesë kategori të tokës [39] (I – V).*(shih hartën…)*

Përafërsisht 550 hektarë të tokës bujqësore është në pronësi private, shumica e fermerëve kanë parcela të vogla të tokës.

Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë nga toka në pronësi të personave privatë që mbulojnë një përqindje më të lartë të kësaj zone, komuna dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit. Rreth 55% e parcelave në këtë fushë janë të madhësive së vogël 0-2500,0 m ². (*shih figurën…)*

Mamusha është i përbërë nga toka bujqësore e kualitetit të mirë, e cila është shumë e përshtatshëm për prodhimin e perimeve dhe drithërave.

*[39] Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Projekti i menaxhuar nga ZNKE-ja (ECLO) dhe i zbatuar nga konsorciumi i përbërë nga GFA Consulting Group GmbH (lider), BVVG nga Gjermania dhe DLG nga Holanda*

| **Diapason** *(ha)* | **Nr of parcel** **(%)** |
|---|---|
| **0-0,25** | 55.4 |
| **0,25-0,50** | 30.0 |
| **0,50-1,00** | 12.6 |
| **1,00-1,50** | 1.5 |
| **1,50-2,00** | 0.3 |
| **2,00-5,00** | 0.15 |
| **>10,00** | 0.05 |

***Figura 24. Madhësitë e parceleva të tokës bujqësore***

Prona në pronësi të Agjencisë Kosovare të Privatizimit është rreth 43.0 ha (430,000 m²) e cila është ish-pronë shoqërore e që gjendet në proces të ndryshimit të pronësisë. Kjo tokë është e vendosur në pjesën jug perëndimore të territorit të komunës dhe përdoret si vresht, të cilat në fakt janë tharë. Kjo zonë është e përshtatshme për përdorim ekonomik.

**Pyjet, Kullotat dhe Livadhet:** ky pyll mbulon rreth 8,5% dhe është i vendosur në një lartësi mbidetare prej 320-400m. Këto zona janë përdorur për kullotjen e kafshëve dhe në të ardhmen mund të përdoret për kullotje dhe qëllime rekreative.

Lidhur me pronësinë e tokës kjo zonë është e përbërë kryesisht nga toka në pronësi të personave privatë.




*Harta 6. Shfrytëzimi i tokës*




*Harta 7. Kategoritë e tokës bujqësor*




***Harta 8. Zgjerimi i vendbanimeve mbi tokën bujqësore***

### 1.5.2 Vendbanimi

Komuna e Mamushës është një komunë e karakterit rural që ka vetëm një vendbanim të përbërë nga nëntë lagje. Madhësia e zonës së vendbanimit është rreth 117 ha ose 11% të territorit të përgjithshëm të komunës. Komuna e Mamushës është zhvilluar në mënyrë lineare përgjatë rrugës kryesore / rajonale i cili është një terren i rrafshët. Analizat tregojnë tendenca të zgjerimit në zonën veriore dhe juglindore, dhe në terrene të pjerrëta në veriperëndim të zonës së komunës duke shkaktuar humbjen e tokës bujqësore.

**Vendbanimet joformale:** Sipas Nenit 2 të Ligjit të Modifikuar për Planifikim Hapësinor (2008), vendbanimet joformale janë ato vendbanime që karakterizohen me:

- Posedim joformal të pronës,
- Qasje joadekuate ose privim nga shërbimet bazike,
- Pjesëmarrje joadekuate ose mospjesëmarrje në qeverisje, dhe
- Rrezikshmëri të lartë për banorët që jetojnë në atë vendbanim

Raporti mbi vendbanimet joformale në Kosovë[40], ka identifikuar një vendbanim joformal brenda territorit të komunës. Megjithatë, deri tani komuna me të hyrat e veta dhe me ndihmën e donatorëve ka realizuar projekte për përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe sociale, në mënyrë që të sigurohen kushte më të mira jetesës për të gjithë qytetarët.

### 1.5.3 Banimi

*Sipas Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës të vitit 2011* komuna Mamushës ka rreth 667 ndërtesa të banimit prej të cilave 481 janë ndërtesa me një ose më shumë banorë, 8 janë përdorur për qëndrim sezonal ose përdorim dytësor dhe rreth 149 janë të zbrazëta

- **Mjedis i sigurt dhe i pastër i ambientit jetësor** - krijimi i tampon zonave natyrore në mes të veprimtarive industriale dhe zonës së banimit, përgjatë shtratit të lumit, përgjatë rrugëve ekzistuese dhe të reja ashtu që të zvogëlohet ndikimi në ambient, aktivitetet për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njerëzit;




***Harta 11. Skenari i preferuar***




***Harta 12. Zonimi komunal***

**Epërsitë**

- ***Ruajtja e tokës bujqësore*** - Toka bujqësore është pasuria kryesore për zhvillimin ekonomik lokal
- dhe për këtë arsye duhet të mbrohet nga zhvillimi i pakontrolluar;
- ***Zhvillimet ku infrastruktura ekziston*** - Buxheti Komunal është shumë e vogël, prandaj kjo qasje do të zvogëlojë ndërlikimet financiare të Komunës;
- ***Shfrytëzimi racional i tokës*** - pasi që shumica e territorit të komunës është e përbërë nga toka e cilësisë së mirë, e në mënyrë që të mbrohet, lokacioni për zhvillimin e ardhshëm duhet të bëhet me plotësim dhe dendësim;
- ***Shfrytëzimi i lëvizshmërisë së ngadaltë*** - për shkak të distancave të shkurtra mes aktiviteteve të ndryshme brenda Komunës dhe kjo kontribuon në rritjen e sigurisë dhe përmirësimit të ambientit;
- ***Sigurimi i transportit efikas publik*** - sigurimi i stacionit të autobusëve dhe zhvillimin e dy linjave të reja autobusi me komunat e Rahovecit dhe Suharekës për të përmirësuar qasjen në komunat tjera fqinje; (Komunat Rahovec dhe Suharekë);
- ***Mundësi të tjera për zhvillimin ekonomik*** - inkurajon zhvillimin e blegtorisë dhe kultivimin e pemëtarisë, aktivitete të cilat në fakt janë zhvilluar kryesisht për qëllime familjare;

**Mangësitë**

- **Planifikimi i zonës së re për zhvillim në tokë private kërkon ndërlikime financiare** ngaKomuna - për kompensimin e atyre rasteve që posedojnë tokë vetëm në zonën e mbrojtur;
- **Çrregullimet mjedisore në mes veprimtarisë ekonomike (industria dhe bujqësia) dhe mjedisit për banim** - pasi që nga veprimtaritë ekzistuese industriale gjenden në zonën e vendbanimit dhe janë pranë shtëpive, Komuna duhet të ndërmarrë disa masa në mënyrë që t'i zvogëlojë këto çrregullime;
- Rreziku **nga zhvillimet përgjatë rrugëve ndër-komunale të propozuara** - këtu janë propozuar trirrugët ndër-komunale dhe për shkak të trendit të ndërtimit përgjatë rrugëve kjo do të shkaktojë humbjen e tokës bujqësore;

## 3.2 STRUKTURAT HAPËSINORE DHE LOKACIONET PËR ZHVILLIMET DHE ORGANIZIMET E ARDHSHME

*Ndikimet e jashtme - Projektet dhe strategjitë e parapara në Planin Hapësinor të Kosovës 2010 - 2020 +*

*Në kuadër të Planit Hapësinor të Kosovës 2010 - 2020 + (PHK) Komuna e Mamushës ndodhet në zonën e Kopshteve, me qendër në Prizren. Në kohën kur është hartuar Plani Hapësinor, Mamusha ende nuk ishte e konsoliduar si komunë, prandaj është e vështirë për të gjetur ndonjë projekt në kuadër të Planit Hapësinor i cili ekskluzivisht i është referuar kësaj komune.*

*Sidoqoftë, sipas Planit Hapësinor të Kosovës 2010 - 2020 +, për vendbanimet e vogla (vendbanimet me më pak se 10.000 banorë, ku hyn edhe Mamusha), ka nevojë për investime për përmirësimin dhe ndërtimin e rrugëve lokale, infrastrukturës dhe lidhje më të mirë me rrjetin e rrugëve të nivelit më të lartë, ndërtimin e ujësjellësit dhe sistemit të kanalizimit për tërë vendbanimin, ndërtimi i linjave të reja të rrjetit elektrik dhe telekomunikacionit, rritjen e cilësisë e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore në mënyrë që të bëjë të mundur zhvillimin e mjaftueshëm dhe të barabartë.*

*Madje, sipas PHK-së zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë e orientuar në zhvillimin e strukturave të harmonizuara të vendbanimeve, shfrytëzimi racional i burimeve natyrore dhe shfrytëzimin maksimal të potencialit njerëzor, orientimin e investimeve në ndërtesat për prodhimtari dhe infrastrukturë teknike dhe sociale; shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese; rigjenerimin të zonës rurale duke shtuar aktivitetet për përmirësimin e lidhjeve ekzistuese dhe ndërtimin e lidhjeve të reja me zonat urbane me qëllim që zonat kodrinore - malore të mos trajtohet vetëm si zona bujqësore, por të jenë edhe si pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.*

Duke marrë parasysh trendin aktual për nevojat e parashikuara për banim do të jetë rreth 830 banorë dhe do të bëhet nëpërmjet plotësimit dhe dendësimit. *(shih kapitullin 6 - Elementet për rregullimin e vendbanimit)*

### 3.2.1 Popullsia, strehimi dhe vendbanimi

Sipas Agjencisë Kadastrale të Kosovës në fund të vitit 2012 [57] Mamusha kishte 5.695 banorë dhe duke pasur parasysh se rritja vjetore e popullsisë së Kosovës është 1.3% [58] deri në vitin 2023 komuna do të ketë rreth 6.600 banorë, pra rreth 900 banorë më shumë se tani. Duke pasur parasysh se në Mamushë ekziston një tendencë e rritjes së familjeve të vogla, në vitet e ardhshme Mamusha mund të pritet që familjet do të ketë rreth 6.5 anëtarë, kështu që do të jenë rreth 140 familjeve më shumë.

---

[57] *Burimi: VLERËSIMI I "Popullsisë së Kosovës në vitin 2012", botuar në prill të vitit 2013*
[58] *Burimi: Plani hapësinor 2010-2020+*

| Viti | Popullsia | Familjet |
|---|---|---|
| **Vlerësimi për vitin 2012** | 5695 | 566 |
| **2012** | 6600 | 706 |

Hapësirë për ndërtimin e banesave për familjet e projektuara në Mamushë do të bëhet me dendësimin dhe plotësimin në zonat ekzistuese dhe në një lokacion të ri në pjesën perëndimore të territorit të komunës.

Koncepti sugjeron ndarjen e zonës së vendbanimeve në 4 zona: Zona A - rindërtimi, Zona B - ruajtja, Zona C - zgjerimi dhe Zona D - Zona e rezervuar. Të 4 zonat ndryshojnë nga njëra-tjetra për kah dendësia, tipologjia e ndërtesave, dhe numrin e kateve.

Ndërtesat e banimit do të organizohen dhe konsolidohen në bazë të tri kategorive të banimit që kanë parcela të madhësive dhe përmbajtjeve të ndryshme *(shih kapitullin 6 - Elementet për rregullimin e vendbanimit)*

### *3.2.2 Infrastruktura Sociale*

**Shëndeti**: Duke ditur kriteret e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare për 10.000 banorë në Mamushë nuk ka nevojë për objekte shtesë për popullsinë e parashikuar.

Megjithatë, koncepti i zhvillimit hapësinor këshillon që të bëhet përmirësimi i shërbimeve dhe pajisjeve shëndetësore.

**Edukimi**: *Çerdhja / niveli parashkollor* - Mamusha nuk ka strukturë për fëmijët më të vegjël se pesë vjet, ndërsa për fëmijët më të vjetër se 5 vjet ekziston objekti brenda shkollës fillore.

Në dekadën e ardhshme popullsia e Mamushës pritet të rritet në rreth 6600 banorë. Sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (një kopsht/objektit parashkollor në 2000 - 2500 banorë), kështu që Mamusha do të duhej të ketë dy kopshte/objekte parashkollore.

Sido që të jetë, Mamusha është komunë rurale dhe gratë ende merren me amvisëri, kështu që qytetarët nuk janë të interesuar për të dërguar fëmijët në kopsht. Megjithatë, plani rekomandon që të përcaktohet lokacioni për ndërtimin e objektit në nivel të kopshtit / objektit parashkollor, ose të krijohet një hapësirë brenda ndërtesave ekzistuese publike.

*Shkollimi i mesëm i ulët* - Mamusha ka një shkollë fillore e cila është ndërtuar në vitin 2010, dhe gjendet në zonën qendrore të komunës. Sipas kritereve për numrin e popullsisë së parashikuar për 10 vitet e ardhshme Mamusha nuk do të ketë nevojë për objekte të reja të edukimit fillor.

Pasi që raporti mësues /nxënës nuk është sipas kritereve, është e rekomanduar që të rritet numri i mësimdhënësve për mësim në gjuhën turke. Në mënyrë që të avancohen kapacitetet e mësimdhënësve plani propozon seminare dhe trajnime të ndryshme.

*Shkollimi i mesëm i lartë* - Në Mamushë ka vetëm një shkollë e mesme e cila gjendet në zonën qendrore. Plani për të ardhmen sugjeron zgjerimin e shkollës në mënyrë që të plotësojë nevojat e parashikuara.

Plani gjithashtu rekomandon avancimin e kapaciteteve të mësuesve, mësim në gjuhën shqipe dhe krijimin i shkollave të reja profesionale në fushën e bujqësisë.

**Feja**: Mamusha ka dy xhami të cilat e plotësojnë nevojat e popullatës edhe në të ardhmen.

**Kultura**: Ish ndërtesa e komunës është përdorur si Shtëpinë e Kulturës, e cila është rivitalizuar kohëve të fundit si pjesë e projektit " Programi për Stabilizim e Komunitetit i BE-së ", financuar nga ZNKE dhe implementuar nga IOM-i. Kjo ndërtesë është duke u përdorë edhe si bibliotekë, teatër, shfaqjen e filmave dhe ekspozita.

Sipas kritereve të përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (një qendër kulturore për 4000-5000 banorë), dhe në mënyrë që të plotësojë nevojat e popullatës së planifikuar, plani sugjeron zgjerimin e objektit ekzistues.

Ish Shtëpia e Shëndetit aktualisht përdoret dhe do të vazhdojë të përdoret nga shoqatat lokale.

**Hapësirat e gjelbra, sporti dhe rekreacioni**: Komuna e Mamushës është duke e rritur sipërfaqen e zonave të gjelbra, sporteve dhe rekreacionin duke ndërtuar parqe të reja, hapësira për sport dhe rekreacion. Ajo gjithashtu planifikon të ndërtojë një objekt për sport dhe rekreacion në hapësirë të brendshme. Megjithatë, plani rekomandon edhe krijimin e parqeve tjera, shirita dhe korridoret të gjelbër përgjatë rrugëve, lumit dhe shtigjeve. Është e rekomanduar të shfrytëzohen fushave sportive në oborret shkollore edhe për publikun.

**Varrezat**: Komuna ka tri lokacione të varrezave, megjithatë për shkak të pozitës së tyre në qendër të vendbanimit dhe nevojat për zgjerim për popullatën që planifikohet të rritet plani rekomandon për të ardhmen që të identifikohet lokacioni i duhur dhe atë mundësisht në tokë publike.

**Çështjet administrative, shërbimeve publike dhe sociale:** Komuna ka ndërtesën e vet, stacionin policor, zyrat e PTK-së, KEK-ut, që kanë sipërfaqe të mjaftueshme për të përmbushur nevojat për popullsinë e parashikuar. Në vitin 2012 tregu është ndërtuar me financim të përbashkët nga Komuna dhe donatorët. Megjithatë, koncepti i planit sugjeron përmirësimin e shërbimeve të lartpërmendura administrative dhe publike.

Pasi që Mamusha është komunë e re ajo nuk ka zyrë të punësimit, plani sugjeron krijimin e një hapësire në ndërtesat ekzistuese publike.

Edhe pse nuk ka ndonjë interes nga qytetarët për hapësirë mbi kujdesin e të moshuarve, plani i rekomandon zgjerimin e qendrës shëndetësore ekzistuese në mënyrë që të sigurojë hapësirë për kujdesin e të moshuarve.

### *3.2.3 Zhvillimi ekonomik, duke përfshirë turizmin, rekreacionin dhe tregtinë*

*Ndikimet e jashtme - projektet dhe strategjitë e parapara në Planin Hapësinor të Kosovës*

*Plani Hapësinor i Kosovës për Zonën e Kopshtit, ka përcaktuar disa zona hapësinore me interes hapësinor për Kosovën. Këto zona janë siç vijon: Parku Kombëtar-Sharri, korridori i autostradës Merdarë - Durrës, vendkalimi kufitar Vërmicë, si dhe zonat e trashëgimisë kulturore. Edhe pse Mamusha nuk është pritet për tu zgjeruar në këto fusha, mund të përfitojë nga afërsia me këto vende të përmendura më lart dhe në mënyrë indirekte me zhvillimet e këtyre zonave do të ndikojë edhe në zhvillimit të komunës. Për shembull, autostrada do të bëjë më të lehtë importin e produkteve të ndryshme bujqësore jashtë Kosovës përmes portit të Durrësit apo rrugë tjera.*

*Plani Hapësinor në një pjesë e strategjive tregon për veprimet mbi zhvillimin e ardhshëm e të gjitha vendbanimeve të Kosovës (në fushën e arsimit-shoqëror, shëndetësore, zhvillim ekonomik - me fokus në zvogëlimin e papunësisë dhe varfërisë; zhvillimi i vendbanimeve me fokus kryesor në mbrojtjen e tokës bujqësore; etj). Ai rekomandon konsolidimin e tokës bujqësore, rritjen e pasurisë bujqësore nëpërmjet krijimit të komplekseve të mëdha të fermave dhe ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës bujqësore, zhvillimin e agro përpunimit, si dhe përmirësimi i infrastrukturës teknike.*

Sipas analizës, aktiviteti ekonomik është bërë kryesisht nga prodhimet bujqësore dhe industria bujqësore. Bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010 - 2020 + Mamusha e cila i takon Kopshteve të Kosovës (Zona e portokalltë) është zonë e njohur kulturore - turistike, tregtare, agro-industriale dhe e industrisë së lehtë. Gjithashtu, vizioni i Mamushës për zhvillimin në të ardhmen bazohet në bujqësi dhe burimet alternative ekonomike si tregtia, industria dhe turizmi. Prandaj, rritja ekonomike e Mamushës në të ardhmen bazohet në:

- Bujqësi
- Industri
- Tregti (shumicë dhe pakicë)
- Turizëm

**Bujqësi**a: Territori i Komunës është e shtrirë mbi kategori të mira të tokës, kategoritë I, II, III, IV dhe V ku, I, II, III dhe IV janë kategoritë që janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, derisa kategoria V është e përshtatshme për bujqësi dhe qëllime tjera.

Që nga atëherë, aty ekziston një tokë shumë e mirë bujqësore ku edhe shumica e popullsisë merret me bujqësi.

Prandaj, qëllimi kryesor i konceptit për zhvillim hapësinor është ruajtja e kësaj toke nga të gjitha zhvillimet ashtu që bujqësia të jetë shtylla kryesore për rritjen ekonomike të komunës.

Për tokën në pjesën lindore të komunës, koncepti sugjeron përdorimin e saj për kultivimin e drithërave dhe për bujqësi (në lidhje me bujqësi çdoherë i referohet Ligjit për Tokën Bujqësore Nr. 02/L-26).

Në pjesën perëndimore dhe veri-perëndimore të territorit të komunës është propozuar kultivimi i pemëve, si dhe kultivimi i bimëve mjekësore.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ofron subvencione për bujqit për kultivimin e drithërave dhe blegtorinë, e cila inkurajon bujqit që të merren me bujqësi dhe si dhe promovon bujqësinë si një pasuri e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, jo vetëm e Mamushës, por edhe për të gjitha komunat e Kosovës.

Pasi që interesimi për blegtorinë është në rritje e sipër dhe në komunë nuk ekziston asnjë objekt veterinare, plani rekomandon hapjen e një pike veterinare në mënyrë që të kursehet udhëtimi i bujqve në komunat fqinje.

Përveç kësaj, në mënyrë që të mbështetet veprimtaria bujqësore, Komuna me mbështetjen e donatorëve ka ndërtuar objektin e tregut, ndërsa për ndërtimin e frigoriferit punimet janë duke vazhduar.

Plani gjithashtu sugjeron zhvillimin e marketingut të produkteve vendore bujqësore përmes aktiviteteve promovuese. Një nga aktivitetet e promovimit i cili tashmë është funksional, është Festivali vjetor i Domateve gjatë së cilit promovohen produktet, e sidomos domatet e Mamushës jo vetëm në rajon, por në tërë Kosovën.

**Toka e NSH-ve (Ndërmarrjeve Shoqërore):** Komuna e Mamushës ka rreth 43 hektarë të tokës që janë nën mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Plani rekomandon që shfrytëzimi i kësaj toke në të ardhmen të përcaktohet atëherë kur do të zgjidhet çështja e pronës. Megjithatë, toka është një zonë potenciale për zhvillimin e ardhshëm të aktiviteteve ekonomike.

**Industria**: Aktualisht në Mamushë industria si biznes privat është zhvilluar në një masë të vogël. Disa fabrika si mullinjtë, prodhimi i bllokave të betonit dhe gypave, xhamave të automjeteve si dhe kutive të drurit janë duke funksionuar, ndërsa fabrika e qeseve nuk është duke funksionuar. Plani rekomandon mirëmbajtjen e fabrikave ekzistuese, por propozon të ndërmarrë masa parandaluese për të reduktuar ndikimin e tyre negativ në mjedis.

Sipas planit, si vend potencial për zhvillimin e agro-industrisë së lehtë, përveç tokës së NSH-së, është propozuar të zona jugore e territorit të komunës.

Vendi për aktivitetet e ardhshme industriale është përcaktuar sipas kritereve të zonave të përshtatshme lidhur me mjedisin natyror dhe afërsinë me transportin dhe infrastrukturën. Minimizimi i ndonjë konflikti të mundshëm midis aktiviteteve industriale dhe zhvillimin në të ardhmen për të ruajtur burimet natyrore dhe zonat bujqësore, dhe duke pasur parasysh koston optimale operacionale e që janë thelbësore.

Si masë për zvogëlimin e trazirave mes shfrytëzimit të hapësirës për veprimtari industriale apo banim, plani rekomandon krijimin e një tampon zone mes këtyre dy mundësive.

**Tregtia**: Përveç tregtisë dhe veprimtarisë bujqësore, sektori i biznesit të vogël është i pranishëm edhe në Mamushë, duke u marrë me aktivitete të ndryshme. Sidoqoftë, tregtia bazohet në tregtinë e vajrave

motorike dhe pjesëve të automjeteve të cilat kryesisht importohen nga Turqia, si dhe prodhimeve bujqësore të prodhuara në Mamushë. Koncepti propozon lokacionin e ardhshëm për zhvillimin e veprimtarive tregtare që të jetë përgjatë rrugës rajonale / kryesore. Në mënyrë që toka të përdoret racionalisht  është propozuar të promovohet shfrytëzim i përzier i tokës (duke u kombinuar me banim).

Bashkë me avantazhet  që ka shfrytëzimi racional të tokës, shfrytëzimi i përzier mund të krijojë konflikte ndërmjet shfrytëzimeve të ndryshme. Në këtë zonë, ambienti jetësor mund të prishet nga zhurma e trafikut, ngarkimi dhe shkarkimi, mbeturinat, zhurma gjatë ndërtimeve, etj. Megjithatë, është propozuar që të  ruhet ky lloj i përzier i shfrytëzimit  që tashmë është ekziston në komunë dhe të paraqiten politika të duhura për planifikim dhe rregulloret që do të mundësojnë rregullimin e saj dhe në përmirësimin e cilësisë së ambientit jetësor.

Në mënyrë që të përmirësohet  zhvillimi i tregtisë, Komuna ka zbatuar projektin për ndërtimin e tregut dhe do të vazhdojë me ndërtimin e një depoje të ftohtë (frigorifer). 95% e mjeteve janë siguruar nga Komisioni Evropian dhe 5% nga buxheti i komunës. Ky objekt do të jetë i një rëndësie të madhe për bujqit e Mamushës.

**Turizmi**: Mamusha ka një pamje të bukur dhe bujqësia është aktivitet kryesor ekonomik i saj. Këto janë potencialet për zhvillimin e agro - turizmit, ku vizitorët mund të shohin veprimtarinë bujqësore gjatë vizitës së Mamushës. Prandaj, është propozuar që të  adaptohen disa shtëpi  për të shërbyer si bujtina për vizitorët (përfshirë fjetjen dhe mëngjesin). Si lokacione potenciale për zhvillimin e agro - turizmit dhe turizmit të gastronomisë janë pjesa qendrore dhe lindore e komunës.

Festivali vjetor i domateve është një nga ngjarjet që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e aktiviteteve turistike.

Në Mamushë ekzistojnë edhe disa ndërtesa të trashëgimisë kulturore dhe varreza osmane të cilat  mund të jenë potencial për zhvillimin e turizmit kulturor. Është sugjeruar riparimi dhe rivitalizimi i shtëpive, sahat kullës dhe varrezave. Sahat kulla mund të shërbejë si një pikë vrojtimi mbi qytetin. Këto asete të trashëgimisë kulturore gjenden në qendër të qytetit si dhe në pjesën jugore të komunës. Plani rekomandon përmirësimin e qasjes tek këto ndërtesa dhe ndërtimin e  shtegut për tek varrezat osmane.

Përveç kësaj, është rekomanduar hapja e një qendre për informacion turistik në brendi të ndërtesës komunale si dhe organizimin e veprimtarive të ndryshme promovuese. Aktivitetet e turizmit që bazohen në resurset natyrore dhe kulturore janë të lidhura ngushtë me  sigurimin e vendeve të punës dhe si shërbimet  e duhura përcjellëse por edhe duke pasur parasysh ruajtjen e resurseve natyrore.

Madje, plani inkurajon bashkëpunimin me komunat fqinje sa i përket turizmit.




*Harta 13. Zhvillimit ekonomik*

### *3.2.4 Infrastruktura, transporti, komunikacioni dhe shërbimet publike*

*Ndikimet e jashtme - projektet dhe strategjitë e parapara në Planin Hapësinor të Kosovës 2010 - 2020 +*

*Në fushën e infrastrukturës dhe të komunikimit, Plani Hapësinor parasheh projekte të cilat mund të ndikojnë në mënyrë indirekte në përmirësimin e qasjes në Mamushë. Projekte të tilla janë: Ndërtimi i rrugës Prizren - kufiri me Maqedoninë, ndërtimi i autostradës Merdare - Vërmicë; Ndërtimi i hekurudhave Prizren - Vërmicë; funksionalizimi i stacioneve hekurudhore (hekurudha në Prizren është e një rëndësie të veçantë për Mamushën, pasi që transporti hekurudhor i mallrave mund të ketë kosto më të ulët se sa transporti rrugor); ndërtimi i kolektorëve të ujërave në komunat (Prizren apo Suharekë e që kolektorët mund të jenë me rëndësi të madhe për Mamushën); mbulimit e territorit me rrjet të telefonisë mobile dhe internetit, etj*

**Infrastruktura rrugore**: Në bazë të Ligjit mbi Rrugët [59], rrugët kryesore dhe rajonale janë kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, derisa rrugët lokale (siç përcaktohet me ligj) janë kompetencë e Administratës Lokale.

Vendbanimi i Mamushës shtrihet përgjatë rrugës rajonale Prizren - Mamushë - Suharekë e cila është me të vërtetë rruga kryesore e vendbanimit. Duke pasur parasysh se vendbanimi është zhvilluar spontanisht, plani i përgjithshëm rrugor nuk ka ndonjë strukturë të duhur apo ndonjë hierarki të rrugëve. *(shih Strukturën Urbane të Vendbanimit).*

Siç tregon propozimi për banim, plani propozon krijimin e një strukture të rrjetit të rrugëve që do të mundësojnë qasje të lehtë dhe ta lehtësojë lëvizjen brenda vendbanimit.

Një element i shquar i rrjetit të propozuar është krijimi i unazës e cila do të mundësojë një qasje të drejtpërdrejtë në rrugët fushore dhe anasjelltas, duke përjashtuar mundësinë e lëvizshmërisë së rëndë nëpër pjesën më të dendur të vendbanimit.

Plani rregullon rrugët në Mamushë si në hierarkinë e mëposhtme:

- Rruga kryesore / rajonale
- Rruga ndër-komunale
- Rrugët kolektive
- Rrugët e bllokut

**Rruga rajonale "Prizren - Mamushë - Suharekë** ": Kjo është me të vërtetë rruga kryesore e vendbanimit. Për shkak të intensitetit në qendër, plani propozon ndarjen e rrugës në segmente të cilat do të planifikohen në përputhje me nevojën për zonat e mbyllura. Në pjesët më të dendura, seksioni rrugor duhet që të përmbajë vende parkime- pasi bizneset kryesore janë të vendosura përgjatë këtij segmenti,

[59] *Ligji mbi Rrugët nr. 2003/10 dhe Ligji nr. 03/L-120 mbi Përmirësimin e Ligjit nr . 2003/10*

gjelbërim- për të zvogëluar ndikimin që kanë automjetet e motorizuara gjatë lëvizjes, shteg për biçikleta, vend-parkim dhe pika për shërbim me qira – që të ndihmojë lëvizshmërinë si dhe një stacion të autobusëve. Për të rritur sigurinë, plani propozon zvogëlimin e dimensionit rrugë porsa hyhet në zonën e vendbanimit.

**Rrugët ndër-komunale**: Plani synon të përmirësojë lidhjen e Mamushës me komunat përreth, duke pasur parasysh se aktualisht lidhja bëhet përmes rrugëve të pashtruara të ndërtuara spontanisht. Vendbanimet fqinje të konsideruara si prioritet janë: fshati Reti (Komuna e Rahovecit), fshati Tërn (Komuna e Suharekës) dhe fshati Novakë (Komuna e Prizrenit) . Këto rrugë duhet të projektohen dhe ndërtohen sipas standardeve.

**Rrugët kolektive**: Plani propozon një rrjet të rrugëve kolektive të cilat shtrihen përgjatë zonave komerciale të Mamushës. Ato kryesisht janë të organizuar paralel me një distancë përafërsisht???. Këto rrugë janë dy kahëshe dhe shtrihen përgjatë zonave komerciale të vendbanimit. Përbërja është e ngjashme me rrugën kryesore, me dallim në dimensionin e përgjithshëm të seksionit, pasi shtrihen në zonat më pak të dendura të vendbanimit.

**Rrugët e bllokut**: Këto rrugë mundësojnë qasjen në secilën prej njësive të banimit në zonë. Në rastet kur rrugët e tilla lidhin dy rrugë kolektive, ato janë rrugë një kahëshe me profile të ngushta për tu shfrytëzuar si hapësira të përbashkëta. Ndërsa në rastet kur janë qorr-sokaqe janë rrugët dy-kahëshe me profil të ngushtë që shfrytëzohen si hapësirë e përbashkët.

Është rekomanduar që rrugët e propozuara të ndërtohen apo të përmirësohen bazuar në profile, të dala nga analiza e gjendjes ekzistuese të rrugëve dhe modelit të vendbanimit (për detaje teknike *(shih Kapitullin 6 - Elementet e Rregullimit të Vendbanimit).*

Në mënyrë që të përmirësohet qasja në tokat bujqësore, plani sugjeron të vazhdohet me shtruarjen e rrugëve nëpër fusha.

Mamusha nuk ka adresa të rrugëve prandaj plani sugjeron që të fillohet me emërtimin e rrugëve. Është sugjeruar që të ndërtohet kanali i ujit të shiut përgjatë rrugëve.

**Transporti publik**: Aktualisht janë dy kompanitë private të cilat operojnë me linjën e autobusit Mamushë - Prizren dhe Prizren - Mamushë nga e hëna deri të premten.

Komuna e Mamushës nuk ka stacion të autobusëve, prandaj plani rekomandon ndërtimin e objektit në një lokacion të caktuar për zhvillimin e ardhshëm.

Rekomandimet e tjera janë edhe fillimi i dy linjave të reja të autobusëve Mamushë - Rahovec dhe Mamushë - Suharekë, i cili do të përmirësojë dhe lehtësojë qasjen në ato qytete.

**Rrjeti i ujësjellësit**: Rrjeti i ujësjellësit në Mamushë është ndërtuar në vitin 2005, dhe shumica e shtëpive kanë qasje në rrjet. Megjithatë për shkak të mospagesës së faturave nga banorët Ujësjellësi Rajonal "Hidroregjioni Jugor" – në Prizren, sistemi nuk është duke punuar siç duhet prandaj banorët janë duke përdorur ujin nga puset private. Kështu, plani sugjeron organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes në mesin e banorëve për të paguar faturën e ujit.

Plani rekomandon punimet në rehabilitim dhe rivitalizim në mënyrë që të zvogëlohen humbjen e ujit, të bëhet zgjerimi i rrjetit për lidhjet e ardhshme, si dhe hulumtimet për rritjen e kapaciteteve të ujit.

Në Mamushë ekziston mungesë e sistemit të ujitjes që e vështirëson punën e bujqve. Prandaj, plani sugjeron ndërtimin e sistemit të ujitjes.

**Rrjeti i kanalizimit**: Mamusha ka një rrjet të kanalizimit dhe shumica e shtëpive janë të lidhura me të. Sistemi nuk ka fabrikë lokale për trajtim të ujërave të zeza, kështu që një pjesë derdhet në lumin Toplluhë, ndërsa pjesa tjetër është e lidhur me sistemin e fshatit Medvec (komuna e Prizrenit). Plani sugjeron ndërtimin e një fabrike për trajtimin e ujërave të zeza të kapacitetit të vogël me financim nga donatorët dhe lokacioni është rekomanduar të jetë afër pikës së shkarkimit të mbeturinave, përkatësisht në kryqëzimin e dy lumenjve.

Plani gjithashtu synon riaftësimin në të ardhmen të gypave të dëmtuar (sipas nevojës) dhe zgjerimin e sistemit të kanalizimit për lidhjet në të ardhmen.

Sa i përket sistemit të ujit të shiut koncepti i zhvillimit hapësinor rekomandon ndërtimin e tij përgjatë rrugëve rajonale dhe lokale.

**Mbeturinat e ngurta**: Grumbullimi i mbeturinave bëhet nga kompania private I & S. Ekziston një deponi mbeturinash informale por e pa menaxhuar në komunë e cila shkakton ndotje në mjedis. Kohëve të fundit Komuna ka larguar njërën prej ish deponive, ku është nevojitur që të bëhet ndërtimi i tregut.

Që të zbutet situata, plani synon këto aktivitete: Rritjen e numrit të kontejnerëve në komunë dhe krijimin e një kompanie lokale komunale.

Përveç kësaj, komuna mund ta ndërtojë edhe një stacion transporti (ndërtesë/vend për deponimin e përkohshëm dhe përpunimin e mbeturinave) në pjesën jugore të komunës në afërsi të zonës së përcaktuar për veprimtari të vogla industriale, ku mbeturinat do të kompresohen dhe vendosen në kamionë të vogël për transport deri në deponinë rajonale si dhe në proces të mëtejmë të riciklimit. *(shih hartën ...)*

**Energjia elektrike**: Rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike në Mamushë është relativisht i vjetër dhe nuk i plotëson nevojat e popullsisë aktuale. Mospagesa e faturës së energjisë elektrike nga qytetarët gjithashtu ndikon në këtë sistem.

Komuna tashmë ka planifikuar projektin për zhvendosjen e transmetuesve të tensionit të lartë në periferi të vendbanimit që do të mbështetet nga donatorët. Madje, plani synon riaftësimin dhe përmirësimin e rrjetit ekzistues elektrik dhe zgjerimin e tij në mënyrë që të plotësohen kërkesat e popullsisë në të ardhmen. Janë duke u inkurajuar masat për energjinë efiçiente, si dhe përdorimin e energjisë alternative.

**Komunikimi (Telekomunikacioni dhe Interneti):** Territori i Mamushës mbulohet nga të dy operatorët: PTK dhe IPKO. Që të dy operatorët ofrojnë telefoni fikse dhe mobile. Është rekomanduar që të ofrohen shërbime edhe për zonat e reja.




*Harta 14. Infrastruktura rrugore e propozuar*

### *3.2.5 Trashëgimia mjedisore, natyrore dhe resurset, pamja e vendit dhe trashëgimia kulturore*

***Ndikimet e jashtme*** *- projektet dhe strategjitë e parapara në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020 +*
*Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Plani Hapësinor i Kosovës parasheh mbrojtjen e mjedisit nga degradimi përmes masave që parandalojnë nxjerrjen e materialeve inerte nga shtretërit e lumenjve, në parandalimin e hedhjes së mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në bujqësi, ndërtimi i impianteve të trajtimit e ujërave të zeza, eliminimin e deponive ilegale, ndërprerjen e ndërtimeve pa leje në tokat e punueshme, zvogëlim e përdorimit të druve për ngrohje përmes zgjidhjeve alternative, ndërmarrjen e veprimeve që parandalojnë erozionin.*

Sa i përket mjedisit, Mamusha ka peizazhe të bukura natyrore, dhe me qëllim që të mbrohet dhe përmirësohet, është rekomanduar që të ndërmerren hapa të rëndësishëm. Për shkak të përqindjes së lartë të tokës bujqësore, ajo do të shfrytëzohet si një bazë për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Bile, toka bujqësore veçse ia shton bukurinë komunës. Nga ana tjetër, pasi një pjesë e madhe e zonës është e mbuluar me hapësirë të gjelbër, menaxhimi i duhur i këtyre fushave duhet të promovohet dhe të rritet funksioni në këto fusha. Prandaj, në këto hapësira është propozuar që të shfrytëzohen për aktivitete sportive dhe argëtuese. Në mënyrë që të krijohet një lidhje mes zonave të gjelbra, është rekomanduar ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë.

Edhe lumi Toplluhë, kontribuon në shtimin e bukurisë së pamjes së komunës; kështu që, plani rekomandon përmirësimin e shtratit të lumit dhe të vazhdohet me mirëmbajtjen e tij. Gjithashtu, është rekomanduar krijimi i një korridori të gjelbër përgjatë shtratit të lumit, i cili do të ofronte për qytetarët e të gjitha moshave një hapësirë për shëtitje, ushtrime dhe çlodhje, si dhe një qasje më e përshtatshme për në shtratin e lumit.

Përveç kësaj, që të parandalohet prerja e druve janë sugjeruar aktivitete primare për shfrytëzimin e qëndrueshëm të saj, duke përfshirë mbjelljen e fidanëve dhe ruajtjen e drunjve ekzistues.

Për parandalimin e ndotjes së tokës është e rekomanduar organizimi i aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Rekomandim tjetër që lidhet me mbrojtjen e mjedisit është krijimi i tampon zonave natyrore mes sektorëve të ndryshëm. Në mënyrë që të mbrohet mjedisi nga përkeqësimi dhe ndotja, plani gjithashtu sugjeron zhvillimin e Planit Lokal të Veprimit në Mjedis (PLVM).

**Fatkeqësitë dhe rreziqet**: Profili tregon se cilat janë kërcënime kryesore në Komunën e Mamushës:, erozioni, përmbytjet, zjarret, degradimi dhe tërmeti.

*Erozioni* - në Mamushë erozioni është kryesisht me ritëm të mesëm dhe të ulët. Në mënyrë që të parandalohet erozioni në zonën e paraqitur në hartë, janë propozuar masat e mëposhtme: parandalimi i prerjes së drurit, pyllëzimi, krijimi i tarracave natyrore dhe parandalimi i ndërtimeve në këtë zonë.

*Përmbytja* - Përmbytja nga lumi Toplluhë shkaktohet nga reshjet sezonale dhe nga bllokadat e shkaktuara nga mbeturinat e ngurta të hedhura nga banorët dhe mbeturinave  që vijnë nga vendbanimet fqinje. Plani propozon rregullimin e shtratit dhe bregut të lumit, krijimi i korridoreve të gjelbra si dhe rekomandon parandalimin e ndërtimeve në distancë më pak se 30 m (Ligji nr. 04/L-147 mbi Ujërat) nga shtrati i lumit. Një tjetër rekomandim është edhe parandalimi i grumbullimit të mbeturinave të ngurta.

*Tërmeti* - Sa i përket klasifikimit sizmik, territori i komunës është klasifikuar si zona VII dhe VIII. Pika normale është e vendosur në pjesën perëndimore dhe jugore të komunës, ku plani nuk rekomandon ndërtime. Përveç kësaj, plani sugjeron aplikimin e standardeve dhe rregullave teknike për ndërtimin e godinave në zonat e ndjeshme ndaj tërmeteve.

*Zjarret* - Zjarret shkaktohen kryesisht përreth stacioneve të benzinës, nga rezervuarët e gazit dhe të naftës dhe për shkak të temperaturave të larta në pyje dhe zona bujqësore. Plani sugjeron ndërmarrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në këto zona. Është e nevojshme që të krijohen dhe trajnohen grupe vullnetare  në rast të katastrofave.




***Harta 15. Mjedisi, rreziqet dhe trashegimia kulturore***

**Peizazhi Kulturor**: Koncepti i peizazhit kulturor sjell së bashku një numër të elementeve të ndryshme territoriale në mënyrë që të krijojë një rrjet me karakteristikat më të dalluara të vendbanimit dhe t'i bëjë shumë lehtë për të hyrë dhe për ta gëzuar. Madje, ka ndërmend të përdorë këto elemente për t'i dhënë karakter strukturës së mobilitetit brenda komunës.

Aspektet që këtu janë marrë parasysh janë:

- Trashëgimia Kulturore

Xhamia Qendrore, 3 shtëpi të vjetra

- Objektet kulturore dhe të tjera publike

Xhamia e Re, Shatërvani, Shkolla fillore "Haxhi OMER LUTFU", Qendra Kulturore, Ndërtesa Komunale, Stacioni i Autobusëve

- Hapësirat Publike

Parku Ankara, Parku i fëmijëve, Parku i ri

- Linjat ujore

Segmenti i lumit Toplluhë

- Rrjeti i lëvizshmërisë së ngadalësuar

Rrjeti i mobilitetit të ngadalësuar që përfshinë shtegun për biçikleta përgjatë rrugëve të vendbanimit dhe rrugëve fushore

- Tokat bujqësore

Tokat bujqësore përgjatë lumit ashtu që të vihet në dukje produktin e etiketuar të Mamushës, dhe promovimin e prodhimeve organike, si pjesë e këtij rrjeti

- Korridoret e gjelbra

Prania e gjelbërimit përgjatë rrjetit të drejtojë shfrytëzuesin dhe të jap aromë arterieve brenda vendbanimit.

Ky rrjet ka për qëllim t'i japë banorit/ vizitorit / shfrytëzuesit një paralele alternative për të lëvizur brenda komunës e cila do t'i mundësojë dikujt për të treguar për resurset kryesore të Komunës.

Segmentet e rrjetit kanë një cilësi dalluese në varësi të karakterit të elementeve që sjellin së bashku:

*Shtegu i domates* - Shtegu ka si pikënisje ndërtesën komunale dhe si pikë të fundit shkollën fillore "Haxhi OMER LUTFU", si dy vende kryesore për ngjarjet festive. Shtegu shtrihet përgjatë lumit Toplluhë dhe së bashku me tokat bujqësore krijon një sistem që synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor. Është emëruar shtegu i domates pasi ka për qëllim të lidhë dy pikat kryesore ku zhvillohen ngjarjet festivalit të domates, e cila është në rritje çdo vit. Shtegu i tillë do të ketë edhe shëtitore të këndshme, i pasuruar me ngjarjet promovuese, me ç'rast përmirëson qasjen në fusha dhe siguron funksionimin e segmentit të lumit.

*Shtegu i pyllit* - Shtegu i gjelbër shtrihet përgjatë kufirit perëndimor të zonës së vendbanimit, duke përfaqësuar një urë mes pyllit dhe zonës së banuar. Ai synon të ofrojë njerëzve një shëtitore të duhur

për çlodhje. Ky segment rrjeti është shoqëruar me një pamje të dendur gjelbërimi. Kjo është bërë me qëllim që të zbus kalimin nga zona e banuar me mungesë të madhe të drunjve në zonë pyjore.

Shtegu i lumit - Pikënisja e këtij segmenti me të vërtetë paraqet pikën hyrëse të Komunës nga Komuna e Suharekës e shënuar me një portë të veçantë. Shtegu plotëson qëllimin e rrjetit duke i dhënë një qasje të menjëhershme në zonën e lumit si një mënyrë alternative e lëvizjes përgjatë komunës paralele për në rrugën kryesore të vendbanimit. Shtegu karakterizohet me një trajtim të veçantë të lumit që do të kontribuonte në ngadalësimin e rrjedhës së lumit drejt zonës së banuar ashtu që të zvogëlohen mundësitë për përmbytje duke shfrytëzuar elementet natyrore të zonës. Ky kombinim do të rezultojë me efekte shumë të këndshme të ujit sa i përket lidhjes me pjesët tjera të lumit, ku do të ketë rrjedhë më të natyrshme e ujit.

*Shtegu shpirtëror*- I ngjashëm me atë paraprak, ky segment si një pikënisje ka një xhami të re e cila edhe pse nuk është e vendosur në vetë kufirin e komunës, me praninë e saj paraqet pikënisjen e vendbanimit, kur arrihet nga Komuna e Prizrenit. Duke pasur parasysh se feja është pjesë shumë e rëndësishme e identitetit të Mamushës dhe Xhamia e Re përkujdeset që të zhvillohen aktivitete të përditshme, plani propozon krijimin e një linje që përveç lidhjes me zonën qendrore, ka për qëllim të ofrohet një shëtitore në të cilën do zhvilloheshin aktivitete që mundësojnë socializimin, me fokus të veçantë për të moshuarit (p.sh. tabela shahu, etj.)

**Trashëgimia Kulturore**: Komuna e Mamushës ka disa monumente me vlerë historike nga periudha e Osmanëve, dhe koncepti i zhvillimit hapësinor rekomandon që Komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të bëjë ndarjen e mjeteve për projektet e restaurimit.




***Harta 16. Peisazhi kulturor***




*Harta 17. Korniza e zhvillimit hapësinor*

## *3.3 SHËNJIMI I ZONËS SË VENDBANIMIT EKZISTUES DHE ZONAT E PROPOZUARA SI DHE KUSHTET RREGULLUESE PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM*

Sipas Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor (nr. 2003/14, neni 2) zona urbane / e banuar është toka me kufij të përcaktuar brenda suazave të së cilës është planifikuar ndërtimi urbanistik.

Mamusha  nuk ka zona të shënjuara urbane si dhe kushtet dhe rregulloret për kontrollin e zhvillimit, prandaj ka ardhur deri tek zhvillimi i pakontrolluar në tokën bujqësore. Prandaj hapi i parë në të cilin plani ishte iniciuar, është përcaktimi i kufirit ekzistues dhe atij të ardhshëm i vendbanimit  të aprovuar nga Kuvendi Komunal.

Madhësia e zonës së vendbanimit ekzistues është rreth 117 ha, e cila shfrytëzohet për qëllime banesore, bujqësore, komerciale, industriale, publike, shoqërore dhe rekreative.

Popullsia e komunës në një periudhë prej 10 vitesh pritet të rritet në rreth 900 banorë. Sipas rekomandimeve të planit, hapësira për këtë numër të banorëve do të sigurohet brenda zonës së vendbanimit e miratuar me rreth 64 ha, që tashmë ka infrastrukturë dhe qasje në shërbimet publike, që do të arrihet përmes mbushjes dhe/ose rritjes së dendësisë ndërsa rreth 82 ha tokë është rezervuar vetëm për zhvillimin e agro- industrisë.

Plani gjithashtu propozon si vend me potencial për veprimtari ekonomike një tokë të NSH-së që ka rreth 43 ha, e cila është jashtë kufijve të vendbanimit. Zhvillimi i kësaj zone do të bëhet me hartimin e Planit Rregullues Urban si dhe në bazë të procedurave të përshkruara në Ligjin për Planifikim Hapësinor (nr. 2003/14) dhe Ligji (L-03/L-106) për përmirësimin e Ligjit ( nr. 2003/14).

Madje, plani propozon kriteret dhe elementet për rregullimin e hapësirës brenda zonës së vendbanimit.

# 4. STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANI I VEPRIMIT

Ky kapitull përshkruan tranzicionin në mes të situatës ekzistuese dhe zhvillimin e propozuar hapësinor. Ai formulon një grup të strategjive dhe veprimeve për realizimin e qëllimeve brenda kornizës së zhvillimit hapësinor, duke marrë parasysh përgjegjësitë, çështjet kohore dhe implikimet financiare.

Më poshtë janë një numër i tabelave të cilat përshkruajnë në formë të përmbledhur se si duhet të zhvillohen gjashtë komponentët kryesore të komunës. Komponentët janë:

A. **ZHVILLIMI SOCIAL DHE INFRASTRUKTURA SOCIALE**
B. **ZHVILLIMI EKONOMIK**
C. **INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE**
D. **PËRDORIMI I TOKËS, BANIMI DHE VENDBANIMI**
E. **MJEDISI, ZONAT E PRIRURA NDAJ RREZIKUT, DEGRADIMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE**
F. **KAPACITETET NJERËZORE**

Synimet dhe objektivat e çdo komponenti janë në përputhje me kapitullin 2. Në mënyrë që të zbatohen synimet dhe objektivat, janë propozuar strategjitë me veprime, projekte dhe/ose programe që përshkruajnë përgjegjësitë, afatet kohore, implikimet financiare etj.

## 4.1 STRATEGJITË PËR ZBATIM DHE PLANI I VEPRIMIT

### A. DEMOGRAFIA DHE GJENDJA SOCIO EKONOMIKE

Sipas analizave komuna e Mamuşa/Mamushës/Mamuša përballet me çështjet vijuese: papunësia në kuadër të popullsisë së re (të rinjtë nuk janë të interesuar të merren me aktivitete bujqësore), niveli i ulët i arsimimit të grave dhe përfshirjes në institucione dhe aktivitete publike si dhe mungesa e infrastrukturës sociale për rekreacion dhe argëtim.
Duke pasur parasysh që parimet e provokuara nga PZHK-ja janë ngritja e cilësisë së jetës dhe mirëqenia sociale, qasja e integruar, ekonomia e qëndrueshme, qeverisje e mirë urbane, në mënyrë që të propozoj strategjitë vijuese për të arritur qëllimet.

| Fushat tematike | Qëllimi | Strategjia | Kodi i projektit | AKCIONET / PROJEKTE / PROGRAME | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE E TJERA TË PERFSHIRA | PRIORITETI Lartë-L Mesatar-M I Ulët- U | Korniza Kohore Afat shkurtër-ASH Afat mesë -AM Afat gjatë -AGJ E vazhdueshme - C | PASOJAT FINANCIARE* Minimale; Të Ulëta Mesatare; Të Larta ; | BUXHETI | Monitorimi i treguesve të rezultateve |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A. DEMOGRAFIA DHE GJENDJA SOCIO EKONOMIKE | Qëllimi: A1 Përmirësimi i situatës sociale dhe mirëqenies | Strategjia A1: Aftsim, ndërgjegjësim dhe ndërhyrjet fizike për të përmirësuar gjendjen sociale dhe mirëqenien | A1: Mundësi të reja të ofruara për biznesin e fokusuar kryesisht në bujqësi | | | | | | | | |
| | | | A1.1 | Kthimi i tokës të NSH-ve në pronë komunale | Komuna | AKP-ja | L | ASH | Ulët | Komunal | Marrëveshjet e nënshkruara |
| | | | A1.2 | Hapja e degëve të reja profesionale në fushën e industrisë që kanë të bëjë me bujqësinë, blegtorin, bujqësinë, trajtimin e mbeturinave organike (njëjtë si në B.1.5) | Komuna DE | MASHT, MBPZHR dhe donatori | M | AM | Mesatar | Komunal, ministror donatorët | Degët profesionale, në kuadër të shkollës së mesme |
| | | | A1.3 | Baza e të dhënave e punësimit dhe përditësimi i saj | Komuna DF | MESW | U | AM | Ulët | Komunal | Baza e të dhënave |
| | | | A1.4 | Nxitja e trajnimeve profesionale për krijimin e mundësive të reja të punës | Komuna DE | MASHT, MBPZHR dhe donatori | M | AM | Mesatar | Komunal, ministror donatorët | Numri i trajnimeve të zhvilluara |
| | | | A2: Inkurajimi i grave të vazhdojnë arsimimin e lartë dhe të angazhohen në aktivitetet publike si dhe të punësohen | | | | | | | | |
| | | | A2.1 | Inkurajimi i themelimit të OJQ-ve të grave | Shoqëria Civile | Komuna | U | ASH | Minimum | | OJQ |
| | | | A2.2 | Fushatat informative, seminare, trajnime në lidhje me përfitimet nga arsimimi | Komuna DE | Donatorët | M | C | Ulët | Komunal Donatorët | Numri i fushatave, seminareve të mbajtur |
| | | | A2.3 | Trajnime profesionale për vetë-punësim dhe krijimin e vendeve të punës | Komuna DE | Donatorët | M | C | Ulët | Komunal Donatorët | Nr. i trajnimeve |

Page 1

**DEMOGRAFIA DHE GJENDJA SOCIO EKONOMIKE**

**Qëllimi: A1 Përmirësimi i situatës sociale dhe mirëqenies**

**Strategjia A1: Aftesim, ndërgjegjësim dhe ndërhyrjet fizike për të përmirësuar gjendjen sociale dhe mirëqenien**

**A3: Infrastruktura sociale është e përparuar dhe shërbimet shëndetësore dhe arsimore janë të përparuara përmes ofrimit të vazhdueshëm të zhvillimit të kapaciteteve të stafit për këto shërbime.**

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A3.1** | Ndërtimi i qendrës rinore (shumë qëllime) | Komuna DE | DU, DSP MKRS Donatorë | M | AM | Mesatar | Komunal Donatorët | Themelimi I qendrës |
| **A3.2** | Zgjerimi i kapaciteteve të shkollës së mesme | Komuna DE | DU DSP MAPL MASHT | L | ASH | Mesatar | Komunal dhe ministror donatorët | Sigurimi i aneksit |
| **A3.3** | Zgjerimi i kapaciteteve të qendrës shëndetësore / Gjinekologjisë dhe obstetrikës | Komuna DH | MSH | L | ASH | Mesatar | Komunal Donatorët | Sigurimi i aneksit |
| **A3.4** | Trajnimi i stafit të arsimimit dhe shëndetësisë | Komuna DE dhe DH | MASHT, MSH Donatorët | M | C | Minimum | Komunale dhe qeveritare donatorët | Numri i trajnimeve të mbajtura |
| **A3.5** | Studimi i fizibilitetit për hapjen e degës së fakultetit ose institut / qendres kërkimor) | Komuna DE | MASHT, donatori | L | ASH | Minimum | Komunale dhe qeveritare donatorët | Dokumenti i përpiluar |
| **A3.6** | Hapja e radio stacionit lokal | Komuna | Donatorët | M | ASH | Mesatar | Donatorët | Themelimi i radio stacionit |
| **A3.7** | Sigurimi i pajisjeve të teknologjisë së re në arsim dhe shëndetësi | Qendra Shëndetësore, Shkollat | DE DSH Donatorët | M | AM+C | Mesatar | Komunal Donatorët | Vendosja e pajisjeve |
| **A3.8** | Ofrimi i shërbimeve telefonike për kujdesin ndaj të moshuarve dhe njerëzve me nevoja të veçanta | Komuna DH | Donatorët | M | AM+C | Ulët | Komunal Donatorët | Ofrimi i shërbimeve të telefonisë |

Afat shkurtër (1-3 vjet); Afat mesëm (deri në 6 vjet); Afat të gjatë (më shumë se 6 vjet); vazhdimësi (aktivitet që është duke u zhvilluar në vazhdimësi;

Minimumi (<1 000 €); E ulët (<10 000 - ≥ 1 000 €); Mesatar (<500 000 - ≥ 10 000 €); i Lartë (≥ 500 000 €)

Page 2

## B. ZHVILLIMI EKONOMIK

Sipas analizave të qytetarëve të Komunës së Mamuşa/Mamushës/Mamuša përballen me mungesë të sistemit të ujitjes dhe aktiviteteve për promovimin e produkteve në regjion, me kredi dhe grande si dhe me shkarkime të mbeturinave dhe ujërave të zeza.
Një problem tjetër me të cilin është përballur komuna është mungesa e mundësive të punësimit për të tërhequr rinin të cilët nuk janë të interesuar për aktivitete bujqësore. Ka mungesë të trajnimeve, seminareve si dhe kredive dhe grandeve për profesionistët e rinj në një fushë të biznesit.
Parimet e promovuara nga PZHK-ja janë: një ekonomi e qëndrueshme dhe zhvillim i qëndrueshëm prandaj strategjia mundohet të arrij qëllimin vijues:

| Fushat tematike | Qëllimi | Strategjia | Kodi I projektit | AKCIONET / PROJEKTE / PROGRAME | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE E TJERA TË PERFSHIRA | PRIORITETI | Korniza Kohore | Pasojat financiare * | Treguesit e Monitorimit | Buxheti |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Lartë-L | Afat shkurtër-ASH | Minimale; | | |
| | | | | | | | Mesatar-M | Afat mesë -AM | Të Ulëta | | |
| | | | | | | | I Ulët- U | Afat gjatë -Agj | Mesatare; | | |
| | | | | | | | | E vazhdueshme -C | Të Larta ; | | |
| B. ZHVILLIMI EKONOMIK | Qëllimi: B1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat, sidomos në bujqësi / blegtori | Strategjia B1:t Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë/blegtorisë dhe biznesit | **B1:Zhvillimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale është përparuar dhe promovuar me anë të sigurimit të qasjes në tregjet lokale dhe regjionale** | | | | | | | | |
| | | | **B1.1** | Hartimi i programit për zhvillim të bujqësisë / blegtorisë | Komuna DSP | AM or LT | U | ASH | Të Ulëta | Dokumenti | Donatorë komunal |
| | | | **B1.2** | Hartimi PRrU-së për zonën ekonomike ( e njëjta si në D1.1) | Komuna DU | MASHT Donatorët | L | AM | Mesatare | URrP-ja | Donatorë Investitor Komuna. |
| | | | **B1.3** | Krijimi i njësisë apo departamentit të bujqësisë në kuadër të strukturës organizative të komunës | Komuna DSP | MBPZHR | U | ASH | Të Ulëta | Njësia / Sektori i themeluar | Komuna |
| | | | **B1.4** | Projektet e infrastrukturës fizike (njëjtë si në C 2.1 Dhe C 4.4) | Komuna DSP | MBPZHR Donatorët | M | AGJ | Të Larta | Rrjeti i sistemeve | Qendror (ministritë) Donatorë komunal |
| | | | **B1.5** | Hapja e degëve profesionale të agro-industrisë, agro-turizmit, bujqësisë, trajtimin e mbeturinave organike (njëjtë si në A1.2) | Komuna DE | MASHT, MBPZHR e donatorët | M | AM | Mesatare | Degët e shkollave | Komunës Qendrore dhe donatorët |

Page 1

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| B. ZHVILLIMI EKONOMIK | Qëllimi: B1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat, sidomos në bujqësi / blegtori | Strategjia B1:t Krijimi I kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë/blegtorisë dhe biznesit | B1.6 | Organizimi i trajnimeve në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë | Komuna DSP | MBPZHR / OJQ Universiteti i Kosovës Donatorë | L | ASH | Të Ulëta* | Numri i trajnimeve të mbajtur Numri i qytetarëve të | Komuna Donatorë |
| | | | B1.7 | T ë sigurohen kushtet për të rritur prodhimin e të korrave bujqësore-prodhimi gjatë të gjitha sezoneve - ndërtimi i serrave të përkohshme | Komuna DSP | MBPZHR Donator | L | AGJ | Të Larta | Numri i serrave të ndërtuara | Niveli qendror Donatorë |
| | | | B1.8 | Rritja e zonave të reja me fidanishte | Komuna | MBPZHR Donatorët Investitorët | M | AM | Mesatare | Hektarë të tokës me pemishte | Qendror Donatorë Investitor |
| | | | B1.9 | Të siguroj kushte të volitshme për zhvillimin e industrisë së lehtë | Komuna DSP Dhe U | PPP | M | AGJ | Të Larta | Numri i objekteve | Komuna Donatorë |
| | | | B1.10 | Të kultivoj bimë barishtore – të tilla si bima e Shën-Gjergjit, nenexhiku, kamomili | Komuna DSP | MBPZHR Donator | U | AM | Të Ulëta | Hektarë të tokës me bimë barishtore | |
| | | | B1.11 | Zhvillimi i tregtisë për shitjen e produkteve bujqësore-blegtorale duke përfshirë aktivitete ruajtjes si qendër e shpërndarjes - Ndërtimi i tregut dhe magazinimit të ftohtë dhe sigurimi i qasjes së lehtë | Komuna DSP | Donator | L | SHT | Të Larta | Tregu dhe ruajtja e ftohtë | Komunal Donatorë |

**B. ZHVILLIMI EKONOMIK**

**Qëllimi: B1 Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në të gjitha fushat, sidomos në bujqësi / blegtori**

**Strategjia B1:t Krijimi I kushteve për zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë/blegtorisë dhe biznesi**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **B1.12** | Zhvillimi i programeve për marketingun e produkteve eko | Komuna DPS | Donator Asociacioni I fermerëve dhe I | H | SHT | Të Ulëta | Eko-programet të zhvilluara | Komunal Donatorë |
| **B1.13** | Hapja e pikës së informacionit për promovimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, organizimi i festivalit | Komuna DPS | OJQ | H | SHT | Të Ulëta | Pika e Informacionit (zyra) e | Komunal Donatorë |
| **B1.14** | Promovimi i Agro-turizmit, gastro-turizmit dhe trashëgimisë kulturore specifike | Komuna DE | Asociacioni I fermerëve dhe I biznesit | M | AM | Mesatare | Numri i turistëve që vizitojnë komunën. | Komuna Donatorë |
| **B1.15** | Hapja e zyrës së informacionit turistik (brenda objekteve komunale) | Komuna DE | | M | AM | Të Ulëta | Zyra e informimit tw turistëve të jetë e themeluar | Komuna |
| **B2 :Ruajtja dhe zhvillimi i mëtejshëm i bizneseve të vogla dhe të mesme është promovuar** | | | | | | | | |
| **B2.1** | Organizimi i trajnimeve profesionale dhe punëtorive për profesionistët e rinj në një fushë të biznesit | Komuna | Asociacioni I Biznesit | M | AM | Të Ulëta | Numri i trajnimeve të mbajtur Numri i qytetarëve të certifikuar | Komunal Donatorët |
| **B3:Krijimi i kushteve për fermerët që të kenë qasje në kredi dhe subvencione** | | | | | | | | |
| **B3.1** | Marrëveshja në mes të nivelit qendror dhe lokal, institucioneve bankare për kredi | Komuna (DF) | Asociacionet (biznesit dhe fermerëve) Institucionet Bankare Oda Ekonomike | HL | AM | Mesatare | Marrëveshja e nënshkruar | Banka Qendrore e Kosovës Donatorë |
| **B3.2** | Të mbështeten fermerët që të marrin subvencione nga institucionet e nivelit qendror | Komuna DSP | MBPZHR Donatorë OJQ | U | AM | Mesatare | % e fermerëve që marrin subvencione | Niveli qendror Donatorë |

° Afat shkurtër (1-3 vjet); Afat mesëm (deri në 6 vjet); Afat të gjatë (më shumë se 6 vjet); Në vazhdimësi (aktivitet që është duke u zhvilluar vazhdimisht;
* Minimum (<1 000 €); ulët (<10 000 - ≥ 1 000 €); Mesatar (<500 000 - ≥ 10 000 €); I lartë (≥ 500 000 €)

Page 2

## C. INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Sa i përket infrastrukturës rrugore, sipas analizimit situatës Komuna është përballur me çështje si në vijim: relativisht cilësi e dobët e asfaltit rrugor, mungesa e sigurisë përgjatë rrugës kryesore/rajonale, mungesa e trotuarit dhe rrugëve lokale dhe atyre fushore, mungesa e parkingjeve publike, mungesa e linjave të autobusëve nga Mamushë për në Suharekë dhe Rahovec, mungesa e stacionit të autobusëve, mungesa e rrjetit të sigurt të lëvizshmërisë së ngadaltë. Lidhur me shërbimet publike ekziston nevoja për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese (uji, kanalizimi, mbeturinat, telekomunikacion, energji elektrike) dhe zgjerimit të zonave të reja të zhvillimit. Parimet e nxitura nga PZHK janë qasshmëria dhe qasje më të lehtë në shërbimet publike, ekonomi të qëndrueshme, interesat e përbashkëta të banorëve, prandaj propozon strategji për të arritur këto qëllime:

| Fusha tematike | Qëllimi | Strategjia | Kodi i projektit | VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET | INSTITUTCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTET E TJERA TË PËRFSHIRA | PRIORITETI- Lartë- L Mesëm-M Ulët- U | Afati KOHOR° Afat-shkurtër-ASH Afat-mesëm-AM Afat-gjatë-AGJ Në vazhdimësi-V | IMPLIKIMET FINANCIARE* Mesatare Ulët Mesatare Lartë | Indikatorët e monitorimit | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C. INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE | QëllimiC1: Përmirësimi, zgjerimi dhe ndërtimi i infrastrukturës fizike në komunë sipas standardeve moderne | Strategjia C1: Përmirësimi, zgjerimi dhe ndërtimi i infrastrukturës rrugore | **C1: Infrastruktura rrugore e përmirësuar dhe ofruar në të gjithë territorin e komunës për secilën kërkesë** | | | | | | | | |
| | | | C1.1 | Ndërtimi i rrugës Mamushë - Reti | Komuna DSHP | MT K. Rahovecit | L | ASH | Mesatar | Rruga e ndërtuar | Qendror Komunal |
| | | | C1.2 | Ndërtimi i rrugës Mamushë-Tërrne | Komuna DSHP | MT K.Suharekës | M | AM | Mesatar | Rruga e ndërtuar | Qendror Komunal |
| | | | C1.3 | Rehabilitimi i rrugës Mamushë- Prizren | Komuna DSHP | MT K. Prizrenit | U | AM | Mesatar | Rruga e rehabilituar | Qendror |
| | | | C1.4 | Mirëmbajtja e rrugëve ndërkomunale dhe lokale | Komuna DSHP | | L | V | Mesatar | Km e rrugës së shtruara | Komunal |
| | | | C1.5 | Zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës Mamushë - Novakë | Komuna DSHP | MT K. Prizrenit | U | AM | Lartë | Rruga | Komunal |
| | | | C1.6 | Rehabilitimi i rrugëve dytësore | Komuna DSHP | | M | AM | Mesatar | Km e rrugës së shtruara | Komunal |
| | | | C1.7 | Emërimi i rrugëve dhe instalimi i adresave | Komuna | Komuna KE | L | ASH | Ulët | Numri i rrugëve dhe shtëpive | Komunal KE |
| | | | **C2: Qasje më të lehtë në zonat bujqësore për fermerët e parashikuara** | | | | | | | | |
| | | | C2.1 | Hapja dhe shtrimi i rrugëve fushore me zhavorr (sikur se në B1.4) | Komuna DSHP | | L | ASH | Mesatar | Km e rrugës së shtruara | Komunal |
| | Qëllimi C2: Ofrimi menyrave efikase të transportit për njerëzit dhe mallrat | Strategjia C2:Krijimi i kushteve për mënyrat efikase dhe jo të motorizuara të transportit | **C3:C3: Inkurajimi i përdorimit te mënyrave të pa-motorizuara të transportit dhe siguroni një transport publik të sigurt** | | | | | | | | |
| | | | C3.1 | Zgjatja e trotuareve | Komuna DSHP | | M | ASH | Mesatar | Km e trotuareve | Komunal |
| | | | C3.2 | Ndërtimi i rrjetit të ngadalshëm të mobilitetit (sikurse në E5.2) aty ku është e mundur | Komuna DSHP | | M | ASH | Mesatar | Km e shtigjeve | Komunal |
| | | | C3.3 | Fushata për ngritjen e vetëdijes për përdorimin e mënyrave të pa-motorizuara të transportit | Komuna DSHP | OJQ | M | ASH | Ulët | % e përdorimit të mënyrave të pa-motorizuara | Komunal + OJQ-të |
| | | | C3.4 | Ndërtimi i stacionit të autobusëve | Komuna DSHP | Donatori | L | AM | Mesatar | Ndërtimi i stacionit të autobusëve | Komunal Donatori |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C. INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE | Qëllimi C3 : Përmirësimi i shërbimeve publike sipas standardeve moderne Evropiane | Strategjia C3: Zgjero, rehabilito dhe interveno për të përmirësuar shërbimet publike | **C4: Qasja në shërbimet publike (ujë, kanalizim, rrymë, telekomunikacion) të parashikuara** | | | | | | | | |
| | | | **C4.1** | Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit pr ndrtimet e reja | Komuna DSHP | KRU "Hidroregjioni Jugor" | M | ASH | Mesatar | Nr. i shtëpive me sistem të furnizimit me ujë | Komunal KRU |
| | | | **C4.2** | Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit dhe trajtimi | Komuna DSHP | KRU Hidroregjioni Jugor | M | ASH | Mesatar | Km e rehabilituara të rrjetit të ujit të pijes | Komunal KRU |
| | | | **C4.3** | Studimi I fizibiliettit mbi burimet e ujit të pijes | Komuna DSHP | DSH Instituti pë shëndet publik | M | AM | Mesatar | Ofrimi i studimit | Komunal Donatori |
| | | | **C4.4** | Ndërtimi i sistemit të ujitjes (sikurse në B1.4) | Komuna DSHP | MPBZHR | M | AGJ | Lartë | Km e sistemit të ndërtuar të ujitjes | Qendror Komunal |
| | | | **C4.5** | Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit pr ndrtimet e reja | Komuna DSHP | | M | ASH | Mesatar | Nr. i shtëpive me s. të kanalizimit | Komunal KRU |
| | | | **C4.6** | Rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit | Komuna DSHP | | M | ASH | Mesatar | Nr. i shtëpive me s. të kanalizimit | Komunal KRU |
| | | | **C4.7** | Zgjerimi i rrjetit të ujërave atmosferike | Komuna DSHP | Ministritë | M | AGJ | Mesatar | Km e rrjetit të zgjeruar | Qendror Komunal |
| | | | **C4.8** | Zhvendosja e tensionit të lartë të rrymës elektri | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | ASH | Mesatar | Nr. i shtyllave elektrike të parashikuara | Komunal |
| C. INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE | Qëllimi C3 : Përmirësimi i shërbimeve publike sipas atyre moderne Evropiane | Strategjia C3: Zgjero, rehabilito dhe interveno për të përmirësuar shërbimet publike | **C4.9** | Zgjerimi I rrjetit të ndriçimit publik | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | ASH | Mesatar | Nr. i ndriçimit publik | Komunal Donatori |
| | | | **C4.10** | Zgjerimi i rrjetit elektrik për ndrtimet e reja | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | ASH | Mesatar | Numri i shtëpive që u është ofruar rrymë elektrike | Komunal |
| | | | **C4.11** | Instalimi i rrjetit të ri elektrik të tensionit të ulët (nëntokësore) | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | AGJ | Lartë | km e rrjetit nr. i shtëpive me qasje në rrymë | Komunal Donatori |
| | | | **C4.12** | Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit për ndrtimet e reja | Komuna DSHP | Telekom Kosova/ IPKO | M | ASH | Mesatar | Km e rrjetit nr i shtëpive dhe rrjeti ekeltrik | Komunal PTK dhe IPKO |
| | | | **C4.13** | Ndërgjegjësimi mbi mundësinë e shfrytëzimit të ujit të shiut dhe energjisë alternative | Komuna DSHP | OJQ | M | ASH | Ulët | Numri i fushatave për ngritje të vetëdijes të ofruara | Komunal +OJQ |
| | | | **C5: Promovimi i menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, mbeturinave dhe ujërave të zeza përmes aktiviteteve adekuate** | | | | | | | | |
| | | | **C5.1** | Hartimi i planit të menaxhimit për trajtimin e mbeturinave të ngurta | Komuna DSHP | Donatori | M | AM | Ulët | Plani i menaxhimit | Municipal Donor |
| | | | **C5.2** | Ndërgjegjësimi për riciklimin e mbeturinave të | Komuna DSHP | OJQ | M | ASH | Ulët | nr. i fushatave, diskutimeve | Komunal +OJQ |
| | | | **C5.3** | Themelimi i kompanisë publike për Menaxhimi i mbetjeve të ngurta | Komuna | MMPS | M | ASH | Mesatar or Lartë | Kompania publike e themeluar | Qendror Komunal |
| | | | **C5.4** | Përcaktimi i lokacionit për deponi transferimi ose stacionin e riciklimit | Komuna | Donatori | L | ASH | Ulët | Deponia tranzite | Komunal Donatori |
| | | | **C5.5** | Ndërtimi I impiantit për trajtimin e ujërave të zeza | Komuna DSHP | Donatori | M | AGJ | Lartë | Impianti i ndërtuar | Donatori |

° Afat-shkurt (1-3 vite); Afat-mesëm ( deri 6 vite); Afat-gjatë( më shumë se 6 vite); Në vazhdimësi (aktiviteti është duke i zhvilluar në vazhdimësi;
*Minimum (< 1 000 €); Ulët (<10 000 - ≥ 1 000€); Mesatar (<500 000 - ≥10 000 €); i lartë (≥500 000€)

Page 2
Page 3

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C. INFRASTRUKTURA RRUGORE, TRANSPORTI DHE SHËRBIMET PUBLIKE | Qëllimi C3 : Përmirësimi i shërbimeve publike sipas atyre moderne Evropiane | Strategjia C3: Zgjero, rehabilito dhe interveno për të përmirësuar shërbimet publike | C4.9 | Zgjerimi I rrjetit të ndriçimit publik | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | ASH | Mesatar | Nr. i ndriçimit publik | Komunal Donatori |
| | | | C4.10 | Zgjerimi i rrjetit elektrik për zonën e re të banimit | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | ASH | Mesatar | Numri i shtëpive që u është ofruar rrymë elektrike | Komunal |
| | | | C4.11 | Instalimi i rrjetit të ri elektrik të tensionit të ulët (nëntokësore) | Komuna DSHP | Korporata Energjetike e Kosovës | M | AGJ | Lartë | km e rrjetit nr. i shtëpive me qasje në rrymë | Komunal Donatori |
| | | | C4.12 | Zgjerimi i rrjetit të telekomunikacionit për zonën e re të banimit | Komuna DSHP | Telekom Kosova/ IPKO | M | ASH | Mesatar | Km e rrjetit nr i shtëpive dhe rrjeti ekeltrik | Komunal PTK dhe IPKO |
| | | | C4.13 | Ndërgjegjësimi mbi mundësinë e shfrytëzimit të ujit të shiut dhe energjisë alternative | Komuna DSHP | OJQ | M | ASH | Ulët | Numri i fushatave për ngritje të vetëdijes të ofruara | Komunal +OJQ |
| | | | **C5: Promovimi i menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, mbeturinave dhe ujërave të zeza përmes aktiviteteve adekuate** | | | | | | | | |
| | | | C5.1 | Hartimi i planit të menaxhimit për trajtimin e mbeturinave të ngurta | Komuna DSHP | Donatori | M | AM | Ulët | Plani i menaxhimit | Municipal Donor |
| | | | C5.2 | Ndërgjegjësimi për riciklimin e mbeturinave të | Komuna DSHP | OJQ | M | ASH | Ulët | nr. i fushatave, diskutimeve | Komunal +OJQ |
| | | | C5.3 | Themelimi i kompanisë publike për Menaxhimi i mbetjeve të ngurta | Komuna | MMPS | M | ASH | Mesatar or Lartë | Kompania publike e themeluar | Qendror Komunal |
| | | | C5.4 | Përcaktimi i lokacionit për deponi transferimi ose stacionin e riciklimit | Komuna | Donatori | L | ASH | Ulët | Deponia tranzite | Komunal Donatori |
| | | | C5.5 | Ndërtimi I impiantit për trajtimin e ujërave të zeza | Komuna DSHP | Donatori | M | AGJ | Lartë | Impianti i ndërtuar | Donatori |

° Afat-shkurt (1-3 vite); Afat-mesëm ( deri 6 vite); Afat-gjatë( më shumë se 6 vite); Në vazhdimësi (aktiviteti është duke i zhvilluar në vazhdimësi;
*Minimum (< 1 000 €); Ulët (<10 000 - ≥ 1 000€); Mesatar (<500 000 - ≥10 000 €); i lartë (≥500 000€)

Page 3

## D. PËRDORIMI I TOKËS, STREHIMI DHE VENDBANIMET

Sipas situatës aktuale, Mamusha është përballur me çështjet e mëposhtme: mungesa e dokumenteve planifikuese dhe mekanizmave që do të drejtojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe kompakt, mungesa e vetëdijes për rëndësinë e planifikimit të duhur hapësinor, tendencat e zgjerimit drejt tokës bujqësore, toka e kufizuar për ndërtim dhe zhvillim të pakontrolluar. Parimet e nxitura nga PZHK janë zhvillimi i qëndrueshëm si dhe zhvillim kompakt, prandaj propozon strategjitë për të arritur këto qëllime:

| Fusha tematike | Qëllimi | Strategjia | Kodi i projektit | VEPRIMET/PROJEKTET/PROGRAMET | INSTITUTCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTET E TJERA TË PËRFSHIRA | PRIORITETI- Lartë- L Mesëm-M Ulët- U | Afati KOHOR° Afat-shkurtër-ASH Afat-mesëm-AM Afat-gjatë-AGJ Në vazhdimësi-V | IMPLIKIMET FINANCIARE* Mesatare Ulët Mesatare Lartë | Indikatorët e monitorimit | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| D. PËRDORIMI I TOKËS, STREHIMI DHE VENDBANIMET | Qëllimi D1 : Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tokës përmes mekanizmave ligjorë | StrategjiaD1 : Ngritja e kapaciteteve, ndërgjegjësimit dhe zbatimi i ligjit mbi kontrollin e zhvillimit | **D1:Janë ofruar instrumentet e planifikimit për mbrojtjen dhe kontrollin e zhvillimeve në komunë** | | | | | | | | |
| | | | D1.1 | Hartimi i PRU`s | Komuna DU | | L | AM | Mesatarë | Komunal | Hartimi i PRU |
| | | | D1.2 | Ndërmarrin aktivitete trajnuese për të forcuar kapacitetet e inspektoratit të ndërtimit / planifikimi për kontrollin e zhvillimit | Komuna DSHP | MMPH | M | V | Ulët | komunal; donatori | Numri i trajnimeve dhe aktiviteteve të mbajtura |
| | | | **D2: Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për procesin e planifikimit dhe të përfitimeve të kontrollit të zhvillimit** | | | | | | | | |
| | | | D2.1 | "Fushata ndërgjegjësimi mbi kontrollin e zhvillimit " | Komuna DU | OJQ, MAPL Donatori | L | V | Ulët (vjetor) | Donatori | Numri i fushatave ndërgjegjësuese të zhvilluara brenda një viti |
| | | | D1.2.2 | Broshura (dy here në vit) | Komuna DE | Departamentet e tjera komunale | M | V | Ulët (vjetor) | Komunal OSBE | Nr. i broshurave |
| | | | D1.2.3 | Themelimi i zyrës për informim | Komuna Zyra e Kryetarit | | M | AM | Ulët | Municipal | Zyra u themelua |
| | | | **D3: Rritja e cilësisë së zonave të banimit nëpërmjet hapësirave publike cilësore dhe shërbimet e nevojshme sociale dhe programet** | | | | | | | | |
| | | | D3.1 | hartimi i programit 3 vejqar për banim | Komuna DU | MMPH Donatori | M | AM-V | Ulët | Komunal Donatori | Programi |
| | | | D3.2 | Projekte për përmirësimin e hapësirave publike D3.1; 3.2; 3.3) | Komuna DSHP | Donatori | M | AM | Mesatarë | Komunal Donatori | Nr. i ndërtimeve dhe rehabilitimeve të hap.publike |
| | | | **D4: Mbushja dhe dendësimi brenda kufijve të vendbanimeve është inkurajuar** | | | | | | | | |
| | | | D4.1 | Krijimi i kadastrës së tokës bujqësore (regjistrim) në GIS | Komuna DSHP | MPBZHR | L | AM | Ulët | Komunal | GIS regjistrimet |
| | | | D4.2 | Rregullimi i ndërtimit sipas ligjeve në fuqi dhe kushteve të përcaktuara nga planet (PZHK dhe PRU) | Komuna DU | MMPH | L | AM | Ulët | Komunal | % e objekteve të ndërtuara dhe legalizuara |

° Afat-shkurt (1-3 vite); Afat-mesëm ( deri 6 vite); Afat-gjatë( më shumë se 6 vite); Në vazhdimësi (aktiviteti është duke i zhvilluar në vazhdimësi;
*Minimum (< 1 000 €); Ulët (<10 000 - ≥ 1 000€); Mesatar (<500 000 - ≥10 000 €); i lartë (≥500 000€)

Page 1

## E. MJEDISI, ZONAT E PRIRURA NDAJ RREZIKUT, DEGRADIMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE

Sipas situatës aktuale Mamuşa/Mamushë/Mamuša ka nevojë të ndërmarr masa për zbutjen dhe reduktimin e fatkeqësive natyrale dhe atyre të shkaktuara nga njerëzit (tërmetet, përmbytjet zjarret, prerja e drunjve, mbeturinat e ngurta dhe shkarkimi i ujërave të zeza në lumenj dhe hapësira të hapura. Gjithashtu, ka nevojë të ndërmerren masa në mënyrë që të parandaloj përdorimin e pesticideve dhe fetilizuesve artificial që mund të ndotin ujin token si dhe shkaktojnë humbjen e tokës bujqësore. Parimet e promovuara nga PZHK-ja janë zhvillime të qëndrueshme, prandaj propozon strategjitë për të arritur këto qëllime :

| Fushat tematike | Qëllimi | Strategjia | Kodi i projektit | AKCIONET / PROJEKTE / PROGRAMET | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE E TJERA TË PËRFSHIRA | PRIORITETI Lartë-L Mesatar-M I Ulët- U | Korniza Kohore' Afat shkurtër-ASH Afat mesë -AM Afat gjatë -AGJ E vazhdueshme - C | PASOJAT FINANCIARE* Minimale; Të Ulëta Mesatare; Të Larta | Monitorimi i indikatorëve | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| E. MJEDISI, ZONAT E PRIRURA NDAJ RREZIKUT, DEGRADIMI DHE TRASHËGI | Synimi E1: Mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit | Strategjia E1: Ngritja e vetedijesimit, e zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndër komunal | **E1: Është zvogëluar ndotja e tokës dhe lumit me mbeturina të ngurta, pesticideve dhe ujëra të zeza** | | | | | | | | |
| | | | E1.1 | Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ndotjes së ujit dhe tokës | Komuna DU | Asociacion shoqërisë civile donatorët | M | AM | Ulët | Nr. I kampanjave | Komunal shoqërisë civile donatorët |
| | | | E1.2 | Marrëveshja ndër-komunale - Mamusha-Suhareka për mbrojtjes e lumit Toplluha nga ndotja | Komuna | omuna e Suharekë: | L | ASH+C | Minimale | Marrëveshje | Komunal |
| | | | E1.3 | për ngritjen e vetëdijes për fermerët mbi prodhimet eko dhe kufizimin e përdorimit të pesticideve për prodhimet bujqësore | Komuna DSHP - Sektori bujqësor ? | Asociacion i fermerëve MBPZHR | M | AM | Ulët | Nr. i fushatave % të reduktuar në | Komunal Donatorët |
| | | | E1.4 | Trajnim për fermerët që lidhen me riciklimin e mbetjeve bujqësore (për prodhimin e plehrave) | ciacion fermerë | Projekti i Komisionit Evropian dhe MBPZHR | H | AGJ | Ulët | Nr i trajnimeve Nr. i fermerëve të | Granti I Komisionit Europian |
| | | | **E2: Ngritja e vetëdijes mbi legjislacionin mjedisor** | | | | | | | | |
| | | | E2.1 | Organizimi i trajnimeve për stafin komunal përkitazi me legjislacionin mjedisor | Komuna DU dhe inspektorati komunal për mjedis, | MASHT | L | C | Ulët | Nr i trajnimeve nr. të stafit të trajnuar | Komunal |
| | | | E2.2 | Hartimi i PLVM | Komuna D U | Donatorët | L | AM | Ulët | PLVM | Komunal Donatorët |
| | | | E2.3 | Aktivitete për ngritjen e vetëdijes për fëmijët | Komuna DE | Donatorët | L | C | Ulët | Numri i aktiviteteve | Komunal Donatorët |
| | | | **E3: E3: Burimet natyrore duke përfshirë biodiversitetin e mbrojtur nga degradimi** | | | | | | | | |
| | | | E3.1 | Ndërmarrjen e masave në planet komunale për ndërtimin e ndërtesave të reja sipas kërkesave të ligjit mbi ujërat | Komuna DU | DSHP | L | ASH | Mesatare | Nr. i aplikacionev e të refuzuara | Komunal |
| | | | E3.2 | Organizimi i programeve të veçanta për ngritjen e vetëdijes dhe edukimin e të rinjve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit | Komuna DE | MASHT OJQ-të Rinore dhe mjedisore | M | C | Ulët | Ir. i aktivitetev | Komunal Donatorët |

Page 1

**E. MJEDISI, ZONAT E PRIRURA NDAJ RREZIKUT, DEGRADIMI DHE TRASHËGIMIA KULTURORE**

**E2 Qëllimi: Zvogëlimi i rreziqeve dhe menaxhimi i ndikimeve negative në mjedis të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore apo aktivitetet e nxitura nga njerëzit**

**Strategjia E2: Preventivat, rregulloret dhe ngritja e vetëdijes për katastrofat dhe menaxhimi i rrezikut**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **E4: Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis, në fusha të prirura për fatkeqësi natyrore** | | | | | | | | |
| E4.1 | Pyllëzimi në jug perëndim të komunës, në mënyrë që të parandalohet erozioni | Komuna DSHP | MBPZHR Donatorët | M | AM | Mesatare | Numri i bimëve të mbjella apo sipërfaqes | Komunal Donatorët |
| E4.2 | Rregullimi i shtratit të lumit të lumenjve Toplluha dhe Terrnja në mënyrë që të parandalojë përmbytjet e tokës bujqësore | Komuna DU | Donator | L | AM | Lartë | Km e shtratit të lumit të rehabilituar | Komunal Donatorët |
| E4.3 | Të parandalohen ndërtimet në jug perëndim të komunës për shkak të defekteve normale | Komuna | Inspektorati I DU-së | L | ASH | Ulët | Nr i lejeve të refuzuara | Komunal |
| E4.4 | Hartimi i planit lokal për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe të nxitura nga njerëzit | Komuna | MPB Donatorët | M | AM | Ulët | Plani i hartuar | Komunal Donatorët |
| E4.5 | Trajnimi i stafit komunal që përballen me rrezikun e fatkeqësive | Komuna | Donator | M | ASH | Ulët | Numri i trajnimeve të mbajtura | Komunal Donatorët |
| **E5: Janë promovuar aktivitetet për reduktimin e efekteve të ndryshimeve klimatike** | | | | | | | | |
| E5.1 | Promovimi i politikave mjedisore nga komuna (taksat e reduktuar në rastin e efikasitetit të energjisë) | Komuna | MMPH donator | M | C | Ulët | Nr i lëshuar i tatimeve të reduktuara | Komunal Donatorët |
| E5.2 | Krijimi i korridorit të gjelbër përgjatë shtratit të lumit, i cili do të promovojë transportin e pa motorizuar (çiklizëm dhe ecje), të sigurojë lidhjes, zonat tampon, etj | Komuna DPS and U | Donator | M | AM | Mesatar | Km e korridorit të gjelbër | Komunal Donatorët |

**Synimi E3 :Mbrojtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe të objekteve rekreative dhe sportive**

**Strategjia E3: Revitalizimi, mirëmbajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrale si dhe i objekteve**

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **E6:Promovohet dhe zhvillohet revitalizimi i trashëgimisë kulturore** | | | | | | | | |
| E6.1 | Rivitalizimi i Sahat Kullës | Komuna | MKRS Donator | M | AM | Mesatar | Revitalizimi i orës | Qendrore Donatorët |
| E6.2 | Për të vënë varrezat dhe shtëpitë osmane në listën e përkohshme të trashëgimisë kulturore dhe burimet natyrore si një trashëgimi | Komuna | MKRS | L | ASH | Minimumi | Këto asete janë të përfshira në listën e MKRS... | Komunal |
| E6.3 | Ofrojë qasje të lehtë nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së varrezave | Komuna D U | DSHP | U | AM | Mesatar | Km e rrugëve | Komunal |
| **E7: Përmirësimi i objekteve sportive dhe rekreative sipas standardeve moderne** | | | | | | | | |
| E7.1 | Ndërtimi i objektit të sallës sportive dhe rekreative për shumë lloje të | Komuna DU | Donatorët | L | ASH | Lartë | Ndërtesa | Donatorët |
| E7.2 | Krijimi i shtigjeve për këmbësorë dhe çiklizëm, veçanërisht në rrugët kodrinore dhe përgjatë lumit (njëjtë si në C3.2) | Komuna DU DSHP | Donatorët - Komisionit Evropian | L | ASH | Mesatar | Km e rrugëve | Donatorët |

° Afat shkurtër (1-3 vjet); Afat mesëm (deri në 6 vjet); Afat të gjatë (më shumë se 6 vjet); në vazhdimësi (aktivitet që është duke u zhvilluar në vazhdimësi;
* Minimumi (<1 000 €); ulët (<10 000 - ≥ 1 000 €); Mesatar (<500 000 - ≥ 10 000 €); i Lartë (≥ 500 000 €)

Page 2

## F. KAPACITETET NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPESINORË DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE

Bazuar në situatën aktuale është e nevojshme avancimi I kapaciteteve njerëzore në fushën e planifikimit hapësinor dhe urban. Ky aktivitet do të inicoj krijimin e një mekanizmi që do të mbështes implementimin e planit. Njëra nga parimet që e mbështhet PZHK është qeverisja e mirë që promovon transparencën dhe barazinë në planifikim, kështu që është propozuar strategjia për të realizuar qëllimin.

| Fusha tematike | Qellimi | Strategjia F1:Aftesimi i | Kodi i projektit | VEPRIMET PROJEKTET PROGRAMET | INSTITUCIONI PËRGJEGJËS | SUBJEKTE TJERA TË PËRFSHIRA | Prioritet Lartë-L Mesëm-M Ulët-U | KOHËZGJATJA* Afatshkurtër-Ash Afatmesëm-AM Afatgjatë-Ag Vazhdimësi-V | IMPLIKIME FINANCIARE* Minimale Ulët Mesme Lartë | BUXHETI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **F. KAPACITETET NJERËZORE DHE INSTITUCIONALE NË FUSHËN E PLANIFIKIMIT HAPESINORË DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE** | **Qëllimi F1: Permiresimi I administrates publike ne KK Mamushe** | **Strategjia F1:Aftesimi i personeli te komunes ne administrate publike dhe ne zbatim te ligjit** | **F1: Ngritja e kapaciteteve të personelit komunal në fushën e planifikimit hapësinor dhe administrimit publik është siguruar** | | | | | | | |
| | | | F1.1 | Mbështetja e edukimit te avancuar dhe trajnimit te stafit komunal ne fushen e palnifikimit hapesinor dhe administrates publike | Komuna DU | MMPH Donator | L | V | Ulet | Qendror komunal donator |
| | | | F1.2 | Inkurajimi i inspektoriatit per monitorim dhe kontrollim te ndertimit | Komuna DU DSHP | MMPH | L | V | Ulet | Qendror komunal donator |
| | | | **F2: Baza e të dhënave në GIS është themeluar** | | | | | | | |
| | | | F.2.1 | organizimi I trajnimeve te stafit komunal | Komuna DU | Donator | M | ASH | Ulet | Komunal Donator |
| | | | F2.2 | themelimi I data bazes ne GIS dhe harmonizimi me te dhenat e ministrise | Komuna DU DSHP | MMPH Donator | M | ASH | Ulet | komunal donator |
| | | | F2.3 | Instalimi I software-it te GIS | Komunal DU DSHP | Donator | M | ASH | Ulet | Komunal Donator |
| | | | **F3: Procedurat rreth administrates publike janë lehtesuar** | | | | | | | |
| | | | F3.1 | Themelimi i zyres kryesore (one stop ) | Komuna | | L | ASH | Ulet | Komunal |
| | | | F3.2 | Broshurat dhe posteret mbi procedurat e marrjes se lejes ndertimore | Komuna DU | Donator | L | ASH | Ulet | Komunal Donator |
| | | | F3.3 | Aktivitetet vetëdijësuese për inkurajimin e qytetareve rreth aplikimit per leje ndertimore | Komuna DU | | L | ASH | Ulet | komunal |
| | | | F3.4 | Përdorimi i të dhënave nepermjet internetit | Komuna | | L | ASH | Medium | Te dhenat ne webfaqe |

Page 1

## *4.2 VLERËSIMI I STRATEGJIVE BAZUAR NË KRITERET E PËRCAKTUARA NË BAZË TË PARIMEVE, POLITIKAVE DHE LIGJIT*

Ka gjashtë strategji të propozuara brenda PZHK-së për komponentët në vijim:

A. Demografia dhe gjendja socio ekonomike (1),
B. Zhvillimi ekonomik (2);
C. Infrastruktura, transporti dhe shërbimet publike (3);
D. Përdorimi i tokës, banimi dhe vendbanimi (4);
E. Mjedisi, zonat e prirura për rreziqe dhe degradim, burimet natyrore dhe kulturore (5);
F. Kapacitetet njerëzore dhe institucionale në fushën e planifikimit hapësinor. (6).

Për çdo synim (siç përshkruhet në Kaptinën 2.1) ka një propozim strategjie me objektiva , veprime, afate kohore dhe implikime financiare.

Të gjitha strategjitë e propozuara janë në përputhje me natyrën e përgjithshme të PZHK-së e cila kryesisht qon në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, si atij natyror ashtu edhe fizik(mjedisit jetësor). Strategjitë e komponentit të dytë, të tretë dhe të katërt e kanë ndikimin më të lartë të drejtpërdrejtë në mjedis. Pasi që strategjia e komponentit të parë kryesisht përfshin veprime që lidhen me çështjet organizative ndikimi mjedisor është mjaft indirekt dhe ka natyrë pozitive

Disa veprime të propozuara nga komponenti i dytë për të arritur objektivin 1 (Zhvillimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale ka përparuar, i nxitur nga ofrimi i qasjes në tregjet lokale dhe rajonale), të tilla si ngritja e fabrikave dhe zbatimi i projekteve të infrastrukturës fizike mund të kenë ndikim të mundshëm negativ mjedisor nëse nuk kryhen në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, domosdoshmëria e qëndrueshmërisë është përmendur në qëllimin e përgjithshëm dhe këto veprime për të rigjallëruar aktivitetet tradicionale bujqësore / ekonomike kanë ndikim indirekt pozitiv në rast se cilësia e jetesës do të rritet si rezultat i këtyre veprimeve. Aktivitetet e propozuara për strategjitë e komponentit të tretë dhe të pestë, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë të rëndësishëm pozitiv në mjedis, nëse zbatohet, sepse ata janë të drejtuara për të adresuar dhe për të zgjidhur problemet kryesore aktuale mjedisore (Mbeturinat e ngurta, ujërat e zeza), gjithashtu edhe shmangia e mëtejshme e problemeve të tjera do të jenë të zgjidhura në qoftë se transporti jo- i motorizuar apo mundësitë e transportit të qëndrueshëm (publik) do të ofrohen për të mbrojtur trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Aktiviteteve për ngritjen e ndërgjegjësimit mjedisor kanë gjithashtu efekte pozitive edhe mjedisore gjë e cila pengon vazhdimin e degradimit të mjedisit. Strategjia e komponentit të pestë kryesisht përfshin veprime që lidhen me dokumentet e nevojshme për planifikimin, mbrojtjen e tokës dhe organizimin e zhvillimit të ardhshëm, i cili ka një natyrë pozitive dhe ndikim në mjedis

Strategjia e gjashtë me qëllimin e përgjithshëm për të rritur kapacitetet komunale në ofrimin e shërbimeve publike (duke përfshirë planifikimin urban) ka një ndikim të tërthortë pasi që vendimet e përgatitura në mënyrë efektive dhe vendimet e zbatuara të planifikimit do të parandalojnë/minimizojnë rreziqet e efekteve të mundshme negative që ndodhin në të ardhmen.

Në mënyrë që të vlerësohen qëllimet e propozuara, strategjitë, objektivat dhe veprimet në bazë të kritereve të përcaktuara me parimet strategjike të PZHK-së së Mamushës (PZHK-Faza e dytë, kapitulli 2.2)është kompozuar një tabelë vlerësimi(shih Shtojca X). Gjatë fazës së dyte, 8 parime të përgjithshme janë identifikuar për të

ndjekur  nevojat e zhvillimit në Mamushë, në përputhje me politikat aktuale kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe legjislacione të tilla si: qasja e integruar, interesat e përbashkëta të banorëve, zhvillimin e qëndrueshëm, ekonomi të qëndrueshme, qeverisjes së mirë urbane, parimit të subsidiaritetit, zhvillimit kompakt dhe partneriteti ndër komunal / bashkëpunimi.

# 5. DISPOZITAT PËR ZBATIM

Në mënyrë që të sigurojë zbatimin e planit, të gjithë akterët e kyçur në procesin e zbatimit duhet të respektojnë dhe të përmbushin dispozitat e detyrueshme të cilat janë të përfshira në kapitullin e dispozitave Zbatuese të PZHK-së së Mamushës. Zhvillimet e ardhshme në territorin e komunës do të bazohen në vendimet e duhura që duhet të ndërmerren nga autoriteti komunal.

## 5.1 UDHËZUES MBI PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL ÇËSHTJET E ZBATIMIT GJATË HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES DHE PLANEVE TJERA;

PZHK-ja duhet të jetë në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës (PHK) dhe të vendimeve për zhvillimet e rëndësishme në nivel kombëtar që duhet të respektohen plotësisht. PZHK-ja duhet të jetë bazë për hartimin e PRrU-së. PRrU-ja nuk duhet të bie ndesh me dispozitat e PZHK-së.

PZHK-ja duhet të jetë bazë për rregullimin e zhvillimeve jashtë zonës urbane;

PZHK-ja është një dokument orientues për zhvillimin e të gjithë sektorëve të tjerë në komunë.

Çdo propozim për ndryshime, plotësime apo shfuqizimin të PZHK-së janë subjekt i një shqyrtimi publik (*ashtu siç kërkohet me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor nr. 2003/14*) dhe do të miratohen nga Kuvendi Komunal.

## 5.2 KUSHTET E PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE PËR ÇËSHTJET RELEVANTE PER ZHVILLIM DHE PËRDORIM TË TOKËS NË KOMUNË

### 5.2.1 Kushtet për përcaktimin e destinacionit për përdorimin e tokës brenda territorit të komunës

Përdorimi i ardhshëm i tokës brenda territorit të komunës është përcaktuar në bazë të kushteve gjeografike, morfologjike,karakteristikave, vizionit dhe qëllimeve të planit të drejtpërdrejtë për zhvillimin e ardhshëm të komunës. PZHK-ja përcakton konceptin e mëposhtme të përdorimit të tokës:

1. Zonën e vendbanimit e cila është e përbërë nga banimi, shërbimet sociale, administrative, kulturore, sportive, tregtare, publike, shërbimet private, hapësirat publike-përfshirë edhe vendin e tregut
2. Tokën bujqësore
3. Zonën (shkurret) pyjore
4. Zonën ekonomike (biznesi dhe industria)
5. Parqet, sporti dhe rekreacioni, korridoret dhe rripat e gjelbra, zona e piknikut dhe lumenjtë
6. Zonës së trashëgimisë kulturore dhe zonës së trashëgimisë natyrore
7. Infrastruktura fizike (rruga, uji, kanalizimi dhe rrjeti i ngadalshëm lëvizshmërisë)
8. Zonat e prirura për katastrofa

### 5.2.2 Kushtet për rregulloren e hapësirës

- PZHK përcakton kushtet për rregulloren e hapësirës brenda të gjitha fushave për përdorimin e tokës në tërë territorin e komunës;
- Korniza e zhvillimit hapësinor dhe rregulloret e veçanta të përcaktuara nga ligjet përkatëse dhe Udhëzimet Administrative të LMS-së që rregullon kushtet e lokacionit për ndërtime;
- Zhvillimi do të bëhet vetëm në zonat e përcaktuara për këtë qëllim nga PZHK-ja.
- Për rregullimin e zhvillimeve në ZONËN A të zonës së vendbanimit do të hartohet Plani Rregullues Urban.
- Për deri sa Plani Rregullues Urban do të hartohet, natyra e zhvillimeve brenda zonës së vendbanimeve është vendosur nga elementet e rregullores hapësinore të parashikuara në kapitullin 6 të PZHK-së.
- Zhvillimet në toka bujqësore nuk do të lejohen, të përveç atyre për përdorim bujqësor siç rregullohet me Ligjin për tokën bujqësore nr. 02/L-26.
- Rregullorja për zhvillimet në fushat e gjelbra do të zhvillohet në respekt të kërkesave të Ligjit për mbrojtjen e Natyrës nr. 03/L-233 dhe Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025.
- Objektet ekzistuese duhet të adaptohet me masat e përcaktuara me PZHK.

### *5.2.3 Kushtet për rregullimin e zonave të ndërtimit në vendbanime*

- Zonat e ndërtimit në vendbanimet e Mamushës janë përkufizuar me PZHK. Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e destinuara për zhvillimin e vendbanimit.
- Zhvillimet do të bëhen vetëm brenda vendbanimit ekzistues dhe në Zonat në zgjerimin e propozuar, siç përcaktohet me anë të hartës së zonimit;
- Duke pasur parasysh se zhvillimi në masë të madhe duhet të bëhet në vendbanimet ekzistuese, përdorimi racional i tokës dhe zhvillimin i hapësirës së pazhvilluar do të zbatohen.
- Në zonat e ndërtimit, zhvillimet do të organizohen në bazë të kritereve, rregullave dhe parametrave të përcaktuara nga elementet e rregullores së hapësirës (kapitulli 6) në PZHK dhe Planet Rregulluese Urbane;
- Ndërtesat e ardhshme e banimit do të lejohen vetëm brenda zonës së demarkuar të zonës ndërtimore urbane. Procesi i zhvillimit të banimit do të bëhet nëpërmjet plotësimit, dendjes dhe zgjerimit të ri. Në të dy rastet zhvillimet do të kryhen në bazë të kushteve të dendësisë, lartësisë, dhe madhësisë së ndërtesave të vendosura nga PZHK-ja ( elementet e rregullores së hapësirës të dhëna në kapitullin 6). Zhvillimet do të jenë në linjë me Ligjin për Kadastrën nr. 04/L-013 dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013 mbi zbatimin e Ligjit për kadastër;
- Plani zhvillimor i komunës përcakton ruajtjen e tokës bujqësore të kategorive prej I deri IV;
- Në tokën bujqësore nuk do të lejohen ndërtimet, përveç atyre që lidhen me aktivitetet bujqësore të rregulluara me Ligjin për Tokën Bujqësore nr. 02/L-26;
- Infrastruktura publike dhe sociale duhet të ofrohen vetëm në ato zona ku zhvillimet e reja janë të lejuara me plan;
- Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, zhvilluesi duhet t`i ndjek hapat e kërkuara nga Ligji për Ndërtim nr. 04 / L - 110, përkatësisht Kodi i Unifikuar i Ndërtimit i Kosovës;
- Zhvilluesi duhet të respektojë kërkesat për mbrojtjen e mjedisit gjatë ndërtimit

- ose rindërtimit ashtu siç kërkohet me ligjet përkatëse;

### 5.2.3(a ) Objektet me rëndësi për Kosovën

- Komuna vazhdimisht do të monitoroj dhe kontrollojë zhvillimet edhe në rrugët rajonale të territorit të saj.
- Zhvillimi krahas rrugëve rajonale bazohet në kushtet e përcaktuara me Ligjin për Rrugët nr. 2003/11 (neni 26), Ligji për Modifikimin e Ligjit për Rrugët nr. 03/L-120 (neni 16) dhe elementet e rregullores së hapësirës brenda PZHK-së;
- Zhvillimet në dhe afër zonave të prirura për fatkeqësi para se të ndërmerren masat e nevojshme do të ndalohen ashtu siç kërkohet me Ligjin për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027;
- Komuna do të ndalojë zhvillimet në zonat e pasura me burime natyrore dhe kulturore;

### 5.2.3 (b) Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve;

- Për zonat që nuk janë të përcaktuara si zona të ndërtimit nga PZHK-ja dhe ku ndërtimi nuk është i lejuar, ajo duhet të sigurohet:
- Ruajtja e tokës bujqësore;
- Ruajtja e peizazhit;
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore;
- Parandalimi i ndikimeve të mundshme negative mjedisore nga zhvillimet (estetika, uji, kanalizimi, mbeturinat, zhurma);
- Në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14 - Neni 17, ndërtesat të cilat mund të planifikohen jashtë zonës së ndërtimit janë:
- Objektet e mbrojtjes civile;
- Objektet për mbrojtje nga zjarri dhe materialet e rrezikshme;
- Objektet për menaxhimin e resurseve ujore;
- Objektet për transport dhe infrastruktura të tjera;
- Objektet për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit të mineraleve të papërpunuara;
- Objektet për rekreacion dhe turizëm; dhe
- Objektet për bujqësi, pylltari, gjueti, aktivitet e peshkimit dhe turizmit rural;
- Komuna nuk është e obliguar të sigurojë infrastrukturën për zhvillimet jashtë zonës së ndërtimit.

### *5.2.4 Kushtet për rregulloren e veprimtarive ekonomike*

Edhe pse zhvillimi ekonomik i Mamushës është i orientuar në prodhimin bujqësor, zhvillimi i sektorëve të tjerë të bujqësisë (tregtia dhe industria e lehtë), si dhe sektori i turizmit do të ketë aktivitete të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të komunës.

PZHK-ja ka përcaktuar zonën për zhvillimin e aktiviteteve ekonomike. Zona gjendet në pjesën jugore të komunës dhe si opsion alternativë është sipërfaqja e tokës e NSH-ve të cilat mund të përdoren pasi çështjet pronësore do të zgjidhen. Veprimtaritë ekonomike do të zhvillohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Zonat Ekonomike nr. 04/L-159.

#### 5.2.4(a) Kushtet për vendosjen e veprimtarive bujqësore

- Toka bujqësore e cilësisë së lartë është potenciali kryesor për zhvillimin ekonomik të komunës. Prandaj, kjo tokë nuk mund të përdoret për qëllime jo bujqësore, përveç siç parashihet në Ligjin për Tokë Bujqësore. Nr 02/L-26 dhe PZHK.
- Në mënyrë që të ruajë cilësinë e tokës është e ndaluar shkarkimi dhe asgjësimi i substancave të rrezikshme dhe toksike, dhe përdorimit të pakontrolluar të kimikateve të dëmshme dhe fertilizimit të tepruar.
- Komuna do të inkurajojë kultivimin e frutave dhe bimëve bimor në zonën veri - perëndimore të Mamushës;
- Për zhvillimin e blegtorisë Komuna do të bëjë një marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për të siguruar qasje fermerëve në filiale të ndryshme;
- Aktualisht bletaria është zhvilluar mbi baza individuale. Zgjerimi i këtij aktiviteti do të inkurajohet nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe krijimin e kushteve për mbështetje financiare;

#### 5.2.4(b) Kushtet për vendosjen e veprimtarive industriale

- Zhvillimi i aktiviteteve industriale është i kushtëzuar me ndikimin e tyre në mjedis.
- Aktivitetet ekonomike do të zhvillohen duke ndërmarrë masat e kërkuara nga
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025;
- Komuna duhet të sigurojë tokën dhe infrastrukturën për të inkurajuar investimet e reja në zhvillimin e industrisë së lehtë dhe aktiviteteve bujqësore;
- Plani zhvillimor i komunës ka përcaktuar zonën për zhvillimin e aktiviteteve agro-industriale. Plani rregullues urban për këtë zonë do të hartohet në përcaktimin e kushteve të veçanta dhe nevojën për kryerjen e një VSM-je;
- Në mënyrë që të zvogëlojë kufizimet në mes zonës ekonomike dhe zonës rezidenciale Plani Zhvillimor Komunal ka rekomanduar një tampon zonë;
- Plani Zhvillimor Komunal propozon hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën e tokës së NSH-ve (përdorimi i propozuar është zona ekonomike për zhvillimin e bujqësisë dhe aktivitetet bujqësore). Në

të ardhmen, të gjitha lejet e ndërtimit për zhvillim në këtë fushë, do të lëshohen në bazë të kushteve të përcaktuara nga PRrU-ja;

- Komuna duhet të kërkojë nga operatorët e aktiviteteve industriale ekzistuese në zonën e vendbanimit brenda periudhës prej 2 vitesh për të ndërmarrë masa për të parandaluar ndotjen e mjedisit;
- Brenda periudhës prej 15 muajve. Komuna do të përcaktojë ndëshkime dhe gjoba ndaj operatorëve të industrisë që nuk respektojnë kërkesat e PZHK-së;
- Komuna do të mbështesë arsimimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore në fushat profesionale që lidhen me zhvillimin ekonomik të propozuar.
- Komuna do të bashkëpunojë me organizata të ndryshme dhe komunat fqinje në zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët të tilla si infrastruktura teknike, rrugët ndër komunale dhe linjat e ujit;
- Në nxitjen e rritjes ekonomike, komuna do të angazhohet në promovimin dhe marketingun e prodhimeve vendore;

### 5.2.4(c) Kushtet për vendosjen e veprimtarive tregtare dhe komerciale

- Siç është përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal aktivitetet tregtare dhe komerciale do të zhvillohen përgjatë rrugës rajonale/kryesore dhe në kombinim me aktivitetet të tjera. Kjo zonë ofron mundësi të shitjes me pakicë, të punësimit dhe mundësi komerciale.
- Zona ekzistuese përgjatë rrugës kryesore është një destinacion tradicional për këmbësorë që duhet të mirëmbahet dhe të zgjerohet në lidhje me qasjen e përshtatshëm edhe për vetura.
- Zhvillimet në këtë fushë duhet të përfshijnë tipare universale dhe pa pengesa të projektimit në mënyrë që të rrisin qasjen për lëvizshmëri të ulët dhe për personat me nevoja të veçanta.
- Tregtia dhe zhvillimet për përdorim të shumëllojshëm përgjatë rrugës regjionale/kryesore duhet të përmirësohet përmes ndërtesave tërheqëse dhe dizajnit të peizazhit në mënyrë që t`i shtoj vlerën rrugës.
- Komuna do të hartoj rregulloret për vendosjen e zhvillimeve për përdorim të shumëllojshëm duke përfshirë përdorimin për banim dhe përdorimin komercial në mënyrë vertikale dhe horizontale, ku përdorimet e katit përdhes duhet të akomodojnë aktivitetet tregtare dhe afariste.
- Ndikimi negativ që janë pasoj e aktiviteteve komerciale të tilla si zhurma, ngarkimi
- dhe mbeturinat, në zhvillim të mjedisit jetësor do të parandalohen me anë të respektimit të kërkesave të Ligjit për mbrojtjen nga zhurma nr. 02/L-102, Ligji për Mbeturina nr. 04/L-060l;
- Në mënyrë që të rritet marketingu i produkteve bujqësore dhe aktiviteteve komerciale, Komuna me mbështetjen e donatorëve do të ndërtojë vendin e tregut dhe frigoriferit në përputhje me standardet;
- Ndikimi negativ që rrjedh nga aktivitetet komerciale të tilla si zhurma, ngarkimi
- dhe mbeturinat, në zhvillim të mjedisit jetësor do të parandalohen me anë të respektimit të kërkesave të Ligjit për mbrojtjen nga zhurma nr. 02/L-102, Ligji për Mbeturina nr. 04/L-060l;

### 5.2.4(d) Kushtet për vendosjen e veprimtarive turistike

- Komuna do të rivendosë/revitalizoj objektet e trashëgimisë kulturore: varrezat Osmane, Sahat Kullën dhe të shtëpitë e vjetra, si dhe të përmirësoj qasjen në këto vende;
- Komuna do të hapë zyrën informative dhe do të organizojnë aktivitete të promovimit;

### 5.2.5 Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike

- Komuna duhet të rezervoj tokën për objektet e institucioneve publike dhe zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhje me zhvillimet e propozuara në PZHK.
- Komuna mund të ndajë tokën për përdorim të përbashkët të aktiviteteve publike: arsim, shëndetësi, shërbime sociale, qendra të komunitetit.

#### 5.2.5(a) Arsimi, kultura dhe objektet shëndetësore

- Komuna duhet të ndërtojë qendrën e të rinjve për shumë aktivitete (e cila do të përdorët për arsim, kulturë dhe aktivitete sportive) në përputhje me standardet;
- Zgjerimi i kapaciteteve të shkollës së mesme ekzistuese do të planifikohet në bazë të udhëzimeve të ofruara nga MASHT-i.
- Komuna duhet të krijojë degë të reja në arsimin e mesëm profesional lidhur me bujqësinë
- Oborret e shkollave duhet të pajisen me fushat të gjelbra, fushat sportive të hapura dhe objekte sportiv të mbyllura. Oborret e shkollave duhet të jenë të hapura për përdorim publik që të përdoren për sportin dhe aktivitetet rekreative të banorëve;
- Komuna duhet të zgjerojë kapacitetet e qendrës shëndetësore për mjekësi familjare, në mënyrë që të sigurojë hapësirë për kujdesin e të moshuarve;
- Kushtet e lokacionit, kushtet urbanistiko-teknike do të përcaktohen në TeR të projektimit të projektit; Të gjitha objektet për veprimtari publike duhet të përmbushin normat dhe standardet e kërkuara për qasje të lirë të njerëzve me nevoja të veçanta;

#### 5.2.5(b) Hapësirë të gjelbër dhe fushat rekreativo-sportive

- Komuna duhet të rezervojë në maksimum shpërndarjen e hapësirave të gjelbra dhe për të krijuar hapësira sportive dhe zona rekreative
- Komuna do të mbështesë mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e zonave natyrore brenda zhvillimeve private, të cilat janë përdorur si hapësirë publike të hapura.
- PZHK-ja i ka caktuar zonat natyrore përgjatë lumit Toplluha dhe Ternja si tampon zona. E njëjta gjë është paraparë përgjatë korridoreve infrastrukturore dhe në mes të zonës industriale dhe rezidenciale.
- PZHK-ja ka caktuar zonën natyrore përgjatë lumit Toplluha si një sistemin të madh të hapur të korridorit të gjelbër;
- Zona rekreativo-sportive duhet të zhvillohet duke u bazuar në koncept planin për një gamë të hapësirave publike të hapura që lidhin zonën e banimit me objektet rekreative dhe zonat natyrore dhe të krijojë një rrjet të vazhdueshëm të shtigjeve me përdorim të shumëllojshëm. Lidhjet e trotuareve të mira për këmbësorë dhe shtigjeve për biçikleta duhet të theksohen.

- Brenda zonës rekrativo-sportive do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve sportive të hapura dhe të mbyllura, hapësirat e parkimit, restorante dhe dyqane të vogla që lidhen me objektet sportive;
- Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve sportive të hapura dhe të mbyllura, hapësirat e parkimit, restorante dhe dyqane të vogla që i shërbejnë pajisjeve sportive;
- Komuna do të ndërtojë objekte të mbyllura sportive dhe objekte rekreativ sipas standardeve teknike;

### *5.2.6 Kushtet për vendosjen e korridoreve apo shtigjeve, sipërfaqet lidhëse dhe sistemet tjera të infrastrukturës;*

- Komuna duhet të hartojë planin e detajuar të lëvizshmërisë që duhet t`i adresoj kërkesat për trafikun e veturave, këmbësoreve, biçikletave, parkingut, transportit publik, lëvizjen e mallrave dhe komponentëve të tjerë të sistemit të transportit;
- Gjatë ndërtimit të rrugëve duhet të merret në konsideratë gjerësia e brezit mbrojtës të përcaktuar me Ligjin mbi Rrugët Nr 2003/11, dhe amendamentimin e ligjit nr. 2003/11 nr. 03/l-120):
- Në një zonë të përcaktuar si rripi mbrojtës i rrugës nuk mund të hapet miniera, të ndërtohen liqene artificiale, fabrika dhe instalime të ngjashme që mund të dëmtojnë rrugët publike në një distancë më pak se:

  a) 100 metra nga magjistralja

  b) 60 metra nga autostrada

  c) 40 metra nga rrugët rajonale

  d) 30 metra nga
- Në një zonë të përcaktuar si rripi mbrojtës i rrugës nuk mund të ndërtohen, objekte, banesa, zyra, bunarë, gropa septike, transmetues dhe instalime të ngjashme që mund të dëmtojnë rrugët publike, në një distancë më pak se:

  a) 40 metra nga magjistralja

  b) 20 metra nga autostrada

  c) 10 metra nga rrugët lokale dhe rajonale
- Komuna me mbështetjen e Ministrisë së Transportit do të rehabilitojë dhe ndërtoj rrugët rajonale Prizren-Suharekë-Mamushë, Rahovec-Mamushë sipas rregulloreve teknike dhe kritereve të parapara si gjerësia, pjerrësia, shtresa, trashësia, etj, të parapara me ligjet në fuqi dhe profilet rrugore të paraqitura në PZHK;
- Komuna do të ndërtojë rrugën Mamushë-Novakë;
- Komuna duhet të ndërtojë rrugët lokale për zonën e shtëpive të reja në përputhje me rregullat teknike dhe kriteret si gjerësia, pjerrësia, shtresa, trashësia, etj, të parapara me ligjet në fuqi dhe profilet rrugore të paraqitura në PZHK
- Lagjet e reja do të sigurojë një shkallë të lartë të rrugëve për këmbësorë dhe lidhjes për të lejuar lëvizshmëri të sigurt dhe efikase për të gjitha llojet e transportit dhe përshkueshmëri të mirë të zonës.
- Komuna do të ndajë tokën në afërsi të vendndodhjes së tregut dhe frigoriferit për ndërtimin e stacionit të autobusëve;

- Aty ku është e mundur, Komuna do të bëjë hapësira parkingu  që do të vendosen në dispozicion për publikun krahas rrugëve.
- Komuna duhet të integroj rrugët  e këmbësorëve dhe shtigjet e biçikletave krahas rrugëve;
- Rrugët dhe planet tjera për projektet e hapësirave publike duhet të përfshijnë kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr .2001/19 për kushtet teknike për ndërtimin e objektit në lidhje me qasjen e personave me nevoja të veçanta.
- Komuna me mbështetjen e donatorëve do të instalojë ndriçimin publik përgjatë rrugëve kryesore; Punimet për ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes elektrike duhet të zbatohen në përputhje me kodet teknike, të përgatitura nga kompanitë energjetike dhe të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Ndërsa planifikimi dhe ndërtimi i rrugëve të reja, rrugët duhet të jenë të vendosura në mënyrë që të mos shkaktojnë ndikime negative mjedisore (të shkurtojnë korridorin e gjelbër, të ndodhen në një zonë të vlefshme natyrore);
- Komuna me mbështetjen e donatorëve do të instalojë ndriçimin publik përgjatë rrugëve kryesore; Punimet për ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes elektrike duhet të zbatohen në përputhje me kodet teknike, të përgatitura nga kompanitë energjetike dhe të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Ndërsa planifikimi dhe ndërtimi i rrugëve të reja, rrugët duhet të jenë të vendosura në mënyrë që të mos shkaktojë ndikime negative mjedisore (të shkurtojnë korridorin e gjelbër, të ndodhen në një zonë të vlefshme natyrore);
- Komuna me mbështetjen e donatorëve do të instalojë ndriçimin publik përgjatë rrugëve kryesore; Punimet për ndërtimin apo zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes elektrike duhet të zbatohen në përputhje me kodet teknike, të përgatitura nga kompanitë energjetike dhe të miratuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Ndërsa planifikimi dhe ndërtimi i rrugëve të reja, rrugët duhet të jenë të vendosura në mënyrë që të mos shkaktojë ndikime negative mjedisore (të shkurtojnë korridorin e gjelbër, të ndodhen në një zonë të vlefshme natyrore);
- Pasi shtigjet rrugore janë të përcaktuara nga profilet rrugore, toka private në shënjestër është konvertuar në tokë për përdorim publik dhe nuk janë marrë parasysh gjatë përcaktimit të kushteve të ndërtimit, siç përcaktohet nga elemente brenda rregullores së PZHK-së;

### *5.2.7 Masat për mbrojtjen e peizazhit, vlerave natyrore, kulturore dhe pasurive historike;*

- Komuna do të ndërmarrë projekte dhe do të hartojë politikat për mbrojtjen e mjedisit, pasurive natyrore dhe kulturore;
- Për mbrojtjen e këtyre pasurive komuna do të bashkëpunojnë me organizata lokale, ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare publike, shoqëritë civile dhe organizatat profesionale që të organizojnë aktivitete për ngritjen e ndërgjegjësimit;
- Në mënyrë që të mbrojë tokën bujqësore komuna nuk do të lejojë zhvillimet në këtë fushë;
- Komuna do të rehabilitojë dhe të sigurojë mirëmbajtjen e shtratit të lumit Toplluha përgjatë të cilit do të ndërtohet korridori i gjelbër me shtigje për shumë aktivitete për sport dhe rekreacion;
- Komuna do të zhvendosë industritë jashtë zonës urbane, në mënyrë që të shmang ndotjen e ajrit dhe do të planifikojë tampon zona përkatëse  në qoftë se është e nevojshme për të zbutur ndikimet e mundshme negative nga zonat industriale të zonave të banuara ose zonave natyrore;
- Për industritë ekzistuese brenda zonës urbane kërkohet që të zbatojnë kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit nr. 03/L-025;
- Komuna duhet të gjejë zgjidhje për impiantin e trajtimit të ujërave të zeza (me fondet e donatorëve, MMPH-ja  në bashkëpunim me komunat fqinje);
- Komuna së bashku me institucionet dhe organizatat relevante do të hartojë Planin Lokal të Veprimit për Mjedisin;
- Në mënyrë që të parandaloj erozionin, Komuna do të ndërmarrë aktivitete të tilla si: parandalimi i prerjes së drunjve, pyllëzimin dhe kufizimin e zhvillimit në këtë fushë;
- Komuna duhet të ndalojnë ndërtimet e pompave të benzinës brenda zonës së vendbanimit dhe të ndërmarrin masat për pompat ekzistuese;
- Komuna do të ndërmarrë masat e përcaktuara në Ligjin për Ujin Nr. 04/L-147;
- Komuna do të parandalojë zhvillimet në afërsi të zonës të prirura për tërmete dhe do të kërkojë aplikimin e teknikave të ndërtimit që janë të qëndrueshme ndaj tërmetit;
- Komuna duhet të hartojë Planin Lokal për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, siç kërkohet me Ligjin për Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/L-027);
- Komuna do të marrë pasurit e trashëgimisë kulturore nën mbrojtje dhe për të menaxhuar zhvillimin e tyre, komuna në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të organizojnë fushata të vetëdijesimit për qytetarët lidhur me mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;

### *5.2.8 Mënyrat e trajtimit të mbeturinave të ngurta dhe të ujerave të zeza;*

#### 5.2.8(a ) Mbeturinat e ngurta

- Komuna do të hartojë planin lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në harmoni me Planin për Menaxhimin e Mbeturinave të Republikës së Kosovës. Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave të ngurta duhet të zbatohet nga komuna. Përmbajtja e planit është paraqitur në Ligjin për Mbeturina nr. 04/L-060.
- Sipas Ligjit mbi Mbeturinat dy apo më shumë komuna mund të hartojnë një plan të përbashkët sipas nevojave të tyre dhe marrëveshjes. Komuna e Mamushës duhet të merr në konsideratë hartimin e planit të përbashkët lokal për administrimin e mbeturinave të ngurta me komunat e Prizrenit dhe Rahovecit.
- Komuna rregullon aktivitetin mjedisor të menaxhimit të mbeturinave dhe organizon menaxhimin brenda territorit të saj përmes dhënies së lejeve për menaxhimin e mbeturinave. Detyrimet e mbajtësit të mbeturinave, prodhuesit të mbeturinave, transportuesit, operatorit për trajtimin e mbeturinave dhe detyrimet e operatorit në deponi janë të rregulluara me Ligjin për mbeturinat.
- Komuna organizon, grumbullon, trajton dhe rregullon organizimin dhe mënyrën e ndarjes së mbeturinave për riciklim, në përputhje me dispozitat ligjore mbi mbeturinat dhe në përputhje me planin e saj lokal. Mbeturinat e rrezikshme (eksplozive, oksiduese, shumë të ndezshme dhe të ndezshme, toksike, etj), dhe mbeturinat e veçanta që janë mbledhur veç e veç dhe transportohen me mjete përkatëse të transportit.
- Komuna do të themelojë ndërmarrjen lokale në pronësi publike për trajtimin e mbeturinave;
- Komuna ka përcaktuar lokacionin për deponi transite apo stacion të riciklimit të mbeturinave, ku do të përzgjidhen dhe më pas me traktorë do të transferohen në depon rajonale që ndodhet në komunën e Prizrenit. Ndërtimi i objekteve dhe pajisjeve për menaxhimin e mbeturinave do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore për trajtimin e mbeturinave (Neni 23). Mbledhja, ruajtja (vende ku mbeturinat janë ruajtur-transferuar tek stacioni duhet të jenë të përgatitura teknikisht për deponim të përkohshëm, afati kohor për ruajtjen e përkohshme nuk mund të jetë më shumë se 3 vjet), trajtimi, ripërdorimi dhe përpunimi i mbeturinave bëhet në përputhje me dispozitat ligjore të dhëna nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Mbeturinat, pasi trajtimit, do të deponohen në deponitë (Ambiente të licencuara).
- Komuna do të rrisë numrin e kontejnerëve të mbeturinave; Komuna do të hartojë raportin vjetor për menaxhimin e mbeturinave i cili duhet të dorëzohen tek Ministria (Ligjit mbi Mbeturinat Nr. 04/L-060, Neni 58);

#### *5.2.8.(b)* Trajtimi i ujërave të zeza

- Komuna do të ndërmarrë masa për të parandaluar shkarkimin e ujërave të zeza në lumenj, të tilla:
- Trajtimi i ujërave të zeza do të bëhet në një impiant për trajtimin e ujërave të zeza (kolektor), që do të ndërtohet në bashkëpunim me komunat fqinje ose me anë të financimit nga donatorët

- Komuna duhet të kërkojë leje nga Autoriteti Rajonal për Shtratin e Lumit për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura; Komuna do të ndërmarrë rehabilitimin e rrjetit ekzistues të kanalizimeve dhe zgjerimin e saj në zonat ku ky rrjet mungon;
- Komuna duhet të kërkojë leje nga Autoriteti Rajonal për Shtratin e Lumit për rehabilitimin dhe zgjerimin e sistemit të ujit të tanishme dhe kanalizimit;
- Komuna nuk do të lejoj lidhjet individuale të paligjshme në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Rrjeti i ujërave të zeza dhe rrjeti i shiut duhet të zhvillohet ndaras. Komuna do të zgjerojë sistemin e kullimit të ujërave të shiut krahas rrugëve;

### *5.2.9 Masat për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis*

- PZHK-ja ka identifikuar zonat me ndotje dhe degradim të mjedisit dhe propozon veprime të përgjithshme të tilla si:
- Komuna në bashkëpunim me institucionet dhe organizatat relevante do të hartojë Planin Lokal të Veprimit në Mjedis; Planin për mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve / shkurreve dhe Planin për mbrojtje nga natyra dhe nga fatkeqësitë e tjera;
- Komuna në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse, institucionet dhe organizatat e tjera do të zbatojë programe dhe projekte të ndryshme duke u fokusuara në mbrojtjen e mjedisit;
- Leja për aktivitete ekonomike do të lëshohet vetëm nëse zhvilluesit do të aplikojnë teknologji bashkëkohore që nuk do të krijojë ndotje në ajër, ujë dhe tokë;
- Komuna në bashkëpunim me institucionet e tjera dhe organizatat do të organizojë aktivitete për ngritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e tokës dhe ujit;
- Komuna duhet të kërkojë kryerjen e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Projektet që janë të listuara në një listë të VNM-së (shih Ligjin mbi VNM) ose Vlerësimin Strategjik Mjedisor nëse është relevante për planet ose programet;
- Komuna do të lëshojë lejet mjedisore për projekte të cilat nuk janë subjekt i VNM-së. Lejet mjedisore komunale që janë ndërmarrë gjatë procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit (Udhëzimi Administrativ nr. 10/2012 mbi lëshimin e lejes mjedisore komunale)
- Komuna duhet vazhdimisht të pastroj shtratin e lumit dhe të largoj deponit ilegale;
- Komuna do të ndërtojë (transferoj) deponi transite, si dhe trajtimin e mbeturinave bimore sipas standardeve të përcaktuara nga ligjet;
- Në mënyrë që të zbuten ose të reduktohen zhurmat pranë zonës së banimit do të ndërmerren masat duke ndërtuar barrierat dhe rripat e gjelbër;
- Komuna duhet të promovojë përdorimin e energjisë alternative (energjia diellore, biomasa, era);

### *5.2.10 Masat për parandalimin e ndikimit negativ social;*

- Me qëllim që të parandalojë ndikimin negativ social, Komuna do të ofrojë lehtësi të ndryshme që ofrojnë opsione për aktivitetet sociale, rekreative dhe sportive, siç është propozuar në PZHK (zgjerimi i objekteve shkollore dhe shëndetësore, ndërtimi i qendrës për shumë aktivitete, ndërtimi i aneksit për të moshuarit, rregullimi i hapësirave të sportit dhe rekreacionit,....)
- Komuna do të organizojë dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e banorëve në aktivitetet kulturore, fizike dhe sportive të banorëve për të nxitur mirëqenien e komunitetit.
- Procesi i projektimit për hapësirat publike do të kryhet në mënyrë transparente me pjesëmarrjen dhe me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara për të siguruar që nevojat e tyre do të plotësohen. Komuna do të përfshijë dhe do të konsultohet me banorët e zonës urbane për të cilat PRrU-ja është duke u hartuar, në mënyrë që të përmbushin kërkesat e tyre;
- Të gjitha objektet e infrastrukturës sociale duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje të karakteristikave të projektimit pa pengesa që rrit qasjen për lëvizshmëri të ulët dhe për personat me nevoja të veçanta (qasja në hyrje të ndërtesës, vend parkime, vendkalime, trotuare, etj.)
- Komuna nuk do të lëshoj lejen e ndërtimit për ndërtesat që nuk aplikojnë normat e projektit për sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për lëvizjen e njerëzve me nevoja të veçanta sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 2001/19

### *5.2.11 Masat për zbatimin e planit*

- Në rast të ndryshimit substancial të kushteve të përgjithshme në komunë, duhet të bëhet rishikimi i PZHK-së.
- PZHK-ja do të rishikohet çdo dy vite dhe do të rishikohet atëherë kur rrethanat e arsyetojnë.

#### ***5.2.11(a)*Detyrimi për hartimin e planit;**

- Komuna duhet të sigurojë kushtet financiare dhe të tjera për zbatimin e planit;
- Sipas Planit Hapësinor të Kosovës për çdo fushë më të madhe se 2 hektarë të vendosur jashtë zonës urbane duhet të hartohet një PRrU (duke përfshirë Bizneset / parqet industriale dhe objektet rekreativo-sportive.);
- Komuna duhet të hartojë PRrU-në për zonën ekonomike për vendosjen e industrisë bujqësore dhe bizneset e ndërlidhura.
- Lejet e ndërtimit për zhvillimet jashtë zonës urbane do të lëshohen në bazë të PZHK-së. Përveç kësaj, komuna merr në konsideratë dispozitat ligjore të përcaktuara nga Udhëzimet Administrative të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligjit mbi Ndërtimin dhe ligjet tjera relevante;
- Komuna duhet të hartojë një politikë që përcakton rregullat për zhvillimet përgjatë gjithë rrugës së Novakës, në mënyrë që të ruajë tokën bujqësore;

#### ***5.2.11(b)* Aplikimi i zhvillimit dhe masat e tjera;**

- Pas miratimit të PZHK-së, Komuna do të ndërmarrë veprimet e duhura për hartimin e planit të ndërlidhur kadastral në rast se PZHK-ja ka ofruar ndryshim në përdorimin e tokës.
- Mund të jetë e nevojshme që gjatë zbatimit të propozimeve për mbushjen dhe dendësimin e zonës së banimit, do të ndodhë nënndarja e parcelave.
- Komuna do të krijojë dhe mirëmbajë sistemin e të dhënave, sipas kërkesave të Ligjit mbi
- Planifikimin Hapësinor Nr. 2003/14, e cila duhet të jetë në harmoni me sistemin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Komuna do të ndërmarrë masa për ruajtjen e tokës bujqësore, zonave pyjore dhe fushave të tjera me interes të veçantë për komunën;
- Kuvendi Komunal duhet të përgatisë një vendim për mbrojtjen e tokës cilësore bujqësore . (Ligji për planifikim hapësinor dhe Ligjin për tokën bujqësore)

**5.2.11(c)Rindërtimi i ndërtesave destinimi i së cilave është në kundërshtim me destinimin e planifikuar;**

- Komuna nuk do të lejojë zgjerimin apo rindërtimin e ndërtesave ekzistuese në fushat për të cilat plani nuk i lejon.
- Komuna do të ndërmarrë masa për të parandaluar zhvillimet në zonat ku nuk lejohet ndërtimi.
- Legalizimi i ndërtimeve pa leje të cilat janë ndërtuar para miratimit të PZHK-së do të bëhet në bazë të Ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje.
- Legalizimi i ndërtimeve pa leje të cilat janë ndërtuar para miratimit të PZHK-së do të bëhet në bazë të Ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje.

## *5.3 DISPOZITAT QË LIDHE ME BASHKËPUNIMIN*

- Komuna do të informojë ministritë përkatëse, dhe agjencitë e ndërlidhura për projektet që janë propozuar në PZHK dhe të kërkojë përfshirjen e këtyre institucioneve.
- Komuna informon, bashkëpunon apo kryen marrëveshje për bashkë-financimin e projekteve me komunat fqinje për zbatimin e projekteve me interes të përbashkët.
- Komuna informon, bashkëpunon dhe kryen marrëveshje me kompanitë publike
- përgjegjës për shërbimet publike (ujë, kanalizim, energji elektrike, menaxhimi të mbeturinave të ngurta);
- Komuna bashkëpunon me donatorët në implementimin e projekteve të parapara
- me plan që mund të asistohet nga programet e donatorëve të ndryshëm.
- Komuna bashkëpunon ngushtë me OJQ-të për të zbatuar ngritjen e ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve të promovimit të parapara me plan;

- Komuna duhet të hartojë dhe projektoj planet dhe projektet e dala nga PZHK-ja me përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara sipas kërkesave të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr. 2003/14, përkatësisht amendamenti të ligjit nr 03/L-106;

## *5.4 DSPOZITAT QË MBI FAZAT E IMPLEMENTIMIT*

- Në mënyrë për të siguruar zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal veprimet në vijim duhet të ndërmerren:
- Drejtoria komunale për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm dhe Kadastër do të hartojë Programin për zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal;
- Drejtoria për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm dhe Kadastër do të monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e Planit dhe projekteve dhe të përgatisë raporte mbi zbatimin e tyre dhe të sugjerojnë ndryshime nëse është e nevojshme.
- Veprimet / projektet / programet e propozuara në planin zhvillimor komunal do të zbatohet në tri faza: afatshkurtër (e lidhur me planin e kornizës afatmesme buxhetore komunale; afatmesëm dhe afatgjatë.
- Të gjitha investimet në komunë që kanë karakter hapësinor duhet të jetë në përputhje me PZHK-në.
- Pas miratimit të planit zhvillimor komunal dhe hyrjes së tij në fuqi, Komuna duhet të analizojë buxhetin e tanishëm dhe të përfshijë projektet e propozuara në planin e rishikuar të buxhetit komunal.

## *5.5 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM*

PZHK-ja ka propozuar një numër të analizave paraprake dhe studimeve të cilat janë vërejtur si të domosdoshme për marrjen e informatave të kërkuara për zhvillimin e projekteve dhe zbatimin e planit:

- Studimi i fizibilitetit për burimet e ujit të pijshëm;

Hartimi i:

  - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM)
  - Plani për Menaxhimin e Mbeturinave;
  - Plani i Lëvizshmërisë
  - PRrU

## *5.6 DISPOZITAT PERFUNDIMTARE*

**Hyrja në fuqi***:* pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe shpalljes në Gazetën Zyrtare të RKS

**Vlefshmëria:** Ky plan do të jetë i vlefshëm deri në vitin 2023.

**Vlerësimi dhe ndryshimi i planit:** Vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të planit përkatësisht projekteve që rrjedhin nga ky plan do të bëhet nga Drejtoria komunale për Zhvillimi, Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër në baza vjetore.

Plani Zhvillimor i Komunal duhet të vlerësohet / rishikohet çdo dy vjet, dhe të rishikohet sipas nevojës;

Amendamentimet dhe plotësimet e PZHK-së do të kryhen në përputhje me metodën dhe procedurat e zbatueshme për miratimin fillestar të tyre.

Shqyrtimi publik mbi modifikimet, plotësimet apo shfuqizimin e planit, duhet të marrë të paktën 15 ditë dhe jo më shumë se 30 ditë (Udhëzimi Administrativ për shqyrtim publik 54/2005 të Ligjit për planifikim hapësinor.

# 6. ELEMENTET E RREGULLIMIT TË HAPËSIRËS

## 6.1 HYRJE

Kapitulli nr. 6 mund të konsiderohet si një zgjerim i pikës 5.2.2 të kapitullit nr. 5 Dispozitat e implementimit .

Ai ofron një sërë elementesh për rregullimin hapësinor sa i përket vendbanimeve më të cilat do t'i udhëheqin zhvillimet e ardhshme publike dhe private.

Edhe pse PZHK-ja ka një karakter strategjik inkorporomi i elementeve rregullative ka dalë si një nevojë për ta bërë dokumentin me praktik në mënyrë që t'i përshtatet qëllimit të Mamushës si një komunë e vogël. Një integrim i tillë është bërë në konsultim më autoritetet kompetente të MMPH-së.

Udhëzimet e prezantuara në faqet e mëposhtme kanë të bëjnë me tri elemente kryesore:

1. Zonimi i vendbanimeve
2. Ndërtimi I kushteve të konstruksionit
3. Seksionet/Profilet e Rrjetit të infrastrukturës

**Në të tre rastet rregulloret e mëposhtme aplikohen si udhëzime obligative për zhvillimet private si dhe ato të menaxhuara apo/te financuara nga administrata lokale.**

Pjesa e parë e dokumentit respektivisht **Harta e zonimit** , definon konceptin e dokumentit të gjithëmbarshëm të zonave të ndryshme te vendbanimeve që shkojnë përkrah dinamikave socio-ekonomike dhe strukturës territoriale të fushave të fokusit. Për më shumë ofron indikatorë që do të shërbejnë për të vlerësuar densifikimin dhe kapacitetet e ardhshme për planifikim të së ardhmes.

Pjesa e dytë , **Kushtet e ndërtimit** , radhit kushtet e ndërtimit sipas së cilave lejet e ndërtimit duhet të lëshohen nga zyrtarët komunalë.

Pjesa e tretë e dokumentit, **Infrastruktura rrugore** , rregullon hierarkinë e rrugëve lokale ashtu si edhe profilin e tyre.

Rrjeti i propozuar në mënyrë strikte e ka respektuar strukturën ekzistuese të shtrirjes së rrugëve dhe strukturës së parcelave .

## *6.2 HARTA E ZONIMIT*

Plani i zonimit organizon zonën e vendbanimit në 4 zona kryesore, duke përdorur dy kritere kryesore si bazë për identifikimin:

- Strukturat e vendbanimit dhe dinamikat socio-ekonomike në këtë zonë.
- Potencialet që këto zona përfaqësojnë për zhvillimin e ardhshëm.

Edhe pse vendbanimi është i karakterizuar nga një fond i ndërtimit mjaft homogjen, fakti se ai ishte zhvilluar spontanisht pavarësisht nga ndonjë nga parimet e planifikimit imponon nevojën që fillimisht të përcaktohen dhe theksohen specifikat kryesore të këtyre zonave të ndryshme në kuadër të zgjidhjes së si mjet për të forcuar karakterin e tyre.

Një analizë e thellë ka çuar në një propozim të zhvillimit për secilin prej zonave nëpër të cilën synohet të përmirësohet dhe të promovohen tiparet kryesore dhe burimet e zonave të fokusit

Të dy tiparet specifike që karakterizojnë ato dhe propozimet për zhvillim u prezantuan në faqet në vijim përmes tri instrumenteve kryesore:

- Paraqitja grafike. Kjo është bërë përmes një mostër të zonës që më së miri paraqet karakteristikat kryesore të gjendjes aktuale dhe asaj të propozuar, nëpërmjet tri aspekteve kryesore, të tilla si: njësive të ndërtesës, shtrirjes së rrugëve dhe të strukturës së ngastrës.
- Tabela si një paraqitje empirike e densifikimit të planifikuar, përkatësisht rritjes së paraparë për secilën anë të propozimit të zhvillimit për secilën zonë, të cilat duhet të shërbejnë si tregues për zhvillimin (rritjen) e kontrollit në fusha të ndryshme.
- Përshkrimi tekstual që arsyeton logjikën e propozimit për zhvillim




*Harta 18. Plani i zonimit të vendbanimit*

***Zona A***




**Situata aktuale:**Zona A mbulon zonën qendrore. Së bashku me Zonën B ajo përfaqëson një pjesë origjinale të vendbanimit e cila është zhvilluar në mënyrë spontane, pavarësisht nga çdo lloj I vëmendjes mbi parimet e planifikimit.

Një element shumë i rëndësishëm i parcelës për banim është aktiviteti bujqësor (serë, bagëti, magazinë). Megjithatë trend i zhvillimit është duke shkuar drejt zhvendosjes së  objekteve mbështetëse në toka bujqësore dhe shumëzimin e njësive të banimit.

Shtrirja e rrugëve është e karakterizuar nga rrugët qorre që dështojnë për të mundësuar qasje të drejtpërdrejtë në çdo parcelë apo njësi. Edhe pse të gjitha rrugët kanë qenë të shtruara dhe janë në një gjendje të mirë fizike, cilësia e hapësirë nuk është e kënaqshme, pasi që nuk ka treguar ndonjë konsideratë ndaj mënyrave të transportit të jo-motorizuar.

Seksioni i rrugëve është rreth 5.5 m dhe 0,40 m për shtigje te këmbësorëve pa elemente të gjelbra / natyrore përgjatë vijave

**Propozimi :**Duke marrë në konsideratë kualitetin urban, çmimet e tokës dhe kërkesën për hapësira rezidenciale dhe komerciale në pjesën qendrore, plani për një perspektivë afatgjatë propozon rekonstruktimin e sipërfaqes të rajonit në blloqe të kombinuara duke kombinuar aktivitetet, rezidenciale, ekonomike dhe sociale.

Ndahet në 5 blloqe (shih hartën .. Zonimi i banimit , Zona A ) Këto parcela duhet të ngjiten dhe të regjistrohen si të planifikuara si blloqe rezidenciale deri në 4 kate.

Zhvillimet e tilla mund te rrisin densitetin deri në 100%  duke shmangur nevojën për zgjerim të ardhshëm të vendbanimit në tokën bujqësore si burim me i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik.

| | SIPËRFAQJA (HA) | MADHËSIA E MESATARE E NGASTRËS (M2) | MADHESIA E MBULIMIT TË BAZAMENTIT /NJËSISË (M2) | SIPERFAQJA MESATARE E NJËSISË BANUESE (M2) | MADHESIA MESATARE E E EKONOMISË SHTËPIAKE | DENSITETI (BANOR/HA) | SIP. TOTALE PËR BANORË M2/ BANOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AKTUALE** | **9.07** | **560** | **123** | **251** | **9.28** | **101.42** | **98.60** |
| **PROPOZIMI** | **9.07** | **16 580** | **-** | **-** | **6.5** | **210** | **48** |

***Figura 34. Struktura e propozuar e Zonës A***

Pasi që konformiteti me këtë propozim është i vështirë për momentin për shkak të kapaciteteve të ulëta investuese, plani propozon që në ndërkohë intervenimet të kontribuojnë në përmirësimin e kualitetit të sipërfaqes (infrastruktura–rrjeti rrugor, rrjeti i furnizimit me ujë dhe & rrjeti i kanalizimit) ashtu siç planifikohet për nevojat e ardhshme te qarkut.

Sa i përket zhvillimit të banimit, plani kufizon zhvillimet e reja më atë rajon, përderisa ato ekzistuese duhet të konsolidohen sipas të tri kategorive të banimit si p.sh ato 2 dhe 3 siç janë prezantuar në pikën

## *Zona B*




**Situata aktuale:** Zona B përbëhet nga dy qarqe të vogla që shtrihen në dy anët e rrugës rajonale ,respektivisht rrugës kryesore të vendbanimit . Është përcaktuar si zone ë mbrojtur për shkak të prezencës së trashëgimisë vendore- më saktësisht për shtëpitë që datojnë që nga (shih pikën- Trashëgimia kulturore ).

**Propozimi:**Propozimi ka për qëllim të forcojë karakterin e sipërfaqes në fjalë duke promovuar identitetin e komunitetit për mes zhvillimeve të ardhshme në të gjitha sferat , intervenimet publike ; banimin dhe aktivitetet ekonomike.

Plani e inkurajon densifikimin përmes plotësimit me një rritje në densitet prej jo më shumë se 40%. Ndërtimi banesor është i limituar për shtëpitë një familjare , të ndara apo gjysmë të ndara deri në 2 kate mbi nivelin e tokës. Rekomandohet fuqishëm përdorimi I mikroelementeve që janë karakteristikë për paketën tipike të njësive banuese në kuptimin e dizajnit siç është – ngjyra, dritaret, dyert, rrethojat, proporcionet. Sa i përket përdorimi të parcelave kategoritë e lejuara janë ato 1 dhe 2.

Katër njësitë e trashëgimisë vendore duhet të shpronësohen dhe të përdoren për qëllime publike , në mënyre të preferuar për qëllimet edukative apo kulturore p.sh biblioteka.

| | SIPËRFAQJA (HA) | MADHËSIA E MESATARE E NGASTRËS (M2) | MADHESIA E MBULIMIT TË BAZAMENTIT /NJËSISË (M2) | SIPERFAQJA MESATARE E NJËSISË BANUESE (M2) | MADHESIA MESATARE E E EKONOMISË SHTËPIAKE | DENSITETI (BANOR/HA) | SIP. TOTALE PËR BANORË M2/ BANOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **CURRENT** | **4.65** | **560** | **123** | **251** | **9.28** | **80.25** | **110.52** |
| **PROPOSAL** | **4.65** | **350-700** | < **140** | < **280** | **6.5** | **140** | **70** |

***Figura 35. Struktura e propozuar e Zonës B***

## *Zona C*




**Situata aktuale:** Zona C prezanton zgjerimin e vendbanimeve, me një intensitet më të lartë të densifikimit gjatë 12 viteve të fundit.

Shumica e rrugëve janë individuale të cilat e ndjekin strukturën e parcelës, duke mundësuar qasje të drejtpërdrejtë në secilën njësi. Shumica e tyre janë të asfaltuara dhe përdoren si hapësira të përbashkëta me një gjerësi prej përafërsisht 4 m pa shtigje për këmbësorë ose linja të rezervuara për ecje apo biçikleta.

**Propozimi :**Densiteti i ulët dhe struktura e parcelave prezantojnë një potencial për zhvillimin e strukturës së vendit në atë rajon te përbërë nga një seri e rrugëve paralele që mundësojnë qasje direkte në secilën njësi.

Ndërtimet banesore janë të limituara në shtëpi një familjare me një lartësi deri në 3 kate mbi nivelin e tokës.

Tri prej kategorive (shih pikën 6.2.1 Banimi ) janë të aplikueshme në këtë zonë. Një faktor me rëndësi që i përket kategorisë së tretë është se në rast të një nevojë të madhe për vende të banimit mund të projektohet në një mënyrë që mund të ndahet në dy entitete duke përbërë një njësi nga secila prej këtyre kategorive.

Përmes rritjes së densitetit në këto tri zona propozimi që ka për qëllim konsolidimin e vendbanimit në një strukturë kompakte të centralizuar si një mekanizëm vete-mbajtës.

| | SIPËRFAQJA (HA) | MADHËSIA E MESATARE E NGASTRËS (M2) | MADHESIA E MBULIMIT TË BAZAMENTIT /NJËSISË (M2) | SIPERFAQJA MESATARE E NJËSISË BANUESE (M2) | MADHESIA MESATARE E E EKONOMISË SHTËPIAKE | DENSITETI (BANOR/HA) | SIP. TOTALE PËR BANORË M2/ BANOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **AKTUALE** | **35.97** | **5079** | **123** | **251** | **9.97** | **61.05** | **163.72** |
| **PROPOZIMI** | **50.12** | **350-1150** | **< 140** | **< 320** | **6.5** | **120** | **82** |

***Figura 36. Struktura e propozuar e zonës C***

## *Zona D*




**Propozimi :**Zona D e mbulon sipërfaqen që është e rezervuar për zgjerim në të ardhmen në rast të një zhvillimi të tillë. Në ndërkohë sipërfaqja shfrytëzohet për aktivitete bujqësore gjersa vendbanimi ekzistues duhet të konsolidohet sipas tre kategorive të banimit. (shih pikën 6.2.1 Banimi ).

Pasi që bujqësia është shtytësi kryesor i zhvillimit ekonomik , plani inkurajon zhvillimin e agro industrisë së lehtë (bujqësisë-fermave ) në rajon.

Konstruksionet janë të limituara në sisteme montimi dhe materiale të qëndrueshme ( kryesisht dru).

Rrjeti rrugor duhet të trajtohet sipas materialeve natyrore siç janë, pllakat e gurit, zhavorri etj. Në ndërkohë infrastruktura e shërbimeve duhet t'i përshtatet metodave të gjelbra të sistemeve të pavarura.

| | SIPËRFAQJA (HA) | MADHËSIA E MESATARE E NGASTRËS (M2) | MADHËSIA E MBULIMIT TË BAZAMENTIT /NJËSISË (M2) | SIPERFAQJA MESATARE E NJËSISË BANUESE (M2) | MADHESIA MESATARE E E EKONOMISË SHTËPIAKE | DENSITETI (BANOR/HA) | SIP. TOTALE PËR BANORË M2/ BANOR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **PROPOZIMI** | **82.60** | **350-1150** | DERI TE **140** | DERI TEK **320** | **6.5** | **5** | **200** |

***Figura 37. Struktura e propozuar e Zonës D***

## 6.3 KUSHTET E NDËRTIMIT

Ky seksion siguron kushtet e ndërtimit që janë për t'u ndjekur nga zyrtarët komunalë si një listë e plotë për dhënien e lejeve të ndërtimit.

Këto kushte janë zhvilluar në bazë të funksionit të ndërtesave të tilla si: Banimi; Përdorim i llojllojshëm, Industria, Tregtia dhe Ndërtesat Administrative.

### 6.3.1 Banimi

Tipologjia e banimit në Mamushë është homogjene. Një nga qëllimet kryesore të këtij plani është për të ruajtur karakterin rural të zgjidhjes, pra plani i propozon për të ruajtur kulturën aktuale të banimit, fuqimisht të banimit me bagëtinë dhe aktivitet bujqësor si një element shumë të rëndësishëm të parcelave të strehimit.

Duke thënë se plani propozon tri kategori të banimit, të cilat vërtet paraqesin tre kombinime të aktiviteteve të përmendura më lart në varësi të dimensioneve të parcelës.

Këto tri kategori zbatohen për secilën prej zonave, me kufizime të caktuara të përcaktuara sipas nenit hartën e zonimit.

*Kategoria e parë paraqet një parcelë tradicionale për një shtëpi familjare të vetme me një sipërfaqe deri në 450 m2. Ajo përmban vetëm funksionet kryesore të tilla si*:

| | |
|---|---|
| 1 | HOUSING UNIT |
| 2 | GARDEN |
| 3 | PARKING OR GARAGE |
| 4 | LIVESTOCK FACILITY |
| 5 | GREENHOUSE |







*Kategoria e dytë përbëhet nga një parcelë deri në 700 m2. Funksionet e përfshira janë*:

| | |
|---|---|
| 1 | HOUSING UNIT |
| 2 | GARDEN |
| 3 | PARKING OR GARAGE |
| 4 | LIVESTOCK FACILITY or GREENHOUSE |






*Kategoria e tretë përbëhet nga një parcelë deri në 1150m2. Ndryshe nga dy parcelat tjera që kanë qenë të hartuara në një mënyrë që ato të mund të ndahen në tre parcela të kategorisë së parë ose në dy pjesë e cila do të jetë një kombinim i kategorisë së parë dhe të dytë varësisht të kërkesës për zonën e banimit në Mamushë. Si e tillë ajo përmban*:




<table>
<tr><td colspan="2">KOMPONENTËT PËRBËRËSE TË KATEGORIVE</td><td>KATEGORIA I</td><td>KATEGORIA II</td><td>KATEGORIA III</td></tr>
<tr><td>1</td><td>NJËSIA BANESORE</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td></tr>
<tr><td>2</td><td>OBORRI</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td></tr>
<tr><td>3</td><td>PARKINGU</td><td>✓</td><td>✓</td><td>✓</td></tr>
<tr><td>4</td><td>DYQAN DHE PLEVICË</td><td></td><td rowspan="2">✓</td><td>✓</td></tr>
<tr><td>5</td><td>SERRË</td><td></td><td>✓</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">KUSHTET E BANIMIT SIPAS KATEGORIVE TË PËRCAKTUARA</td><td>KATEGORIA I</td><td>KATEGORIA II</td><td>KATEGORIA III</td></tr>
<tr><td>0.1</td><td colspan="2">SIPËRFAQJA MAKSIMALE E PARCELËS</td><td>350 – 450 m²</td><td>700 m²</td><td>1150 m²</td></tr>
<tr><td>0.2</td><td colspan="2">DIMENZIONET MINIMALE TË PARCELËS[1]</td><td>14 m</td><td>14 m</td><td>28 m</td></tr>
<tr><td rowspan="2">1.1</td><td colspan="2">NJËSIA BANUESE (MAKS.)<br>E NDARË</td><td colspan="3">< 130 m²</td></tr>
<tr><td colspan="2">GJYSMË E NDARË</td><td></td><td colspan="2">< 180 m²</td></tr>
<tr><td>1.2</td><td>LARTËSIA</td><td>Zona A<br>Zona B<br>Zona C</td><td colspan="3">Maks. P+3<br>Maks. P+1<br>Maks. P+2</td></tr>
<tr><td>1.3</td><td colspan="2">LARTËSIA E KATIT (MAKS)</td><td colspan="3">H = 2.8 m</td></tr>
<tr><td></td><td colspan="2">LARTËSIA E KATIT PËR NDERTESA ME PERDORIM TË PËRZIER</td><td colspan="3">H = 2.8 m</td></tr>
<tr><td>1.4</td><td colspan="2">LARTËSIA NGA PIKA MË E ULTË E TERRENIT BAZUAR NË LLOJIIN E KULMIT.</td><td colspan="3">maks 12.0 m</td></tr>
</table>

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1.5 | KULMI ME NJË MAJË | | |
| | Pjerrtësia | < 15° | |
| | Lartësia nga pika më e lartë e pllakës deri në pikën më të lartë të kulmit | maks 3.0 m | |
| | KULMI ME DY E KATËR MAJE | | |
| | Pjerrtësia | < 30° | |
| | Lartësia nga pika më e lartë e pjerrtësisë deri tek pika më e lartë e kulmit. | maks 3.0 m | |
| 1.6 | DISTANCA MINIMALE NGA RRETHOJA | | |
| | Distanca e përparme — Rr. Kryesore | min 10.0 m | |
| | Rr. Kolektive . | min 3.0 m | |
| | Rr. E Bllokut (lagjes). | min 3.0 m | |
| | Distanca anësore | min 1.5 m | |
| 2.1 | ( E KONCENTRUAR) HAPËSIRË E LIRË (MIN) | | min 1.5 x HA[2] |
| 3.1 | GARAZHA | < 20 $m^2$ | |
| 3.2 | KATET-E GARAZHEVE | KG+0 | |
| 3.3 | LARTËSIA NGA PIKA MË E ULËT E TERRENIT DERI TEK PIKA MË E ULËT E MBULESËS, KULMI I RRAFSHËT | maks 2.4 | |
| | KULMI ME NJË MAJE I PJERRTËSISË PREJ < 15° | maks 3.0 | |
| 4.1 | OBJEKTI I BLEGTORISË | | 20 % |
| 4.2 | LARTËSIA NGA PIKA MË E ULËT E TERRENIT DERI TEK PIKA MË E LARTË E KULMIT THE – KULM ME DY MAJE ME PJERRTËSI < 15° | | 6 m |

[1] *Sipërfaqja e përcaktuar për infrastrukturë rrugore duhet të nxirret nga sipërfaqja e parcelës.*

[2] *HA – sipërfaqja e strehimit*

- Jo më shumë se 30 % e sipërfaqes së parcelës mund të zgjerohet jashtë Sipërfaqes së vendbanimit .
- Qasja në sipërfaqe do të jetë nga rruga e nivelit më të ultë, përveç nëse specifikohet ndryshe për raste te ndryshme.

- Konzolat apo ballkonet duhet të përfshihen në sipërfaqen e bazamentit me pikën 1.1 të tabelës mbi.
- Gjatë përdorimit të ndërtesave rezidenciale në të ardhmen duhet të promovohen dhe të sugjerohen masat për efikasitet energjetik.;
- Lartësia maksimale e rrethojës është 1.2 metra. Rrethoja preferohet që të jetë nga strukturat drunore apo metalike. Dera e hyrjes preferohet të jetë e llojit tradicional.

### *6.3.2 Përdorimi i përzier : Banim +*

a) Kushtet për aktivitete

- Në këtë kategori janë përfshirë ndërtesat e përdorimit të përzier: banimi + aktivitetet komerciale .
- Aktivitetet komerciale janë të kufizuara në rrugën rajonale/ rrugën kryesore dhe rrugët kolektive.
- Aktivitete të lejuara janë ato që nuk e shkaktojnë ndotjen e ajrit, atë akustike dhe fizike.

b) Kushtet për ndërtimin e njësive banesore

- Kushtet për shfrytëzimin e tokës, lartësia e ndërtesave dhe përmbajtjet tjera të PARCELËSduhet ti referohen kushteve për ndërtimin e njësive banesore individuale në varësi të kategorisë përkatëse.

c) Kushtet për shfrytëzimin ambientit të ndërtuar

- Aktivitetet tregtare janë të limituara në katin përdhes.

d) Kushtet në raport me hapësirën për përdorim publik.

- Kur linjat për këmbësorë apo linjat për çiklistë janë te penguar nga nevoja për parkim eventual , shmangja duhet te mbulohet nga aplikanti.
- Në rastet kur për përdorimin e shërbimit është i nevojshëm një parking për një periudhe më të gjatë – më shumë së 10 minuta – aplikanti duhet të sigurojë një numër përkatës të vendeve të parkimit pa e penguar lëvizjen e këmbësorëve , biçikletave apo veturave. Në këtë hapësirë nuk përfshihen hapësirat për shfrytëzim publik.

### *6.3.3 Ndërtesat industriale, tregtare dhe administrative*

a) Kushtet për aktivitete

- Ndërtimi i ndërtesave industriale kufizohet në zonën industriale.
- Ndërtimi e ndërtesave administrative dhe tregtare janë të kufizuara përgjatë rrugës rajonale /kryesore.
- Aktivitetet që shkaktojnë ndotje fizike apo akustike brenda zonave të banimit duhet të shënojnë kushtet e shënuara me *.

b) Kushtet për ndërtimin e njësive banesore

- Kushtet e ndërtimit jepen pas përcaktimit të qartë të parcelës.
- Hapësirat e magazinimit dhe hapësirat tjera ndihmëse duhet të organizohen brenda sipërfaqes për ndërtim.

c) Kushtet në raport me hapësirën për përdorim publik

- Kur shtigjet e këmbësorëve apo të çiklistëve janë të penguar nga nevoja për parkim eventual , shmangia duhet të mbulohet nga aplikuesi .

- Aplikanti është i detyruar të parashohë një mur të gjelbër si ndarje nga zona e banimit.
- Aplikanti është i detyruar të parashohë një mur të gjelbër si ndarje nga ndërtesat fqinje nëse aktiviteti parandalon aktivitetet fqinjësore.
- *Hyrja dhe aktivitetet duhet të zhvillohen në pjesën e pasme të ndërtesës.

| | | |
|---|---|---|
| 0.1 | SIPËRFAQJA MAKSIMALE E PARCELËS | 1500 $m^2$ |
| 0.2 | DIMENSIONET MINIMALE TË PARCELËS[1] | 30 m |
| 1.1 | KOEFICIENTI I SHFRYTËZIMIT TË TOKËS PËR NJËSI BANIMI (MAKS) | 50 % |
| 1.2 | LARTËSIA E KATIT (MAKS) | H = 3.5 m |
| | LARTËSIA E KATEEVE TË NDERTESAVE PËR PËRDORIM TË PËRZIER | H = 4.0 m |
| 1.3 | LARTËSIA NGA PIKA MË E ULËT E TËRRENIT BAZUAR NË LLOJIN E KULMIT .(MAKS) | 12.0 m |
| 1.4 | KULMI ME NJË MAJE | |
| | Pjerrtësia | < 15° |
| | Lartësia nga pika me e lartë e pllakës deri tek pika më e lartë e kulmit. (MAKS) | 3.0 m |
| | KULMI ME DY MAJE | |
| | Pjerrtësia | < 30° |
| | Lartësia nga pika me e lartë e pllakës deri tek pika më e lartë e kulmit. (MAKS) | 3.0 m |
| 1.5 | DISTANCA MINIMALE ANESORË NGA RRETHOJAT E PARCELËS (MIN) | |
| | Distanca në të dy anët | 3.0 m |
| | Distanca në njërën anë të PARCELËS | 6.0 m |
| | Distanca në anën e prapme | 4.0 m |

[1] *Sipërfaqja e përcaktuar për infrastrukturë rrugore duhet të nxirret nga sipërfaqja e parcelës*

## *6.4 INFRASTRUKTURA– RRJETI RRUGOR*

Në këtë pjesë të fundit të Kaptinës së 6-të jepen profilet e rrugëve që janë përcaktuar duke marrë parasysh hierarkinë dhe përbërjen, përkatësisht rrjetin e mobilitetit të ngadaltë , korridoret e gjelbra , çështjet e parkimit dhe të sigurisë.

Rrjeti i jep prioritet lëvizshmërisë jo-motorizuar për arsye se lëvizja brenda vendbanimit kryesisht bëhet përmes ecjes, duke paraparë një rrjet të mobilitetit të ngadalshëm që ofron një qasje të lehtë dhe të drejtpërdrejtë në të gjitha funksionet brenda komunitetit*. (shih kaptinën 3, Infrastruktura ).*

Kemi 6 profile të prezantuara, e cila kur të zbatohet duhet në mënyrë strikte të respektojë elementet përbërëse. Dimensionet janë kërkesat minimale prandaj gjatë implementimit këto dimensione mund të jenë më të mëdha kur paraqitet një mundësi e tillë.

Sa i përket rrugëve të lagjeve (*shih hartën 19*) rrjeti do të modifikohet në rastin kur kemi bashkim të parcelave, që duhet të përcillet më një konsensus në mes të pronarëve të tokës dhe administratës.




*Harta 19. Hierarkia e rrugeve*




***Harta 20, Profilet e rrugeve***

Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile




profile 1

Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile




profile 2

Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile



Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile



Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile



Section of the street profile



Blueprint of the street profile




View of the street profile

